

Një jetë kushtuar paqes
dhe lumturisë njerëzore

Përmbajtja

**Kush është
Fethullah Gylen?**

6

**Disa
Perla
Urtësie**

10

**Përpyjekjet e Gylenit
në Fushën e Dialogut**

13

**Edukimi dhe
Rëndësia e tij**

22

**Lëvizja
Gylen**

32

**Komente Rreth
Fethullah Gylenit**

37

Përmbajtja

Fethullah Gylen
në Media

41

Gjykime dhe
Aforizma

46

Konferenca dhe
Seminare mbi
Lëvizjen Gylen

64

Institetet
Gylen

74

Fethullah Gylen
Në Prizmin e
Intelektualëve Shqiptarë

78

Në Prag të
Mijëvjeçarit
të ri

91



FETHULLAH GYLEN

FETHULLAH GYLEN

Një jetë kushtuar paqes dhe lumturisë njerëzore

Fethullah Gylen është një dijetar mysliman turk i gjithanshëm dhe me peshë, mendimtar, autor, poet, editorialist dhe aktivist në fushën e edukimit. Ai mbështet dialogun ndërfaqetarak dhe ndërkulturor, shkencën, demokracinë dhe botën e pasur shpirtërore, kundërshton dhunën si dhe përdorimin e fesë si ideologji politike. Gyleni nxit bashkëpunimin mes qytetërimeve në kërkim të një bote paqësore dhe është kundërshtar i përplasjes mes tyre.

Fethullah Gylen dhe Lëvizja e Shoqërisë Civile e frymëzuar nga pikëpamjet e tij, e cila njihet ndryshe si Lëvizja Gylen, mbartin një domethënie të madhe dhe kërkojnë vëmendje të veçantë për arsyet e mëposhtme:

1. Autoriteti dhe ndikimi i Gylenit: Fethullah Gylen njihet dhe respektohet si në gjirin e myslimanëve turq ashtu edhe nga myslimanët e tjerë rreth e rrotull botës, si një dijetar mysliman me peshë i traditës Suni, së cilës i përkasin 87-90 % e numrit të përgjithshëm të myslimanëve në botë. Ai është gjithashtu një mendimtar, poet, autor produktiv, aktivist në fushën e edukimit si dhe editorialist. Numri i lexuesve të tij në Turqi llogaritet në disa milionë njerëz. Ndikimi i tij jashtë Turqisë po rritet dita ditës dhe librat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë si: anglisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, frëngjisht, rusisht, arabisht, shqip, etj. Përveç botimeve të shkruara, idetë e tij mund të njihen dhe studiohen nga një numër në rritje i njerëzve në mbarë botën, nëpërmjet radiove private dhe rrjeteve televizive simpatizuese të pikëpamjeve të tij.

2. Dënim publik ndaj akteve të dhunës, terrorit dhe sulmeve vetëvrasëse: Gyleni është i njohur për dënimin e vazhdueshëm që i ka

bërë përzjerjes së dhunës me retorikën fetare. Më konkretisht;

- Ai ishte dijetari i parë mysliman i cili dënoi publikisht sulmet e 11 shtatorit (me anë të një artikulli në gazetën Washington Post).

- Ai ndihmoi në botimin e librave mjaft të vlefshëm në lidhje me pikëpamjet islame rreth terrorit apo sulmeve vetëvrasëse, duke i dënuar akte të tilla si nga pikëpamja njerëzore, ashtu edhe nga ajo fetare.

- Ai nuk i ka shprehur këto ide vetëm për lexuesit perëndimorë, por i ka paraqitur me zë të lartë ato edhe me anë të predikimeve nëpër xhami dhe në tubime të tjera në prani të mijëra myslimanëve. Ai i ka dënuar sulmet vetëvrasëse në mënyrë të padiskutueshme.

- Ai ka dhënë mjaft intervista për gazeta të njohura amerikane, turke, japoneze dhe keniane, ku në mënyrë kategorike ka kritikuar përdorimin e motiveve politike, ideologjike dhe fetare për të justifikuar aktet e terrorit. Ai është shfaqur gjithashtu publikisht edhe në programe të shumta televizive ku ka kritikuar akte të tilla.

3. Pionier në fushën e dialogut ndërfaqetarak: Gyleni është angazhuar në mënyrë aktive në nxitjen e dialogut ndërfaqetarak dhe ndërkulturor për më shumë se një dekadë, duke filluar shumë kohë përpara tragjedisë së 11 shtatorit. Në Turqi, ai ka fituar shumë kredibilitet për shkak të nxitjes së një atmosfere pozitive në marrëdhëniet ndërmjet shumicës myslimane dhe minoriteteve të ndryshme fetare që jetojnë atje si ortodoksët grekë, ortodoksët armenë, katolikët si dhe pakica hebreje. Jashtë Turqisë, idetë e tij rreth dialogut ndërfaqetarak kanë frymëzuar shumë persona për të themeluar institute të



FETHULLAH GYLEN

shumta që merren me dialogun me të njëjtat objektiva të mirëkuptimit reciprok, pranimit të ideve të ndryshme, bashkekzistencës paqësore si dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Përpjekjet e tij për dialog dhe tolerancë iu bënë të njohura edhe Papës Gjon Pali II-të nëpërmjet një pritjeje personale që ky i fundit i bëri Gylenit, ashtu dhe Kreut Sefardik të Rabinëve të Izraelit. Po kështu, Gylen ka zhvilluar shumë takime me udhëheqës të ndryshëm fetarë me përkatësi kristiane.

4. Për bashkëpunimin mes qytetërimeve: Gyleni nxit bashkëpunimin mes qytetërimeve nëpërmjet dialogut, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bashkimit rreth vlerave të përbashkëta, si ana e kundërt e përplasjes mes tyre. Si opinionist i shoqërisë civile, ai mbështet përpjekjet turke drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian, duke theksuar se një marrëdhënie e tillë do të jetë e dobishme për të dy palët.

5. Theksi mbi dimensionin shpirtëror të besimit: Duke qenë i pajisur në rininë e tij të hershme me edukim shpirtëror, Gylen njihet për rëndësinë e madhe që i jep botës shpirtërore, si dhe për qëndrimin e ngrohtë ndaj qenieve njerëzore, ndjenjë e cila buron nga ky theks që ai i vë botës shpirtërore. Falë kësaj rëndësie që ai i jep dashurisë, mëshirës dhe shpirtmadhësisë në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me njerëzimin, ai konsiderohet nga shumë njerëz si një "Rumi i ditëve tona". Vetë libri katër vëllimësh i Gylenit rreth Sufizmit, përdoret si tekst universitar në lëndët që kanë të bëjnë me traditat shpirtërore në botë.

6. Shkenca dhe besimi në harmoni: Gylen e sheh shkencën dhe besimin jo vetëm të përputhshme, por edhe si plotësuese të njëra-tjetrës. Për këtë arsye, ai nxit kërkimet shkencore dhe përparimet teknologjike për të mirën e gjithë njerëzimit.

7. Dimensioi intelektual: Ai është i mbujtur mirë me dije rreth mendimtarëve të mëdhenj të traditës perëndimore dhe mund të bashkëbisedojë me ta lehtësisht, nëpërmjet shkrimeve dhe citimeve të tij.

8. Pro-demokracisë: Gyleni e konsideron demokracinë si të vetmin sistem të vlefshëm politik të qeverisjes. Ai denoncon me forcë kthimin e fesë në ideologji politike dhe nxit të gjithë qytetarët të luajnë një rol të qartë dhe të përgjegjshëm në jetën politike të vendit të tyre. Ai e vë theksin mbi fleksibilitetin e parimeve islame në lidhje me qeverisjen dhe mbi përputhshmërinë e tyre me demokracinë e vërtetë.


9. Zgjidhje të problemeve sociale nëpërmjet punës në terren: Aspekti më i mahnitshëm i jetës së Gylenit është fakti se vizioni dhe idetë e tij nuk kanë mbetur thjesht retorika, por përkundrazi, janë vënë në zbatim në mbarë botën si projekte civile. Sipas disa përlloraritjeve, janë themeluar me qindra organizata edukative, si kopshte, shkolla, kolegje, lice dhe universitete në mbarë botën, të frymëzuara nga Gyleni dhe të financuara nga sipërmarrës lokalë, arsimtarë altruistë dhe prindër të përkushtuar. Pavarësisht vendndodhjes së tyre, këto shkolla janë simbole të marrëdhënieve harmonike ndërfaqetare dhe ndërkulturore, të unifikimit të suksesshëm të fesë dhe arsyes, si dhe të përkushtimit ndaj shërbimit për njerëzimin. Veçanërisht në rajone me konflikte të ndezura si në Filipine, Turqinë Juglindore dhe Afganistan, këto institucione ndihmojnë në reduktimin e varfërisë dhe rritjen e mundësive dhe shanseve për edukim, gjë e cila nga ana tjetër ndikon në zvogëlimin e ndikimit të grupeve terroriste, nëpërmjet hartimit të planeve të veçanta të veprimit në këto vende. Krahas kontributit në aspektin e harmonisë sociale, këto shkolla kanë nxjerrë vazhdimisht fitues në konkurset ndërkombëtare në fushën e shkencave dhe të matematikës.

10. Projekte të tjera që kanë të bëjnë me shoqërinë civile: Projekte të tjera civile të frymëzuara nga nxitja dhe idetë e Gylenit përfshijnë organizata të ndryshme bamirëse, ato të zhvillimit të qëndrueshëm, organizata mediatike, shoqata profesionale si dhe institucione të ndryshme mjekësore.

Dr. M. Çetin



FETHULLAH GYLEN



Kush është Fethullah GYLEN?

Gylen është një studiues dhe mendimtar islam, një shkrimtar dhe poet. U arsimua në shkencat fetare nga dijetarë dhe mësues shpirtërorë të shquar islamë të kohës. Gyleni studioi gjithashtu teoritë dhe parimet e shkencave moderne shoqërore e të natyrës.



FETHULLAH GYLEN

I lindur në Erzurum të Turqisë më 1941, M. Fethullah Gylen është një studiues dhe mendimtar islam, një shkrimtar dhe poet. U arsimua në shkencat fetare nga dijetarë dhe mësues shpirtërorë të shquar islamë të kohës. Gyleni studioi gjithashtu teoritë dhe parimet e shkencave moderne shoqërore e të natyrës. Më 1958, pasi arriti rezultate të shkëlqyera në provime iu dha licenca e predikuesit zyrtar dhe, menjëherë, u gradua me një post në Izmir, qyteti i tretë për nga madhësia dhe rëndësia në Turqi. Kjo ishte koha kur Gyleni filloi të kristalizonte temat dhe të zgjeronte bazat e audiencës së tij. Në predikimet dhe ligjëratat që mbante, ai theksonte çështjet e shtypjes shoqërore në kohëra, pasi qëllimi i tij i veçantë ishte të inkurajonte brezin e ri për të harmonizuar ndriçimin intelektual me urtësinë shpirtërore dhe një përkujdesje për aktivizmin human.

Gyleni nuk u kufizua vetëm në qendrat e qyteteve për të predikuar. Ai udhëtoi nëpër provincat e Anadollit dhe predikoi jo vetëm nëpër xhami, por edhe në tubime shoqërore dhe në kuvendet e ngushta rreth filxhanit të kafesë. Kjo e mundësoi atë të arrinte një përfaqësim model në popull dhe të tërhiqte vëmendjen e komunitetit akademik, posaçërisht të studentëve. Përmbajtja e temave në ligjëratat e tij, zyrtare ose jozyrtare, nuk kufizohej vetëm në çështjet fetare; ai fliste rreth arsimit, shkencës, darvinizmit, rreth ekonomisë dhe drejtësisë shoqërore. Ishte thellësia dhe cilësia e ligjëratave të tij në tema të tilla të gjera që bëri më shumë përshtypje në komunitetin akademik, duke fituar vëmendjen dhe respektin e tyre.

Ai konsiderohet si nismëtari dhe frymëzuesi i rrjetit shoqëror mbarëbotëror të vlerave njerëzore të njohur si Lëvizja Gylen. Ai respektohet nga lexuesit dhe dëgjuesit e tij si model i gjallë i vlerave të larta si mençuria, besimi, dashuria, butësia, respekti, sinqeriteti, mëshira, ndjeshmëria dhe shërbimi ndaj njerëzimit. Gylen konsiderohet si një nga intelektualët më me influencë jo vetëm në Turqinë moderne, por gjithashtu edhe në mbarë globin. Në korrik të 2008, ai u rendit mes 100 intelektualëve publikë më të shquar nga revista Foreign Policy dhe në votimin *online* u përzgjodh nga lexuesit si intelektual

Fethullah Gylen është tejet i ndjeshëm përsa i përket mbrojtjes së jetëve njerëzore, pavarësisht besimit fetar, racës apo nivelit kulturor.

më i shquar publik. Pavarësisht vlerësimit të madh që miliona njerëz kanë për të, Gylen e konsideron veten, vetëm një prej vullnetarëve të lëvizjes së shoqërisë civile të cilën ai e ndihmoi të lindte dhe nuk e pranon idenë se ai është udhëheqësi i saj. Ai kalon shumicën e kohës duke lexuar, shkruar, botuar, adhuruar dhe duke marrë mjekim për shkak të shëndetit të tij.

“Të jetosh për të bërë të tjerët të jetojnë” përbën parimin themelor të pikëpamjeve të tij në lidhje me shërbimin. Pozicioni i tij në fushën e dialogut, mirëkuptimit



FETHULLAH GYLEN

dhe bashkekzistencës harmonike, mund të paraqiten më së miri me anë të një paralelizmi të tij me Rumiun. E ndërsa Rumi bënte thirrje duke rënkuar: “Ejani, ejani kudo që të jeni; ky i yni nuk është karvani i dëshpërimit,” Gylen thërret duke ecur: “Unë po vij, kudo që të jeni; a nuk është ky i yni udhëtimi i shpresës?”

Lëvizja Gylen përbën një rast unik të reformimit shoqëror global të bazuar mbi botën shpirtërore në një numër aspektesh. E pajisur me parimet e mirëkuptimit, dashurisë dhe dialogut, Lëvizja Gylen gëzon një pjesëmarrje të madhe vullnetare të të rinjve nga prejardhje, ideologji, kombe, klasa, raca dhe besime të ndryshme fetare në mbarë botën.

Lëvizja Gylen është shfaqur si një fenomen domethënës në Turqi dhe tashmë së fundmi edhe në mbarë botën, ndaj kjo bashkësi e frymëzuar nga mësuesi dhe teologu islam Fethullah Gylen, tashmë përfshin disa miliona pasues. E nisur me një rreth të vogël anëtarësh të xhamisë së tij në Izmir, bashkësi e cila u kristalizua rreth Gylenit aty nga fundi i viteve 70-të, Lëvizja tani fokusohet në projekte globale të shërbimit,

veçanërisht në fushat e edukimit, dialogut ndërfaqetarak dhe ndërkulturor si dhe në ndihma humanitare.

Fethullah Gylen është tejet i ndjeshëm përsa i përket mbrojtjes së jetëve njerëzore, pavarësisht besimit fetar, racës apo nivelit kulturor. “Ai nuk ndjeu keqardhje të thellë vetëm gjatë Luftës së Gjirit ku shumë myslimanë të pafajshëm humbën jetën, por ndjeu keqardhje gjithashtu edhe kur dëgjoji se raketat e Sadam Hysenit goditën fëmijët e pafajshëm izraelitë,” shpjegon Abdullah Ajmaz. “Ai ka mbajtur gjithmonë anën e të pafajshmëve dhe e ka porositur vazhdimisht bashkësinë e pasuesve të tij të bëjnë të njëjtën gjë.” Mësimet e tij kanë frymëzuar dhe vazhdojnë të frymëzojnë mijëra njerëz të punojnë për edukimin global, paqen dhe përhapjen e tolerancës. Ata ndajnë të njëjtat vlera të përbashkëta humane, pasione dhe ideale. Fethullah Gylen është shndërruar në një model për miliona njerëz që jetojnë në vende të ndryshme. Pasuesit e tij janë angazhuar në qindra projekte të shoqërisë civile dhe kanë hapur mbi 800 shkolla në mbarë botën. Këto shkolla ofrojnë një kurrikulum në përputhje me standardet më të larta lokale. Objektivat edukative të frymëzuar nga Gylen kanë mobilizuar organizata të panumërta jofitimprurëse mbi baza vullnetare, fondacione dhe shoqata, si në Turqi ashtu edhe jashtë saj, me mbështetjen edhe të mjaft intelektualëve. Këta njerëz janë vullnetarë dhe profesionistë të cilët punojnë në organizata edukative dhe jofitimprurëse. Megjithatë, ata përjetojnë një gjerësi shpirtërore, intensivitet dhe përkushtim në gjithë jetën dhe punën e tyre.



FETHULLAH GYLEN

Lëvizja është zgjeruar duke financuar hapjen e konvikteve të studenteve, kolegjeve, universiteteve, aktiviteteve kulturore, atë të dialogut ndërfaqetor dhe OJQ-ve. Gylen ka vizituar rregullisht dhe ka pritur vizita nga figura fetare të kalibrit botëror si patriarkë, rabinë si dhe Papa Gjon Pali II. Deri në momentin kur Gyleni nisi të takohej me këta udhëheqës dhe përfaqësues, ka qenë diçka mjaft e pazakontë për një mysliman në Turqi që të hyjë në dialog me një kristian apo hebre.

Lëvizja Gylen përbën një rast unik të reformimit shoqëror global të bazuar mbi botën shpirtërore në një numër aspektesh. E pajisur me parimet e mirëkuptimit, dashurisë dhe dialogut, Lëvizja Gylen gëzon një pjesëmarrje të madhe vullnetare të të rinjve nga prejardhje, ideologji, kombe, klasa, raca dhe besime të ndryshme fetare në mbarë botën. Rrjeti Gylen, propozon një model të partneritetit dhe bashkëpunimit shpirtëror të mbështetur mbi pasionet e përbashkëta dhe idealizmin, si dhe një këndvështrim shumëdimensional të vlerave të përbashkëta universale dhe botës shpirtërore. Ajo çfarë e bën Gylenin unik është se ai ka nxitur dhe mobilizuar mjaft të rinj në mbarë botën për të themeluar institucione edukative dhe civile si dhe ka qenë në gjendje të vërë në jetë parimet e tij të vlerave shpirtërore dhe globale, duke realizuar kështu idealin e tij të lindjes së “brezave të artë” dhe ecjen përpara drejt paqes globale.

Seminare dhe Ligjërata

Gylen ka marrë pjesë në më shumë se 500 seminare, bashkëbisedime dhe konferenca si në Turqi ashtu edhe në vende të tjera. Lista e çështjeve të diskutuara në këto seminare përfshin tema të tilla si: Morali, Dashuria për Zotin, Të drejtat e prindërve, Mirërritja e fëmijëve, Domethënia e lutjeve, Jeta metafizike, Bota e shpirtërave, Jeta shoqërore, Vëllazëria, Ndjenja e përgjegjësisë, Profeti Muhamed, pyetje dhe përgjigje mbi tema të ndryshme etj.,.

Veprat

Fethullah Gylen është një shkrimtar produktiv me mbi gjashtëdhjetë libra. Krahas librave ai ka shkruar faqet editoriale për revista të ndryshme, si The Fountain, Yeni Ümit, Sizinti, dhe Yagmur, revista që përfaqësojnë mendimin popullor dhe shpirtëror sot në Turqi. Disa prej librave të tij, shumë prej të cilëve janë ndër më të shiturit në Turqi, janë të përkthyer në shumë gjuhë të ndryshme si anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, rusisht, italisht, japonisht, indonezisht, etj. Në gjuhën shqipe janë përkthyer veprat më përfaqësuese të Gylenit, të tilla si: Drita e Pashuar 1-2; Kriteret; Drejt një Qytetërimi Botëror me Dashuri dhe Tolerancë; Statuja e Shpirtërave Tanë; Ese, Perspektiva, Opinione; Nga Fara te Lisi; Lëkundjet që Solli Shekulli 1-4; Nën Hijen e Besimit 1-2; Kaderi; Jeta pas Vdekjes; E vërteta e Krijimit ose Evolucionit; Penza e Thyer; Libri i Lutjeve.



FETHULLAH GYLEN



DISA PERLA URTËSIE NGA FETHULLAH GYLEN

E mira, e bukura, drejtësia dhe virtyti janë tharmi esencial i kësaj bote. Sido që të bëhet, herët a vonë, bota do të hyjë në udhë dhe askush s'do të ketë fuqi ta pengojë këtë!



FETHULLAH GYLEN

- Feja dhe shkenca e vërtetë janë si dy fytyrat e një të vërtete të vetme. Feja e shëtiti njeriun nëpër rrugë të drejta dhe e çon në përfundime të lumtura. Ndërkaq, shkenca me synim dhe qëllim të përcaktuar qartë, i bën dritë para, si një pishtar, nëpër këto rrugë dhe në fushën e vet.
- Ata që e kuptojnë lirinë si mundësi absolute veprimi, janë kah e ngatërrojnë lirinë njerëzore me lirinë shtazore. Diametralisht e kundërt me lirinë ku mbështeten zemrat e pafrë për të realizuar dëshirat e errëta të trupit, të të gjithë natyrës lëndore të njeriut, liri e cila është krejtësisht një simptomë shtazore, liria që, duke hequr pengesat para shpirtit, i hap udhë trokut të tij, është krejtësisht një simptomë njerëzore.
- Leximi, studimi dhe qëndrimi kërkues për të arritur aftësimin intuitiv janë nga ushqimet më të rëndësishme të shpirtit, kurse privimi prej këtyre është një mangësi shumë serioze, plotësimi i së cilës është i pamundur.
- Injoranca çon në krenari, kurse urtësia, në virtyt. Krenaria është fëmija bastard i injorancës, kurse virtyti, fëmija fisnik i urtësisë. Krenaria është përkrahëse e despotizmit, kurse virtyti, përkrahës i lirisë dhe i barazisë...
- Po qe se në një zemër, dashuria është e vërtetë, armiqësia është simbolike; po qe se armiqësia është e vërtetë, dashuria është simbolike. Një çelës, ky, magjik, që zbërthen shumë gjëra të vështira...
- Përgjigju të keqes me të mirë, sjelljeve të pahijshme ndaj teje mos ua var! Çdo njeri, me sjelljet e veta, karakterin e vet reflekton. Ti zgjidh rrugën e tolerancës e të mirëkuptimit dhe, përballë atyre që s'dinë se ç'është tradita dhe edukata, tregohu bujar!..
- Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim. Kurse urrejtja për çdo njeri është ose lëshim i zemrës djallit, ose një vepër marrëzie. Ti duaje njeriun, mahnitu pas njerëzores!..
- Foleja familjare e themeluar qysh në krye mbi parime të shëndosha e ku sundon lumturia materiale-shpirtërore, është guri themelor më i shëndoshë i ekzistencës si komb dhe një shkollë e bekuar ku përgatiten individë të virtytshëm e të vlefshëm. Kombet që i bëjnë shtëpitë të begatshme sa dhe shkollat dhe shkollat, të ngrohta sa dhe foletë familjare, quhet se kanë realizuar reformën më të madhe dhe kanë vënë nën garanci qetësinë dhe lumturinë e brezave të ardhshëm...
- Lartësimi ose rënia poshtë e një kombi varen nga shpirti dhe vetëdija me të cilat do të pajisen brezat e tij, nga arsimi dhe edukata që do të marrin. Në kundërshtim me faktin që kombet me brezat e rinj të përgatitur mirë, janë të paracaktuar të përparojnë paprerë, regresi i kombeve që i nënvleftësojnë ata, është i pashmangshëm!..



FETHULLAH GYLEN

■ Morali dhe ndërgjegjja, edukata dhe delikatesa janë si një monedhë që shkon në çdo vend dhe si një margaritar, vlera e të cilit nuk preket nga lëkundja e kursit të monedhës.

■ Tani nuk përgatiten më shpikës apo zbulues, por imitues. Tani ndihet nevoja e shpirtit kundërshtues e kryengritës që ta ndryshojë çdo gjë, qoftë edhe pjesërisht. Çdo gjë duhet ndërruar: libri, shkolla, klasa, banka, çdo gjë. Dhe është thelbësore të niset me kritikë...

Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim. Kurse urrejtja për çdo njeri është ose lëshim i zemrës djallit, ose një vepër marrëzie. Ti duaje njeriun, mahnitë pas njerëzores!..

■ I riu është fidani i forcës dhe i zgjuarsisë. Po qe se edukohet e mësohet, mund të bëhet një Anté, një fuqi që u premtton zemrave ndriçim e botës, harmoni...

■ Të bësh mirë është, sipas fesë dhe urtësisë, detyrë, kurse, sipas ndërgjegjes, një sjellje e denjë për miratim; të mos bësh mirë, sipas

fesë, është mëkat, sipas urtësisë, nivel i ulët moral, sipas ndërgjegjes, moskokëçarje. Disa herë, e mira mund të jetë e padobishme, madje, në një farë mase, e dëmshme, por kurrsesi s'mund të jetë e keqe. Kurse e keqja është krejt e kundërta e së mirës!

■ E mira, e bukura, drejtësia dhe virtyti janë tharmi esencial i kësaj bote. Sido që të bëhet, herët a vonë, bota do të hyjë në udhë dhe askush s'do të ketë fuqi ta pengojë këtë!

■ Duartrokitja e çdo lëvizjeje në kahun e së drejtës e të së vërtetës është shprehje respekti ndaj së vërtetës. Ata që e shohin të vërtetën të posaçme vetëm për vijën e tyre, më besoni se, jo vetëm që, pa shkuar shumë, do të izoloohen me duart e veta, por edhe në konceptimin e së vërtetës do të lëkunden vazhdimisht pa arritur dot një konkluzion përfundimtar!

■ Edhe sikur ngjyra dhe forma të ndërrojnë, rrënja nuk ndryshon, edhe sikur titulli e fama të ndërrojnë, personi nuk ndryshon. Këto kanë qenë edhe gjërat që e kanë mashtruar më shumë njeriun: ngjyra, trajta, titulli dhe fama...

■ Shkenca nuk është pronë private e askujt në botë. Ajo është trashëgimi e përbashkët e të gjithë njerëzimit.

■ Këshillimi është një rrugë e rëndësishme për t'i përfutur pakufishmëri mendjes së kufizuar dhe mendimit të kufizuar!



FETHULLAH GYLEN



PËRPPJEKJET E GYLENIT NË FUSHËN E DIALOGUT

“Dialogu ndërftetar sot përbën një domosdoshmëri dhe hapi i parë në institucionalizimin e tij, është të harruarit e së shkuarës, injorimi i argumenteve polemikë dhe dhënia përparësi e pikave të përbashkëta, të cilat do të flakin tutje polemikat e panumërta.”



FETHULLAH GYLEN

Fethullah Gylen: Kontributi në Paqen Globale dhe në Fushën e Dialogut Ndërfetar

Prof. Greg Barton, nëntor 2007, (me shkurtime)

Fjalim i mbajtur me rastin e promovimit të Katedrës "F. Gylen" në Universitetin Katolik Australian në Melburn.

Ekzistojnë shumë mënyra në lidhje me kompilimin e ideve të Gylenit dhe përshkrimin e aktivizmit të tij social. Ai është së pari dhe mbi të gjitha një *alim*, një dijetar tradicional islam, me nivel të lartë të kuptuari dhe njohurish rreth Kuranit dhe Sunetit, jurisprudencës dhe historisë islame. Ai është gjithashtu një Sufi, megjithëse nuk i përket asnjë *tarikati* të veçantë, apo ndonjë bashkësie Sufi. Burimi i tij kryesor i frymëzimit janë shkrimet e dijetarit të madh Sufi turk Said Nursi (1877-1960), autor i komentimit shumë-volumësh mjaft me peshë të Kuranit, të titulluar *Risale-i Nur*, dhe i cili vetë ishte në të njëjtën linjë me poetin e madh Xhelaledin Rumi (1207-1273). Gyleni bashkohet me Nursiun në bindjen se dialogu dhe bashkëpunimi ndërfetar ndërmjet hebrenjve, myslimanëve dhe kristianëve duhet të jetë objektivi kyç i intelektualëve bashkëkohorë. Por ndërsa Nursiu, kryesisht nëpërmjet shkrimit të *Risale Nur*, ka frymëzuar miliona pasues të cilët takohen rregullisht me njëri-tjetrin për të lexuar librat e tij, Gylen ka frymëzuar një lëvizje të gjerë sociale që merret me bamirësi fetare praktike në një shkallë të gjerë.

Kjo bamirësi mbi baza fetare, mund të konsiderohet si bosht rreth të cilit sillen tri çështje apo elemente thelbësore: dëshira e

madhe për dialog, dashuria për dije dhe pasioni për shërbimin ndaj njerëzve.

Interesi i thellë i Gylenit në fushën e dialogut, mund të dallohet lehtësisht në shkrimet dhe në veprimtarinë e tij personale. Për shembull, në shkurt 1998, Gylen u takua me Papa Gjon Palin e II-të, pasi kishte zhvilluar më parë takime me shumë prej udhëheqësve të vjetër fetarë në Turqi dhe në vendet rreth e rrotull. Grupimi më aktiv me orientim

Kjo bamirësi mbi baza fetare, mund të konsiderohet si bosht rreth të cilit sillen tri çështje apo elemente thelbësore: dëshira e madhe për dialog, dashuria për dije dhe pasioni për shërbimin ndaj njerëzve.

drejt dialogut, i cili ka të bëjë me Lëvizjen e Gylenit, është Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, i themeluar në 1994. Kjo OJQ me mjaft influencë, synon të shkojë përtej raportimeve dhe analizave gazetareske të zakonshme dhe ecën drejt mbështetjes së iniciativave publike strategjike intelektuale, në fushën e promovimit të dialogut. Një nga aktivitetet më të rëndësishme të këtij fondacioni është mbajtja e një forumi veror vjetor të një niveli të lartë përfaqësimi rreth dialogut, i njohur si Platforma e Abantit, e cila është projektuar me qëllim bashkimin e elementeve të fragmentizuara të elitës politike dhe kulturore, për të diskutuar ballë për ballë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me aspekte me peshë të rëndësishme kombëtare. Çdo Platformë e Abantit, ka



FETHULLAH GYLEN



nxjerrë nga një Deklaratë të Abantit në të cilën përmbliidhen të gjitha çështjet e diskutuara. Platforma e parë e Abantit me temë “Islami dhe Laicizmi” u mbajt në korrik 1998. Në vijim, Platforma e Abantit u mor me temat që kanë të bëjnë me “Marrëdhëniet e Fesë me Shtetin” (korrik ‘99), “Islami dhe Demokracia” (korrik ‘00) dhe “Pluralizmi” (korrik ‘01). Në prill 2004, Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, e mbajti Platformën e Abantit jashtë kufijve të Turqisë, duke e transferuar atë në SHBA dhe organizoi një forum të suksesshëm në Johns Hopkins University në Washington D.C, me temën “Islami dhe Demokracia”. Në vijim Platforma e Abantit organizoi gjithashtu mjaft takime në Evropë dhe është duke planifikuar për një seri aktivitetesh ndërkombëtare.

Dialogu Global

Në një aspekt më të zgjeruar, fakti se qysh nga viti 1983 Lëvizja GYLEN ka hapur më shumë se 500 shkolla në Turqi dhe në mbarë Azinë, Afrikën dhe Hemisferën Perëndimore, që të gjitha këto laike dhe shumë prej të cilave me vendndodhje në zona me mjerim social ekonomik, si në botën islame, ashtu edhe në atë jomuslimane, mund të shihet gjithashtu në prizmin e ushtrimit të dialogut praktik. Në mënyrë të ngjashme, rrjeti global i gazetës së suksesshme dhe me influencë të madhe *Zaman* si dhe i analogut të saj televiziv *Samanyolu TV*, me fokusimin e tyre tek objektiviteti dhe gazetaria e shëndoshë dhe profesionale, por jo me



FETHULLAH GYLEN

tendenca të dukshme fetare, përkundrazi, zbavitëse dhe edukative, mund të shihet gjithashtu si një përpjekje në fushën e dialogut

Elementi i dytë i botëkuptimit të Gylenit dhe i veprimtarisë shoqërore të lëvizjes së tij, është dashuria për dijen. Kjo mund të vërehet lehtë në shkollat e lartpërmendura. Përveç këtyre shkollave, ekziston edhe një mori kolegësh thelbësisht laikë dhe një gjysëm duzine universitetesh si Universiteti Fatih në Stamboll dhe Ankara. Këto shkolla, shumë prej të cilave e kanë vendndodhjen në disa prej zonave më të varfra dhe më në nevojë të botës, janë përgjithësisht mjaft cilësore dhe zotërojnë një standard të lartë në fushën e përfitimit të njohurive në krahasim me shkollat e tjera rreth e rrotull, meqenëse ato ndodhen në rajone dhe vende që normalisht nuk shquhen për suksese të mëdha në fushën e edukimit. Ajo çfarë i bën këto shkolla kaq të shquara në kontekstin e botës myslimane, është përpjekja e tyre në drejtim të të mësuarit modern laik, të hapur ndaj studentëve të të gjitha kategorive sociale. Këto shkolla i përmbahen me rigorozitet një kurrikulumi laik, pavarësisht vendit në të cilin funksionojnë dhe legjislacionit përkatës që ka të bëjë me edukimin fetar në shkollat e atij vendi.

Lëvizja Gylen i referohet vetvetes si *hizmet*, dhe anëtarët e saj si të angazhuar në *hizmet*. Fjala turke *hizmet* përkthehet si “shërbim” dhe për anëtarët e lëvizjes Gylen, *hizmeti* kuptohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë si fjala “filantropi”, të cilën kristianët e devotshëm e përdorin për të përshkruar aktivizmin e tyre fetar.

Shumë institucione të lidhura me Lëvizjen Gylen si gazeta Zaman dhe Samanyolu Tv, janë bërë aq të suksesshëm nga pikëpamja komerciale, saqë ato kanë qenë të afta të ecin përpara në rrugën e biznesit të rregullt. Por shumë aspekte të tjera të veprimtarisë së kësaj Lëvizjeje, si p.sh. revista *The Fountain*, mbështeten të paktën pjesërisht në kontributin e vullnetarëve. Shkollat veçanërisht, janë më së shumti produkt i aktivizmit vullnetar. Kapitali fillestar për të themeluar një shkollë të re, shpesh në zona të largëta të Afrikës apo Azisë, buron zakonisht nga bamirësia e bashkësisë së

Elementi i dytë i botëkuptimit të Gylenit dhe i veprimtarisë shoqërore të lëvizjes së tij, është dashuria për dijen.

biznesmenëve të Lëvizjes Gylen, të cilët zhvillojnë takime në një qytet apo lokalitet të caktuar. Ideja është që shkollat, të shndërrohen së fundmi në vetëfinancuese, por përpara se të ndodhë kjo, ato mund të mbështeten në mësuesit të cilët janë të gatshëm të lënë pas krahëve komoditetin e Stambollit, Izmirit apo Ankarasë dhe për të udhëtuar drejt zonave të humbura të Kazakistanit, Nigerisë apo Kamboxhias, për të shërbyer kështu në aspekte të ndryshme të edukimit si “misionarë laikë.” Ky fakt, më shumë se çdo gjë tjetër, e përshkruan më së miri nocionin e *hizmetit* apo shërbimit që karakterizon këtë Lëvizje.



FETHULLAH GYLEN

Sigurisht mund të flitet shumë më gjatë dhe më qartë rreth Fethullah Gylenit dhe Lëvizjes bamirëse që ai ka frymëzuar. Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë elemente të tjera krahas dëshirës së thellë për dialog, dashurisë për dijen dhe përpjekjeve për t'u shërbyer njerëzve. Por këto tre elementë - dialogu, dijet dhe shërbimi - përmbledhin pasione të zemrës së Gylenit. Ndaj ato e shpjegojnë më së miri, përse është zgjedhja më e përshtatshme që katedra e re e ACU për Studimet Rreth Islamit dhe Marrëdhëniet Myslimano-Katolike, duhet të emërtohet Katedra Fethullah Gylen.

Ndërkohë që kristianët dhe myslimanët përpiqen të nxisin dialogun, të thellojnë mirëkuptimin dhe të ndërtojnë marrëdhënie të ndërsjella bashkëpunimi, ne na duhet të mësohemi me idenë se jetojmë në epokën më të keqe, por edhe më të mirë të të gjitha kohërave. Ne sigurisht jetojmë në kohëra interesante, në kohëra betejash. Por sonte duhet të marrim zemër. Ky shekull i ri premton të jetë dëshmitar i shumë më tepër arritjeve në fushën e marrëdhënieve myslimano-kristiane, si dhe në atë të mirëkuptimit, të bazuar mbi njohuritë e sakta me rrënjë në Islam nga ana e kristianëve dhe shoqërive myslimane, sesa ç'ka qenë shekulli i kaluar. Lançimi i kësaj katedre në këtë universitet, unë besoj se përfaqëson diçka shumë të mirë, diçka me domethënie shumë të madhe, që shkon përtej çdo institucioni dhe përpjekjeje personale. Ky, *inshallah*, dashtë Zoti, qoftë fillimi i diçkaje të madhe.

Gylen: Dialogu Është Domosdoshmëri

Fethullah Gylen është një udhëheqës i shquar mysliman i cili nxiti dialogun ndërfaqës në nivel global. Lëvizja e frymëzuar nga idetë dhe udhëzimet e tij, është një nga grupimet kryesore që mbrojnë dhe mbështesin dialogun në botën e sotme. Fethullah Gylen, në lidhje me aspektin kyç të mesazhit të tij shprehet: "Dialogu ndërfaqës sot përbën një domosdoshmëri dhe hapi i parë në institucionalizimin e tij,

"Dialogu ndërfaqës sot përbën një domosdoshmëri dhe hapi i parë në institucionalizimin e tij, është të harruarit e së shkuarës, injorimi i argumenteve polemikë dhe dhënia përparësi e pikave të përbashkëta, të cilat do të flakin tutje polemikat e panumërta."

është të harruarit e së shkuarës, injorimi i argumenteve polemikë dhe dhënia përparësi e pikave të përbashkëta, të cilat do të flakin tutje polemikat e panumërta." Gylen gjithashtu argumenton se Kurani i nxiti myslimanët të respektojnë pasuesit e feve të tjera si dhe të pranojnë Profetët dhe Librat e mëparshëm Hyjnorë. Kështu,



FETHULLAH GYLEN

ai insiston se qëndrimet pro dialogut, nuk janë kërkesa vetëm të kohëve moderne, por edhe të burimeve të vërteta të Islamit.

Bazuar në nocionin e Islamit si fe historikisht tolerante, Gyleni mbron idenë e mirëkuptimit dhe të dialogut me bashkësitë jomyslimane. Për të mbrojtur dhe çuar përpara këtë nocion të tolerancës, ai është takuar me udhëheqës të rëndësishëm fetarë kristianë dhe hebrenj si Papa Gjon Palin e II-të (në 1998), Patriarkun Ekumenik Grek Bartholomeun (në 1996), Kreun Sefardik Rabin të Izraelit Elijahu Bakshi Doron (në 1999), si dhe me udhëheqës të tjerë fetarë të Turqisë, në shumë raste me qëllim promovimin e dialogut ndër fetar.

Shumë kohë përpara Këshillit të Dytë të Vatikanit, Bediuzzaman Said Nursi (1876-1960), një nga mendimtarët myslimanë më me influencë të shekullit të njëzetë, ka mbrojtur idenë e dialogut ndërmjet myslimanëve dhe kristianëve të vërtetë. Thirrja më e hershme e Said Nursit në lidhje me nevojën e dialogut ndërmjet myslimanëve dhe kristianëve, daton që nga viti 1911, më shumë se pesëdhjetë vjet përpara dokumentit të titulluar *Nostra Aetate* të këtij Këshilli. Çfarë motivacionesh sugjeron Fethullah Gyleni për ata të cilët dëshirojnë të ndjekin rrugën e tij, në praktikimin e dialogut dhe bamirësisë? Në fillim të një përmbledhjeje me ese të botuara nën titullin *Drejt Një Qytetërimi Global me Dashuri dhe Tolerancë*, në esenë me titull "Dashuria për qeniet njerëzore", ai përfundon me këtë thirrje:

"Meqenëse jemi që të gjithë gjymtyrë të të njëjtit trup, ne duhet ta ndalojmë këtë dualizëm i cili dhunon unitetin tonë të vërtetë. Ne duhet të pastrojmë rrugën



drejt bashkimit të njerëzve; kjo është një nga mënyrat më të mira me anë të së cilës Zoti u jep njerëzve sukses në këtë botë dhe e transformon atë në një parajsë. Vetëm në këtë mënyrë, dyert e parajsës do të hapen krejtësisht, për të na dhuruar një mirëseardhje të ngrohtë. Prandaj ne duhet të shkulim nga koka çdo ide dhe ndjenjë që na mban mënjanë dhe të rendim për të përqaftuar njëri-tjetrin. Ata të cilët ndejnë dashuri të thellë, le të vrapojnë ta përqafojnë njëri-tjetrin. Zoti hyn në dialog me gjithë njerëzimin, dhe përgjigja jonë fillon me dashurinë për Zotin dhe me dashurinë për njëri-tjetrin." Në veprën "Kriteret ose Drita e Rrugës", Gylen shkruan për dashurinë: "Dashuria është rruga më e drejtpërdrejtë dhe më e sigurt drejt përsosmërisë njerëzore." Një nga



FETHULLAH GYLEN

parimet e dialogut që Gyleni sugjeron, është përpjekja e vëllezërve të tij myslimanë, në të qenurit modest, si dhe largimin e të tjerëve nga rruga e imitimit të verbër dhe në afrimin drejt Krijuesit, gjë e cila mund të arrihet në shumë mënyra, nganjëherë edhe të paimagjinueshme: “Gjykojeni vlerën tuaj tek Krijuesi sipas vendit që Ai zë në zemrën tuaj dhe gjykojeni vlerën tuaj në sytë e njerëzve sipas mënyrës se si i trajtoni ju ata. Mos e shpërfillni të Vërtetën as edhe për një moment të vetëm. Dhe për më tepër ‘bëhuni burra apo gra të denjë në mesin e njerëzve të tjerë.’”

Për Gylenin, “ajo çfarë njerëzit kanë të përbashkët është shumë më e madhe sesa ajo që i ndan ato”; kështu që qëndrimi i tij është hyjnor: harmonia e brendshme dhe paqja për njerëzimin “do të ndodhë vetëm kur bota materiale dhe ajo shpirtërore të bashkohen.”

Për Gylenin, “ajo çfarë njerëzit kanë të përbashkët është shumë më e madhe sesa ajo që i ndan ato”; kështu që qëndrimi i tij është hyjnor: harmonia e brendshme dhe paqja për njerëzimin “do të ndodhë vetëm kur bota materiale dhe ajo shpirtërore të bashkohen.”



Për më tepër, përballë mosbesimit të përhapur gjerësisht (apo humbjes së sensit fetar), Gylen beson se dialogu myslimano-kristian është i domosdoshëm.

“Edhe pse mund të mos kemi pikëpamje të njëjta në disa çështje” thotë Gylen, *“ne të gjithë jetojmë në këtë botë dhe jemi bashkudhëtarë në të njëjtën anije. Në këtë këndvështrim, ekzistojnë shumë pika të përbashkëta, të cilat mund të diskutohen dhe të trajtohen me njerëz nga çdo segment i shoqërisë.”* Fethullah Gylen mbështet mendimin se dialogu i rregullt është thelbësor. Për këtë qëllim, ai u bë pionier i themelimit të Fondacionit të Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, aktivitetet e të cilit në promovimin e dialogut dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet njerëzve nga të gjitha sferat e shoqërisë janë mirëpritur ngrohtësisht nga njerëz të çdo fushe të jetës. Përsëri për këtë qëllim, Fethullah Gylen viziton dhe vizitohet nga figura udhëheqëse, jo vetëm nga gjiri i popullit turk, por edhe nga mbarë bota. Ambasadori i



FETHULLAH GYLEN



Vatikanit në Turqi, Patriarkët e Komunitetit Ortodoks Turk dhe Komunitetit Armen Turk, Kryerabini i Komunitetit Hebre në Turqi, por edhe opinionistë me peshë si gazetarë, editorialistë, yje të televizionit

“Dashuria është arsyeja e ekzistencës dhe thelbi i saj; ajo është fija më e fortë e cila mban të lidhura krijesat së bashku. Gjithçka në univers është vepër e Zotit.”

dhe kinematografisë, mendimtarë dhe shkrimtarë me pikëpamje të ndryshme, përbëjnë disa prej morisë së njerëzve me të cilët ai takohet vazhdimisht.

Fethullah Gylen, në mënyrë të kuptueshme, e konsideron dialogun ndërfaqetarak si një shprehje të dashurisë me frymëzim hyjnor, për shkak se e vërteta themelore teologjike e cila bashkon të gjithë njerëzit e Librit - Hebrenj, Kristianë dhe Myslimanë veçanërisht - është besimi tek Zoti si Krijues. Akti i krijimit, nuk përbën një kapriçio arbitrare, por një akt të qëllimshëm dashurie të Krijuesit për krijesat. Siç thotë Gyleni *“Dashuria është arsyeja e ekzistencës dhe thelbi i saj; ajo është fija më e fortë e cila mban të lidhura krijesat së bashku. Gjithçka në univers është vepër e Zotit.”* Dashuria vihet në zbatim me anë të veprimeve praktike dhe me anë të nivelit të marrëdhënieve të ndërsjella midis njerëzve me besime të ndryshme fetare; ajo paraqitet në termat e angazhimit në fushën e dialogut, prandaj *“dialogu është barriera e vërtetë për terrorin, kaosin dhe intolerancën.”*



FETHULLAH GYLEN

Terrorizmi Nuk Përputhet Me Islamin

M. Fethullah Gylen

Sot, më e pakta që mund të themi, është se Islami nuk njihet nga të gjithë. Myslimanët duhet të deklarojnë: "Në Islam nuk ka terrorizëm!" Në Islam, vrasja e një njeriu është një akt i barabartë për nga rëndësia me mosbesimin. Asnjë person nuk mund të vrasë një krijesë njerëzore. Asnjë person nuk mund ta ngacmojë një person tjetër të pafajshëm, edhe në kohë lufte.

Asnjë person nuk mund të japë një fetva për këtë çështje. Asnjë person nuk mund të jetë një kamikaz. Asnjë person nuk mund të vrapojë mes turmave me njerëz, me bomba lidhur në trupin e tij. Pakujdesia e treguar ndaj fesë së njerëzve në këto turma, nuk është nga ana fetare e lejueshme. Edhe në kohë lufte - gjatë së cilës është e vështirë të mbash balancat - kjo nuk është e lejuar në Islam. Islami deklaron: "Mos prekni fëmijët ose njerëzit që luten në kisha!" Kjo nuk është thënë vetëm një herë, por është përsëritur vazhdimisht gjatë gjithë historisë. Ç'thoshte mësuesi ynë, profeti Muhamed, ç'thoshte Ebu Bekri dhe Omeri, është e njëjtë me çfarë kanë thënë gjithashtu në kohët e mëvonshme Salahudin Ejubi, Allparslani dhe Fatihu.

Por sot, Islami, si në çdo pikë tjetër, nuk është kuptuar saktë. Islami gjithmonë ka respektuar idetë e ndryshme dhe kjo duhet kuptuar për të pasur një vlerësim të saktë. Me keqardhje konstatojmë që në vendet ku jetojnë myslimanët, disa udhëheqës fetarë dhe myslimanë të papjekur nuk kanë armë tjetër në duar veç interpretimit fundamentalist të tyre për Islamin. Ata e shfrytëzojnë këtë për të hedhur njerëzit në luftëra që u shërbejnë interesave të tyre.

Në fakt, Islami është një besim i vërtetë dhe duhet jetuar besnikërisht. Në rrugën për arritjen e besimit nuk mund të përdoren kurrë metoda të rreme. Në Islam, ashtu siç një qëllim mund të jetë i ligjshëm, po ashtu duhet të jenë të gjithë mjetet që përdoren

për ta arritur atë. Nga kjo perspektivë, askush nuk mund ta fitojë parajsën duke vrarë një person tjetër. Një mysliman nuk mund të thotë: "Unë do të vras një njeri dhe kështu do të shkoj në parajsë." Pëlqimi i Zotit nuk mund të fitohet duke vrarë njerëz.

Sot nuk ka një botë islame. Sot Islami është individual. Myslimanët janë në vende të ndryshme të botës. Meqenëse nuk ka një botë islame, gjithsecili vepron individualisht. Madje mund të thuhet që disa myslimanë kanë bindjet e tyre personale. Nuk mund të deklarohet që ka një konceptim islam i cili ka qenë sipas marrëveshjes i aprovuar nga studiues të kualifikuar, mbështetur me besimin në Kuran dhe i testuar në mënyrë të përsëritur. Më saktë, mund të thuhet që është mbizotëruese një kulturë myslimane, sesa një kulturë islame.

Osama Bin Laden është një prej njerëzve që urrej më shumë në botë, sepse ai ka nxirë pamjen e ndritshme të Islamit. Ai ka krijuar një imazh të njollosur. Edhe nëse ne përpiqemi me më të mirën tonë për të rregulluar dëmin e tmerrshëm që ai ka sjellë, do të duhen shumë vite për ta korrigjuar. Ne flasim rreth kësaj mbrapshtie kudo, në shumë tribuna të ndryshme, shkruajmë libra për të, themi: "Ky nuk është Islam". Bin Laden zëvendëson logjikën islame me ndjenjat dhe dëshirat e tij. Ai është një mostër, siç janë edhe njerëzit përreth tij. Nëse njerëzit ngado janë të ngjashëm me të, atëherë ata gjithashtu, nuk janë asgjë më shumë se mostra.

Një mysliman i vërtetë që e ka kuptuar Islamin në çdo aspekt, nuk mund të jetë terrorist. Është e vështirë për një person që të mbetet mysliman nëse ai është përfshirë në terrorizëm. Kurani e konsideron vrasjen e një njeriu si vrasjen e gjithë njerëzimit, sepse për vrasësin e një njeriu është e pranueshme ideja se çdo person tjetër mund të vritet. Islami nuk e pranon terrorizmin në asnjë formë. Terrorizmi nuk mund të përdoret për të arritur ndonjë qëllim islam. Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman i vërtetë nuk mund të jetë terrorist...



FETHULLAH GYLEN



EDUKIMI DHE RËNDËSIA E TIJ

M. Fethullah GYLEN

Para së gjithash, edukimi përbën një shërbim njerëzor, sepse ne jemi dërguar këtu për të mësuar dhe për t'u përsosur si qenie përmes edukimit.



FETHULLAH GYLEN

Përse edukimi?

Shumë gjëra janë thënë dhe shkruar në lidhje me edukimin. Ne do ta trajtojmë këtë subjekt nga tre këndvështrime të ndërlidhura: në atë human-psikologjik, kombëtar-social si dhe në atë universal.

Ne kemi qenë nën ndikimin serioz të shkollave bashkëkohore perëndimore të mendimit, të cilat padyshim zotërojnë shumë aspekte superiore që prej disa shekujsh. Megjithatë, ato përmbajnë edhe disa pika të dobëta, që burojnë veçanërisht nga periudha historike në të cilën kanë

Lëvizjet iluministe, të nisura në shekullin e tetëmbëdhjetë, i shikonin qeniet njerëzore vetëm si mendje. Në të njëjtën mënyrë, edhe lëvizjet pozitiviste dhe materialiste, i shikonin ato vetëm si tërësi materiale apo trupore

lindur, si dhe konditat e veçanta të krijimit të tyre. Në Mesjetë, kur Evropa jetonte nën sundimin teokratik të vendosur nga Kisha, apo monarkët e mbështetur nga Kisha, ajo ra në kontakt me botën islame, veçanërisht nëpërmjet Andaluzisë dhe Kryqëzatave. Krahas faktorëve të tjerë, kjo gjë i hapi derën Rilindjes Evropiane dhe Lëvizjeve Reformiste. Sëbashku me faktorë të tjerë të tillë si territori i pamjaftueshëm, varfëria,

nevojat në rritje si dhe orientimi i disa shteteve ishuj si Anglia drejt transportit detar, ky faktor çoi në zbulime gjeografike transdetare dhe transoqeanike.

Objektivi parësor i të gjithë këtyre zhvillimeve, ishte plotësimi i nevojave materiale. Meqenëse studimet shkencore të cilat shërbenin për këtë qëllim, kryheshin në kundërshtim me Kishën dhe Skolasticizmin kristian mesjetar, evropianët u ballafaquan me një konflikt të ashpër shkencë-fe. Kjo bëri që feja të largohej nga shkenca dhe shumë njerëz t'i prishnin marrëdhëniet me fenë. Një zhvillim i tillë, eventualisht çoi në materializëm dhe komunizëm. Në gjeografinë sociale, njerëzimi u ballafaqua me elementet më të ashpër të historisë perëndimore, si shfrytëzimi global, konfliktet e pafundme me bazë interesash, dy luftëra botërore, si dhe ndarjen e botës në blloqe.

Perëndimi e ka mbajtur botën nën kontrollin e vet ekonomik dhe ushtarak, për shekuj me radhë. Gjatë shekujve të fundit, konflikti shkencë-fe në Perëndim, ka zënë një hapësirë të madhe në shume qarqe të ndryshme intelektuale.

Lëvizjet iluministe, të nisura në shekullin e tetëmbëdhjetë, i shikonin qeniet njerëzore vetëm si mendje. Në të njëjtën mënyrë, edhe lëvizjet pozitiviste dhe materialiste, i shikonin ato vetëm si tërësi materiale apo trupore. Si rezultat, krizat shpirtërore kanë pasuar njëra-tjetrën. Nuk e teprojmë po të themi se këto kriza si dhe mospërmbushja e kënaqësive shpirtërore, qenë faktorët madhorë që çuan në konfliktet e interesave, të lindura gjatë dy shekujve të fundit dhe që kulmuan me dy luftëra botërore.



FETHULLAH GYLEN

Si zotërues të një sistemi besimi me një histori dhe thelb të ndryshëm, ne kemi disa gjëra bazë për t'i dhënë Perëndimit, me të cilin kemi marrëdhënie të ngushta ekonomike, sociale e madje edhe ushtarake, por njëkohësisht edhe gjithë njerëzimit. Në krye të tyre, është botëkuptimi dhe këndvështrimi ynë për njerëzimin. Aktualisht, ky këndvështrim nuk është as ekskluzivitet i yni e as nuk është i karakterit subjektiv; përkundrazi, ai është një këndvështrim objektiv, i cili i jep përgjigje pyetjes se çfarë janë në të vërtetë burrat apo gratë.

Një njeri, nuk është vetëm një krijesë e ndërtuar prej trupit, mendjes, ndjenjave apo shpirtit; përkundrazi, ai ose ajo është një strukturë harmonike e të gjitha këtyre elementeve së bashku. Një njeri, është një trup që përpëlitet në një rrjetë nevojash. Ai ose ajo, është gjithashtu një mendje, e cila ka më tepër brishtësi dhe nevoja jetësore sesa trupi dhe është e mbushur me ankthe rreth së shkuarës dhe së ardhmes, duke u përpjekur kështu vazhdimisht t'u japë përgjigje pyetjeve të tilla si: "Çfarë jam unë? Çfarë është kjo botë? Çfarë duan jeta dhe vdekja nga unë? Kush më dërgoi mua në këtë botë dhe me çfarë qëllimi? Ku po shkoj dhe cili është qëllimi i jetës? Kush është udhërrëfyesi im në këtë udhëtim të kësaj bote?"

Për më tepër, çdo njeri është një krijesë me ndjenja, të cilat nuk mund të kënaqen nga mendja, dhe një krijesë e shpirtit, nëpërmjet të cilit ai ose ajo, fiton identitetin thelbësor human të tij apo të saj. Një individ është të gjitha këto së bashku. Kur një burrë apo një grua rreth të cilit sillen çdo sistem apo përpjekje, merret në konsideratë dhe

vlerësohet si një krijesë e përbërë nga të gjitha aspektet e lartpërmendura së bashku, si dhe kur të gjitha nevojat e tij apo të saj përmbushen plotësisht, ai ose ajo do të jetë në gjendje të arrijë lumturinë e vërtetë. Në këtë pikë, progresi i vërtetë njerëzor dhe angazhimi në marrëdhënie me qenien tonë thelbësore, bëhet i mundur vetëm me anë të edukimit.

Për ta kuptuar siç duhet domethënien e edukimit, vëreni vetëm një nga ndryshimet ndërmjet nesh dhe kafshëve. Në fillim të udhëtimit nga bota e shpirtave e cila shtrihet drejt përjetësisë në stadin e kësaj bote, ne jemi të dobët, jemi njerëz në nevojë dhe në një pozicion të mjerueshëm, ku çdo gjë e presim nga të tjerët. Ndërsa kafshët, vijnë në këtë botë apo dërgohen këtu, sikur të kenë arritur përsosmërinë qysh më

Progresi i vërtetë njerëzor dhe angazhimi në marrëdhënie me qenien tonë thelbësore, bëhet i mundur vetëm me anë të edukimit.

përpara, në një botë tjetër. Brenda dy orëve, dy ditëve apo dy muajve pas lindjes së tyre, ata mësojnë çdo gjë që duhet të dinë, lidhjet e tyre me universin dhe ligjet e jetës si dhe zotërojnë mjeshhtëri në shumë aspekte. Nga ana tjetër, forca për të jetuar dhe aftësia për të punuar të cilat ne na duhet rreth njëzet vjet t'i mësojmë, arrihen nga një harabel apo një bletë, vetëm në njëzet ditë jetë. Më saktë, këto krijesa janë të frymëzuara me këto veçori.



FETHULLAH GYLEN

Nga ana tjetër, ne duhet të mësojmë gjithçka kur vijmë në këtë botë, për arsye se ne jemi injorantë në lidhje me rregullat e jetës. Në fakt, në njëzet vjet apo ndoshta edhe përgjatë gjithë jetës sonë, ne nuk jemi në gjendje plotësisht të mësojmë mbi natyrën dhe domethënien e rregullave dhe kushteve jetësore, apo rreth lidhjeve tona me universin. Ne jemi dërguar këtu në një gjendje fillestare mjaft të dobët dhe pa ndihmë. Për shembull, ne mund të qëndrojmë në këmbë vetëm pas një ose dy vitesh. Për më tepër, neve na duhet pothuajse gjithë jeta për të kuptuar se çfarë është në të vërtetë në interesin tonë dhe çfarë nuk është. Vetëm me ndihmën e jetës shoqërore, ne mund të orientohemi drejt interesave tona dhe të shmangim rreziqet.

Kjo do të thotë se detyra jonë thelbësore, si krijesa të ardhura në këtë botë kalimtare si mysafirë me një natyrë të pastër, është të arrijmë stabilitetin dhe qartësinë në mendime, imagjinatë dhe besim, në mënyrë që të mund të fitojmë një “natyrë të dytë” dhe kualifikimin e nevojshëm për ta vazhduar jetën tonë në “botë të tjera shumë më të përsosura.” Madje, nëpërmjet kryerjes së detyrimeve tona si shërbëtorë, ne kemi për detyrë t’i bëjmë zemrat dhe shpirtrat tanë të funksionojnë siç duhet dhe të aktivizojnë të gjithë potencialet e tyre të brendshme. Duke përqafuar botët tona të brendshme dhe të jashtme, të mbushura me mistere dhe enigma të panumërta, ne duhet të kuptojmë siç duhet sekretin e ekzistencës dhe të rrisim kështu nivelin e njerëzimit të vërtetë.

Së dyti, konflikti fe-shkencë dhe produkti i tij, materializmi, e kanë parë natyrën por

edhe njerëzimin si një grumbull materialesh, të krijuara vetëm për të përmbushur nevojat fizike. Si rezultat i kësaj, ne po përjetojmë sot një katastrofë ambientale globale.

Mendoni: Një libër përbën një paraqitje materiale nëpërmjet fjalëve të ekzistencës së tij “shpirtërore” në mendjen e autorit. Nuk ekziston asnjë konflikt ndërmjet këtyre dy rrugëve të të shprehurit të së njëjtës së vërtetë dhe përmbajtjes së materialit në dy “botë” të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, një ndërtesë posedon një lloj ekzistence shpirtërore në mendjen e arkitektit, një “fat apo paracaktim” në formën apo planin e saj si dhe ekzistencën e saj në formën e një objekti material. Nuk ka asnjë konflikt ndërmjet këtyre tre botëve të ndryshme të të shprehurit të së njëjtit fenomen, përmbajtjeje, kuptimi apo të vërtete. Të

Konflikti fe-shkencë dhe produkti i tij, materializmi, e kanë parë natyrën por edhe njerëzimin si një grumbull materialesh, të krijuara vetëm për të përmbushur nevojat fizike.

kërkuarit për konflikt në këtë rast, nuk është asgjë tjetër, veçse një përpjekje e kotë.

Në të njëjtën mënyrë, nuk ekziston asnjë konflikt ndërmjet Kuranit, Shkrimeve të Shenjta, universit dhe shkencave të cilat i studiojnë ato. Universi përbën një Kuran të



FETHULLAH GYLEN

fuqishëm, që buron nga Cilësia e Fuqisë dhe Vullnetit të Zotit. Me fjalë të tjera, nëse termi është i duhuri, ai përbën një Kuran të madh të krijuar. Nga ana tjetër, duke qenë një shprehje e ligjeve të universit në një formë të ndryshme, Kurani përbën në vetvete një univers të veçantë, i cili është kodifikuar

Shkurt, tre armiqtë tanë më të mëdhenj janë injoranca, varfëria si dhe përçarjet e brendshme.

dhe hedhur në letër. Në kuptimin e saj të vërtetë, feja as nuk e kundërshton dhe as nuk e kufizon shkencën dhe veprimtarinë shkencore.

Sot ekzistojnë mjaft pretendime se feja është e ndashme, duke i hapur kështu rrugën vrasjes së njerëzve të tjerë. Megjithatë, askush nuk mund të mohojë se nuk është feja e veçanërisht Islami, ajo që i ka çuar gjatë shekujve të fundit njerëzit drejt shfrytëzimit të pashpirt dhe as nuk ka qenë ajo shkaktarja që, veçanërisht gjatë shekullit të njëzetë, u përjetuan luftëra dhe revolucione, në të cilat u vranë qindra milionë njerëz, duke lënë pas rrjedhimisht një numër edhe më të madh të pastrehësh, grash të veja, fëmijësh jetimë dhe të gjymtuarish. Materializmi shkencor, i cili përbën një mënyrë jetese dhe mendimi që është distancuar nga feja, si dhe përplasia e interesave, kanë qenë shkaktarët e këtij shfrytëzimi të paskrupullt.

Shërbimi ndaj njerëzimit me anë të edukimit

Një problem që ka lidhje me këtë çështje, po e paraqesim më poshtë. Në mesin e njerëzve ekziston një thënie: “Fqinji ka nevojë edhe për hirin e fqinjit të tij.” Nëse ju nuk keni hi që i nevojitet të tjerëve, askush nuk do t’ju vlerësojë. Siç theksuam më lart, ne kemi shumë më tepër për t’i dhënë njerëzimit, sesa për të marrë prej tij. Sot, organizatat vullnetare apo joqeveritare, kanë themeluar kompani dhe fondacione, të cilat po i shërbejnë të tjerëve me shumë entuziazëm. Pranimi në masë i institucioneve edukative të përhapura në gjithë botën, pavarësisht vështirësive të mëdha financiare me të cilat ato janë ballafaquar, si dhe konkurrenca me homologët e tyre perëndimorë dhe parakalimi i tyre në një periudhë mjaft të shkurtër kohore, janë vërtetim i faktit se ato çfarë thamë nuk mund të mohohen.

Shkurt, tre armiqtë tanë më të mëdhenj janë injoranca, varfëria si dhe përçarjet e brendshme. Dija, kapitali i fituar nëpërmjet punës dhe bashkimi, mund t’i luftojnë këto fenomene negative. Meqenëse injoranca përbën problemin më serioz, ne duhet ta luftojmë atë me anë të edukimit. Edukimi ka qenë gjithmonë mjeti ynë më i rëndësishëm për t’i shërbyer atdheut tonë. Tani që jetojmë në një fshat të globalizuar, edukimi përbën mënyrën më të mirë për t’i shërbyer njerëzimit si dhe për të vendosur dialogun me qytetërimet e tjera.

Por para së gjithash, edukimi përbën një shërbim njerëzor, sepse ne jemi dërguar këtu për të mësuar dhe për t’u përsosur si genie përmes edukimit. Me thënien e tij



FETHULLAH GYLEN

“Në të ardhmen njerëzimi do të kthehet drejt dijes e shkencës dhe arsyeja e fjala do të qeverisë botën,” Bediuzzamani ka nxitur dijen dhe dialogun.

Nën dritën e këtyre parimeve, unë i nxis njerëzit që nëpërmjet edukimit t'i shërbejnë atdheut në veçanti dhe njerëzimit në përgjithësi. Unë u bëj thirrje atyre të ndihmojnë sistemin edukativ shtetëror dhe të rrisin nivelin e njerëzve duke hapur shkolla. Injoranca mposhtet vetëm nëpërmjet edukimit, varfëria nëpërmjet punës dhe grumbullimit të kapitalit, dhe ndarjet dhe përçarjet e brendshme

Injoranca mposhtet vetëm nëpërmjet edukimit, varfëria nëpërmjet punës dhe grumbullimit të kapitalit, dhe ndarjet dhe përçarjet e brendshme nëpërmjet unitetit, dialogut dhe tolerancës.

nëpërmjet unitetit, dialogut dhe tolerancës. Megjithatë, ashtu siç çdo problem që ka të bëjë me natyrën njerëzore varet krejtësisht nga përpjekjet e vetë njerëzve, edhe edukimi varet nga përpjekjet e tyre dhe përbën mjetin më efikas, pavarësisht nëse kryejmë veprimtarinë tonë në një sistem politik apo shoqëror të paralizuar, apo në një sistem i cili funksionon me një saktësi kronometrike.

Gyleni si Edukator



Dr. Thomas Michel, Universiteti Georgetown, prill 2000

Unë kam ardhur për të njohur së pari institucionet edukative të drejtuara nga pjesëmarrësit e lëvizjes së udhëhequr nga Fethullah Gylen. Kjo më ka shtyrë që të studioj shkrimet e tij për të zbuluar racionalitetin që shtrihet pas iniciativës edukative që rrjedh nga vizioni edukativ i Fethullah Gylenit dhe kolegëve të tij.

Në fillim është e nevojshme të saktësohet lidhja e z. Gylen me shkollat që shpesh në mënyrë të pakontrolluar cilësohen “shkollat e Gylenit” ose “shkollat e Lëvizjes së Gylenit.” Z. Gylen para së gjithash e përshkruan veten si një edukator. Ndërkaq, ai është i kujdesshëm të bëjë dallimin në mes edukimit dhe mësimdhënies. “Shumë njerëz mund të jenë mësues,” deklaroi ai, “por numri i edukatorëve është shumë i kufizuar.”

Ai përpiket gjithashtu që të jetë i qartë lidhur me faktin që nuk ka shkolla në pronësi të tij. “Unë jam lodhur duke thënë që nuk kam ndonjë shkollë”, pohon ai, paksa i pezmatuar. Shkollat janë krijuar nga marrëveshje reciproke midis vendeve në të cilat ato janë hapur, dhe nga kompani edukative të themeluara për këtë qëllim. Çdo shkollë është një institucion i pavarur, por shumë prej tyre mbështeten në shërbimet e kompanive turke për të siguruar subvencionet edukative dhe burimet njerëzore.



FETHULLAH GYLEN

Takimi im i parë me një nga këto shkolla daton në vitin 1995 në Zamboanga, ishulli Mindanao në jug të Filipineve, kur unë mësova që ishte një shkollë "turke" disa kilometra jashtë qytetit. Ajo që të bën më shumë përshtypje sapo vështron shkollën, është një tabelë e madhe në hyrje të saj: "Shkolla Filipino-Turke e Tolerancës." Kjo është një thënie e habitshme në Zamboanga, një qytet ku 50% e përbëjnë krishterët dhe 50% myslimanët, dhe që bën pjesë në një zonë ku për 20 vjet lëvizjet e ndryshme

Ndërkaq, ai është i kujdesshëm të bëjë dallimin mes edukimit dhe mësimdhënies. "Shumë njerëz mund të jenë mësues," deklaron ai, "por numri i edukatorëve është shumë i kufizuar."

separatiste Moro (myslimane) luftojnë kundër forcat militare qeveritare filipinase. Shkolla është duke u ofruar fëmijëve filipinas myslimanë dhe të krishterë standarde edukative të një niveli të lartë dhe një rrugë më pozitive për të jetuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin në një regjion ku rrëmbimi i personit dhe marrja peng është diçka e zakonshme së bashku me luftën civile, grabitjet, arrestimet, zhdukjet dhe vrasjet

nga forcat militare dhe paramilitare. Kolegët e mi jezuitë dhe profesorët e Ateneo de Zamboanga konfirmojnë se, që nga hapja e saj, Shkolla Filipino-Turke e Tolerancës i ka mbajtur në një nivel të lartë kontaktet dhe kooperimin me institucionet krishtere të regjionit.

Që atëherë unë kam patur rastin të vizitoj edhe shkolla të tjera dhe të diskutoj politikën edukative me stafin mësimor dhe administrues. Vështirësia ose cilësia e lartë e programeve të tyre arsimore në shkenca, informatikë dhe gjuhë është tregues i suksesit të përsëritur në olimpiadat akademike.

Unë kam kërkuar të gjej një përmbajtje më islame në programin shkollor dhe mjedisin fizik, por kjo nuk ishte e vërtetë. Kur unë pyeta rreth mungesës së habitshme që për mua do të jetë një pjesë e kuptueshme e një projekti edukativ të frymëzuar nga ndjenjat fetare, mu shpjegua se për shkak të natyrës pluraliste të trupës studentore – të krishterë dhe myslimanë në Zamboanga dhe, budist dhe hindu në Kirgistan - çfarë ata kërkonin të transmetonin ishin vlerat universale të tilla si nderi, puna e ndershme, harmonia dhe shërbimi i ndërgjegjshëm më shumë se një shkollim konfensional.

Këto takime rastësore më bënë që të studioj shkrimet e Fethullah Gylenit për të vërtetuar principet edukative dhe motivimin ku mbështeteshin shkollat dhe për të gjetur metodat e Gylenit që e kanë bërë atë një edukator të aftë për të inspiruar të tjerët me vizionin e tij.



FETHULLAH GYLEN

Vizioni edukativ i Fethullah Gylenit

Në dekadat pas krijimit të Republikës Turke, shumë myslimanë turq kanë kritikuar programin “e modernizuar” të ndërmarrë nga qeveritë për adoptimin qorrazi të anëve më pozitive dhe negative të qytetërimit europian. Ata e kanë parë laicizmin jo thjesht si një produkt të paqëllimshëm të procesit laicist, por më shumë si një rezultat të vetëdijshëm të një tendencioziteti antifetar. Prezumimin e heshtur që qëndron në themel të reformave modernizuese, ata e shohin si një bindje ideologjike që feja është një pengesë për progres dhe duhet të lihet jashtë sferës publike të shoqërisë, ekonomisë dhe politikës nëse një komb

Të shkëputur nga vlerat tradicionale, të rinjtë janë në rrezikun e të qenit të edukuar me antivlerat që gjenden pas çdo arritjeje materiale.

është duke ecur përpara. Linjat e betejës së filluar përgjatë dekadave pas krijimit të republikës dhe të përforcuara reciprokisht nga sistemet konkurruese të edukimit e kanë bërë debatin midis fesë dhe laicizmit një terren ku çdo studiues dhe mendimtar pritet të deklarojë besnikërinë e tij.

Në opinionin tim, një prej arsyeve që Fethullah GYLEN ka qenë shpesh i sulmuar në Turqi nga të “dijathtët” dhe të “majtët” nga “laicistët” dhe “fetarët”, është pikërisht fakti që ai ka refuzuar të përfshihet në një çështje

të cilën ai e vlerëson si një rrugë pa krye. Në vend të saj ai propozon një rrugë në të cilën ne shpresojmë të lëmë pas debatet e shkuara. Zgjidhja e Gylenit nuk synon të afirmojë qëllimin e paramenduar të modernizimit të shpallur nga Republika Turke, por të tregojë që një proces modernizues efektiv i vërtetë duhet të përfshijë përparimin e të tërë njerëzve. Në fushën edukative ai duhet të ketë prioritetin kryesor në rrymat e shumta ekzistuese të edukimit dhe t’i ndërtojë ato me një formë të re edukative që do t’u japë përgjigje kërkesave të ndryshme të botës së sotme.

Kjo është shumë ndryshe nga projektet reacionare që kërkojnë të rigjallërojnë ose të kthejnë të kaluarën. Duke mohuar që edukimi i ofruar në shkollat që lidhen me emrin e tij është një përpjekje për të kthyer sistemin otoman ose për të rivendosur kalifatin, GYLEN vazhdimisht afirmon: *“Nëse nuk përshtatemi me kushtet e reja, rezultati do të jetë zhdukja.”*

Pavarësisht nga nevoja e modernizimit, ai megjithatë vlerëson rreziqet që përfshihen në çdo prishje radikale me të kaluarën. Të shkëputur nga vlerat tradicionale, të rinjtë janë në rrezikun e të qenit të edukuar me antivlerat që gjenden pas çdo arritjeje materiale. Vlerat jomateriale të tilla si thellësia e ideve dhe e ndjenjave, qartësia e mendimit, ngritja kulturore ose interesi për jetën shpirtërore kanë tendencën që të injorohen në iniciativat edukative moderne të cilat janë përgjithësisht të fokusuara në prodhimin në seri të funksionarëve për një sistem tregu global.

Studentët e tillë mund të jenë përgatitur mjaftueshëm për të gjetur punë, por ata nuk kanë formimin e brendshëm të



FETHULLAH GYLEN

nevojshëm për të arritur lirinë e vërtetë njerëzore. Drejtuesit e fushave ekonomike dhe politike shpesh favorizojnë dhe nxisin arsimin e përqendruar tek profesioni dhe të mangët nga vlerat, sepse kjo u mundëson atyre që kanë në dorë pushtetin që t'i kontrollojnë më lehtë shtresat "e trajnuara por jo të edukuara". Gylen thotë "që për t'i mbajtur nën kontroll masat mjafton që t'i privosh ata nga dija. Kësaj tiranie ata mund t'i shpëtojnë vetëm nëpërmjet arsimimit. Rruga drejt drejtësisë sociale është e shtruar me gurët e arsimit dhe edukimit të drejtë e universal pasi vetëm kjo mund t'u japë njerëzve mirëkuptimin dhe tolerancën e mjaftueshme për t'i respektuar të drejtat e të tjerëve". Pra, sipas Gylenit, mungesa e një arsimit të kompletuar është pengesë jo vetëm ndaj vënies së drejtësisë, por edhe ndaj njohjes së të drejtave të njeriut dhe qëndrimit të hapur e tolerant ndaj të

"Rruga drejt drejtësisë sociale është e shtruar me gurët e arsimit dhe edukimit të drejtë e universal pasi vetëm kjo mund t'u japë njerëzve mirëkuptimin dhe tolerancën e mjaftueshme për t'i respektuar të drejtat e të tjerëve".

tjerëve. Nëse njerëzit do të edukoheshin në mënyrë që të ishin të aftë për të menduar lirshëm dhe për të përqafuar vlerat e drejtësisë sociale, të drejtat e njeriut dhe tolerancën, ata do të bëheshin pionierët e ndryshimit për t'i vënë në jetë këto qëllime fisnike.

Nëse flitet për realizimin e reformës arsimore, përgatitja e mësuesve është një çështje që nuk mund të lihet mënjanë. Gyleni thotë që "edukimi është tjetër e, mësimdhënia, tjetër. Shumica e njerëzve mund të bëhen mësues, por numri i edukatorëve është tejet i kufizuar." Ndryshimi midis këtyre koncepteve qëndron në atë që edhe mësuesi, edhe edukatori përcjellin dije dhe mjeshtëri, por edukatori është ai i cili ka aftësinë t'i ndihmojë nxënësit e tij në krijimin e personalitetit, të ushqejë mendimin dhe reflektimin tek ai, t'i forcojë karakterin dhe t'i bëjë të mundur atij të përvetësojë cilësitë e vetëdisiplinimit, tolerancës dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Ata të cilët japin mësim thjesht për të marrë rrogën e pa u interesuar për formimin e karakterit të nxënësit, ai i cilëson si "të verbrit që u prijnë të verbërve."

Mungesa e koordinimit dhe e ndërthurjes midis sistemeve arsimore konkurruese dhe reciprokisht të kundërta ka çuar në atë që Gyleni e quan "një konflikt i hidhur që nuk duhej të kish ndodhur: shkenca kundër fesë." Ky dyzim që në fakt nuk ekziston dhe i cili gjatë shekujve të 19-të dhe 20-të shtrydhi energjitë e dijetarëve, politikanëve dhe liderëve fetarë nga të dyja palët, rezultoi në një bigëzim të filozofive e metodave arsimore. Arsimtarët modernë sekularistë në rastin më të mirë e shohin fenë si një harxhim i panevojshëm kohe dhe në më të keqin, si pengesë ndaj zhvillimit. Midis dijetarëve fetarë ky debat çoi në refuzimin e modernitetit dhe në konceptimin e fesë "më shumë si një ideologji politike se sa në sensin dhe funksionin e saj të vërtetë." Ai ndjen se vetëm përmes një procesi arsimor, ku studiuesit e fesë të kenë një formim të lartë shkencor dhe shkencëtarët të jenë të hapur ndaj vlerave fetare dhe shpirtërore,



FETHULLAH GYLEN

është e mundur që *“konflikti i gjatë shkencëfe të marrë fund ose që të kuptohet absurditeti i tij!”*

Që kjo të ndodhë, ai mendon se është e domosdoshme një mënyrë e re arsimimi e cila *“t’i ndërthurë dijet fetare e shkencore me moralin dhe anën shpirtërore për të nxjerrë në dritë njerëz autentikë e të iluminuar, me zemër të ndriçuar nga shkencat fetare e shpirtërore dhe mendjen nga ato pozitive,”* njerëz të përkushtuar ndaj të jetuarit sipas cilësive humane dhe vlerave morale të cilët gjithashtu janë *“në dijeni të kushteve social-ekonomike e politike të kohës.”*


Në shkrimet e Gylenit shfaqen shumë terma të përsëritura mbi arsimimin të cilat duhet të sqarohen për të mos shkaktuar keqkuptime. E para është *ana shpirtërore* dhe *vlerat shpirtërore*. Disa këtë mund ta kuptojnë si një emërtim të koduar për *“fenë”* të përdorur për t’u dalë para paragjykimëve ndaj fesë në shoqëritë sekulariste moderne, por është e qartë se Gyleni e përdor këtë term në një kuptim më të gjerë. Sipas tij, ana shpirtërore përfshin jo vetëm mësimet fetare por edhe etikën, logjikën, shëndetin psikologjik dhe çiltërsinë emotive. Terma kyçe në shkrimet e tij janë *dhembshuria* dhe *toleranca*. Është detyra e edukatorëve që, përveç disiplinave *“ekzakte”*, të ngulisin tek nxënësit e tyre të tilla cilësi *“të paçmuara”*.

Gjithashtu është e nevojshme që të ekzaminohen edhe termat e tjerë që Gyleni i përdor vazhdimisht. Ai shpesh herë flet për nevojën e vlerave *kulturore* dhe *tradicionale*. Thirrja e tij për paraqitjen e vlerave kulturore dhe tradicionale në edukim është interpretuar nga kritikët si një thirrje reaksionare që synon rikthimin tek shoqëria otomane

pararepublikane. Ai ka qenë akuzuar si një arkaik, akuzë që Gyleni gjithmonë e ka mohuar. Për të mbrojtur pozicionin e tij, ai deklaroi: *“Fjala arkaik do të thotë kthim tek e kaluara ose mbartje e së kaluarës tek e sotmja. Unë jam një person të cilit jo vetëm e nesërmja, por edhe amshueshmëria i është marrë si një qëllim. Unë jam duke menduar për të ardhmen e vendit tim dhe po përpiqem të bëj atë që është e mundur për mua. Shkrimet, ligjëratat dhe aktivitetet e mia kurrë nuk kanë synuar që ta rikthejnë prapa vendin tim. Por askush nuk mund t’i etiketojë si arkaikë besimin në Zot, adhurimin, vlerat morale dhe çështjet e tjera që i përkasin kësaj fushe të pakufizuar nga koha.”*

Vizioni i tij edukativ përfshin të gjithë shoqëritë anembanë botës. Ai dëshiron të edukojë reformatorët, që do të thotë, ata që janë fortifikuar me një sistem vlerash që marrin parasysh aspektet fizike dhe jomateriale të njeriut. Gyleni shprehet: *“Ata që duan të reformojnë botën, duhet së pari të reformojnë vetveten. Me qëllim që t’i sjellin të tjerët në udhën për një botë më të mirë, ata duhet të pastrojnë botën e tyre të brendshme nga urrejtja, smira, xhelozia dhe të zbukurojnë botën e tyre të jashtme me të gjitha llojet e virtyteve. Ata që janë larg nga vetëkontrolli dhe vetëdisiplina, që nuk arrijnë të fisnikërojnë ndjenjat e tyre, mund të duken në fillim tërheqës dhe të ditur, ndonëse nuk janë të aftë që të frymëzojnë të tjerët në ndonjë rrugë permanente dhe sentimentet që ata zgjojnë shpejt do të zhduken.”*

Gyleni deklaroi: *“Një person është një njeri i vërtetë nëse ai mëson dhe frymëzon të tjerët. Vështirë që dikush që është injorant dhe nuk ka dëshirë për të mësuar, të cilësohet si një njeri i kompletuar. Gjithashtu është e diskutueshme nëse një person i ditur i cili nuk e rinovon dhe reformon veten për të qenë shembull për të tjerët, të mund të quhet i kompletuar!”*



FETHULLAH GYLEN



LËVIZJA GYLEN

“Ata që duan të reformojnë botën, duhet së pari të reformojnë vetveten. Me qëllim që t’i sjellin të tjerët në udhën për një botë më të mirë, ata duhet të pastrojnë botën e tyre të brendshme nga urrejtja, smira, xhelozia dhe të zbukurojnë botën e tyre të jashtme me të gjitha llojet e virtyteve



Dinamikat Bazë të Lëvizjes

Enes Ergene, gusht 2008

Gylen i kushton shumë rëndësi parimit të “të jetuarit për të tjerët,” aq sa e paraqet atë si një dinamikë bazë, e cila do ta bënte një komb të zgjohet. Çdo shoqëri duhet të bëjë sakrificat e veta. Sakrifika qëndron përtej dhe mbi përfitimet e kësaj bote, ndaj


Ne e konsiderojmë të jetuarit për vete si egoizëm dhe ky gjest na duket mjaft revoltues.

përkufizimi i saj shtrihet përtej altruizmit të zakonshëm. Përkundrazi, ajo është më afër heroizmit idealist. Një altruizëm i tillë formon karakterin e njerëzve, të cilët janë të paineduar për përfitimet personale apo materiale dhe të cilët përpriqen vazhdimisht për të përfituar shpërblim nga Zoti. Gylen i përshkruan këta lloj njerëzish si “arkitektët e shpirtit” dhe si “mjekët e mendjes.” Këto janë njerëz të cilët janë të aftë të injektojnë në shoqëri një ndjenjë përgjegjësie dhe kujdesi për të tjerët. Të tillë njerëz përbëjnë një dinamikë të rëndësishme sipas Gylenit:

Sot, ajo për të cilën kemi më tepër nevojë janë njerëzit me kurajë, të cilët punojnë pa u lodhur në shërbim të Zotit dhe që valëviten jashtë ndjenjave të egoizmit

dhe përfitimeve personale... Ata të cilët përpeliten me mjerimin e njerëzve... Ata të cilët mbajnë në duart e tyre një pishtar dijeje dhe luftojnë injorancën e ashpërsinë në komunikim, e përhapur sot ngado... Ata të cilët me anë të besimit të tyre të palëkundur dhe vendosmërisë, rendin drejt këtyre njerëzve të pafat... Njëlloj si të ishin kuaj race, vrapojnë në rrugën e tyre pa u ankuar dhe pa shtrembëruar fytyrën... Ata të cilët lumturohen me kënaqësinë e të jetuarit për të tjerët duke harruar dëshirën e të jetuarit për vete.

Unë besoj se i gjithë njerëzimi do të jetë i kënaqur dhe se vuajtjet e mjerimi shumëshekullor i njerëzve të vijë drejt fundit, duke bërë kështu që bota të hyjë edhe një herë brenda boshtit të vlerave të çmueshme, në përputhje me idealet të cilat bëjnë që njerëzit e tillë ta shohin shpëtimin e vet, nëpërmjet shpëtimit të të tjerëve. Të tillë njerëz mund të ecin me shpejtësi drejt së ardhmes dhe prosperitetit në emër të lumturisë së të tjerëve; ata do të mund të qarkullojnë në damarët e të tjerëve si të ishin gjak; ata do të mund të ngrihen mbi urinë dhe etjen dhe të frymëzojnë jetë ngado. Me anë të mëshirës e cila kalon kufijtë e përgjegjësive personale si dhe nëpërmjet butësisë me anë të së cilës do të mund të përqafojnë gjithë njerëzimin, ata do të përpriqen të përcjellin tek ne, shpirtin dhe domethënien e tij, të cilën ne e kishim humbur; ata do të na rikujtojnë domethënien e të qenit njeri. Nga ana tjetër, ata do të përbëjnë një model për shpirtat e trazuara, të cilët kanë jetuar pa ideale për një kohë kaq të gjatë.



FETHULLAH GYLEN

Shoqëria jonë ka nevojë vetëm për heronj të idealeve; ata të cilët mund t'ia dalin të ndihmojnë së pari popullin tonë dhe më pas gjithë njerëzimin me anë të ndjenjës fisnike të mëshirës; dhe sa herë që ata të ngrenë duart e tyre drejt Zotit, të luten për të tjerët. Një kriter dhe kërkesë të tillë kaq të madhe, nuk duhet të presim të na e plotësojnë të tjerët; jemi ne ata mbi të cilët bie barra e të filluarit të artikulimit të saj duke nisur që nga vetja jonë.

Ne e konsiderojmë të jetuarit për vete si egoizëm dhe ky gjest na duket mjaft revoltues. Pasioni ynë ka qenë gjithmonë të jetuarit për të tjerët dhe përgatitja e tyre për lumturinë e përhershme. Edhe nëse do të kishim mundësi të riktheheshim edhe një herë në jetë dhe edhe nëse do të ishim të

Altruizmi është lotusi i kopshteve tona. Ai përbën trofeun tonë i cili duhet fituar por që nuk duhet gëzuar.

lirë të zgjidhnim alternativat tona të kësaj jete të re, sigurisht që do të zgjidhnim përsëri "të jetuarit për të tjerët, do t'ia përkushtoheshim sigurisht njerëzimit dhe do ta përgatitnim racën njerëzore për ringjallje. Nuk do të na shkonte asnjëherë në mendje asnjë keqkuptim... Nuk do të përjetonim asnjëherë të qara reagimi dhe ankesa... Ne nuk do të merreshim me asnjëri i cili na ka akuzuar me akuza të rreme dhe keqdashëse... Ne do të buzëqeshnim

ndërkohë që përbrenda do të ishim duke rënkuar. Njerëzit idealë digjen si qirinj për të ndriçuar të tjerët, pa u merakosur për veten... Një mik i vërtetë, i cili do të ishte një person i pjekur, është ai i cili thotë "pas teje", edhe nëse është duke dalë nga Parajsa dhe është duke hyrë në Ferr.

Ajo çfarë ne kemi theksuar vazhdimisht, është fakti se ai i cili jeton jetën e vet me sinqeritet, ndershmëri dhe altruizëm, duke dhënë mjaft nga vetja me qëllim që t'i bëjë të tjerët të jetojnë, është personi të cilin ne mund ta quajmë me plot gojën si trashëgimtar i vërtetë i dinamikave historike, të cilit ne mund t'ia besojmë shpirtat tanë.

Projektet individuale të ndriçimit, të cilat nuk janë planifikuar për të mbështetur komunitetin, janë të destinuara të dështojnë. Për më tepër, nuk është e mundur që ato të rigjallërojnë vlerat të cilat kanë qenë shkatërruar në zemrat e individëve në shoqëri, por as edhe në ndërgjegje dhe në vullnet. Meqenëse planet dhe projektet për shpëtim individual, të cilat janë ta pavarura nga shpëtimi i të tjerëve, nuk janë asgjë më tepër se sa një iluzion, në të njëjtën mënyrë edhe ideja e arritjes së suksesit si tërësi nëpërmjet paralizimit të ndërgjegjes individuale, është thjesht një fantazi. Të jetuarit për të tjerët, përbën faktorin më të rëndësishëm i cili përcakton sjelljen e heronjve të tillë. Shqetësimi i tyre më i madh, është pikëpyetja rreth përzgjedhjes së tyre për të kryer misione të tilla, ndërsa karakteristika e tyre më mbizotëruese, është se ambicia e tyre më e madhe qëndron në faktin nëse ata kanë arritur të fitojnë kënaqësinë e Zotit apo jo. Kur përpiqen të ndriçojnë të tjerët, ata nuk ndajnë as dhembje e as nuk i nënshtrohen



FETHULLAH GYLEN

ndonjë traume të shkaktuar nga drita e tyre që ndriçon të tjerët. Sukseset që këta njerëz arrijnë, konsiderohen si shfaqje të mbështetjes hyjnore të Zotit, ndaj njerëz të tillë janë të zhytur në modesti, duke e nënvleftësuar veten çdo ditë përherë e më tepër. Për ta përforcuar gjithë këtë, ata tmerrohen nga ideja se ndjenjat e tyre mund të ndërhyjnë në veprat që ata marrin përsipër të kryejnë dhe pëshpërisin vazhdimisht: “Ti o Zot je gjithçka për të cilën unë kam nevojë.”

Virtyti i mospritjes së asgjëje në këmbim të kësaj sakrifice, përbën trëndafilin e besimit tonë. Altruizmi është lotusi i kopshteve tona. Ai përbën trofeun tonë i cili duhet fituar por që nuk duhet gëzuar. Ne harrojmë se jetojmë për vete, ndërkohë që digjemi nga dëshira për të jetuar për të tjerët. Janë njerëzit tanë ata të cilët e dinë më mirë se kushdo tjetër se si duhet të qëndrojnë në ballë të punëve kur janë duke shërbyer dhe se kur duhet të qëndrojnë si kompensim. Bota ka zbuluar nga ne ndjenjën e dashurisë së pakushtëzuar.


Besimtarët e përsosur, nuk kënaqen vetëm me arritjet apo përsosmërinë e tyre personale; ata janë të vendosur pothuajse po aq sa Profetët, për t’ia hapur shpirtin çdo njeriu dhe për të përqaftuar secilin njeri që u del përpara. Ata ia përkushtojnë jetën e tyre lumturisë së të tjerëve, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër, duke lënë mbas dore veten. Ata jetojnë si Sahabet e Profetit; ata ecin në një drejtim të kundërt me atë që u diktojnë dëshirat e tyre trupore dha ata përhapin dritë ngado rreth e rrotull, sepse ata e kanë potencialin e mjaftueshëm të ndriçojnë në thelbin e tyre tamam si një qiri. Ata janë gjithmonë në pritë për errësirën

dhe përpiqen gjithmonë ta mbajnë atë të izoluar... Meqenëse digjen gjatë gjithë kohës, ata janë të dëmtuar përbrenda; pavarësisht kësaj, as djegia e vazhdueshme e as konsumimi, nuk mund t’i kufizojë ata nga të ndriçuarit ndaj të tjerëve.

Tani, ne jemi duke pritur me sytë drejt pikës së mbërritjes së këtyre njerëzve, të cilët kanë kaq shumë dashuri për përgjegjësitë

Njerëzimi tani ka tmerrësisht nevojë për njerëz me thellësi dhe sinqeritet të brendshëm, shumë më tepër se për çdo gjë tjetër.

dhe kauzën e tyre, saqë nëse do të ishte e nevojshme, ata do të jepnin në këmbim edhe biletën e hyrjes për në parajsë. Njerëz si këta, edhe nëse do të hynin brenda, do të kërkonin mënyra për t’u larguar nga parajsa. I Dërguari i Zotit, Profeti Muhamed (a.s) ka thënë: “Nëse ata do të vendosnin diellin në dorën time të djathtë dhe hënë në dorën time të majtë, për të më detyruar ta braktis kauzën time, unë do të refuzoja ta bëja këtë derisa Zoti të bëjë që e vërteta të triumfojë, apo derisa të vdes në këtë udhë.” Ky është horizonti i të Dërguarit të Zotit. Bediuzzaman Said Nursi, një dijetar rrezatues me dritën që buron nga i Dërguari i Zotit, i bërë dysh nga dhimbjet që i shkaktonte vështirësia e ndjekjes së kauzës së tij, ka thënë: “Në sytë e mi, unë nuk kam as dashuri për parajsën, e as frikë për ferrin;



FETHULLAH GYLEN

dhe nëse do ta shikoja si të sigurt besimin e popullit tim, do të isha i gatshëm që tani të digjesha në zjarrin e ferrit." Në mënyrë të ngjashme, edhe Ebu Bekri i ngriti duart lart dhe u lut në një mënyrë që do të trondiste qiejt: "O Zoti im, bëje trupin tim aq të madh sa që unë i vetëm të mund të mbush krejt ferrin dhe të mos ketë më vend për askënd tjetër aty."

Njerëzimi tani ka tmerrësisht nevojë për njerëz me thellësi dhe sinqeritet të brendshëm, shumë më tepër se për çdo gjë tjetër; ai ka nevojë për njerëz të cilët vuajnë dhe lotojnë për mëkatet

dhe gabimet e të tjerëve; të cilët shohin përpara për të falur dhe për të kërkuar faljen e të tjerëve përpara vetes së tyre; të cilët në vend që të hyjnë në parajsë dhe të përfitojnë kënaqësitë e tyre individuale atje, preferojnë të qëndrojnë në *A'raf* dhe nga aty, të përpiqen t'i marrin të gjithë njerëzit për në parajsë së bashku me ta; të cilët edhe pasi kanë hyrë në parajsë, nuk kanë mundësi të gjejnë kohë për t'iu gëzuar kënaqësive të saj, për shkak të mendjes që u rri tek të tjerët, duke planifikuar vazhdimisht shpëtimin e tyre nga zjarri i ferrit.





FETHULLAH GYLEN



KOMENTE RRETH FETHULLAH GYLENIT

“Ju po kontribuoni në promovimin e idesë së tolerancës dhe të dialogut ndërfetar të frymëzuar nga Fethullah GYLEN në Lëvizjen e tij sociale ndërkombëtare. Ju e bëni këtë nëpërmjet veprimtarisë suaj të përditshme duke forcuar fabrikimin e njerëzimit tonë të përbashkët, dhe njëkohësisht edhe promovimin e lidhjeve të vazhdueshme kulturore dhe edukative të cilat e mbajnë botën tonë të bashkuar.”



FETHULLAH GYLEN

Bill Klinton Falënderon Lëvizjen GYLEN



Ish-presidenti i ShBA Bill Klinton dha një mesazh në Darkën e III Vjetore të Miqësisë mbajtur nga Qendra Kulturore Turke në **New York** më 25/9/2008, ku theksoi kontributin e Lëvizjes GYLEN në paqen botërore.

“Në këtë botë të ndërvarur, fatet e popujve në anë të ndryshme të globit janë të lidhura ngushtë; ndaj është mjaft thelbësore të mbajmë të hapura linjat e komunikimit sa më shumë të mundemi. Ju po kontribuoni në promovimin e idesë së tolerancës dhe të dialogut ndërjetar të frymëzuar nga Fethullah GYLEN në Lëvizjen e tij sociale ndërkombëtare. Ju e bëni këtë nëpërmjet veprimtarisë suaj të përditshme duke forcuar fabrikimin e njerëzimit tonë të përbashkët, dhe njëkohësisht edhe promovimin e lidhjeve të vazhdueshme kulturore dhe edukative të cilat e mbajnë botën tonë të bashkuar.”

Bylent Exhevit, ish-Kryeministri i Turqisë



GYLEN është një person me një botëkuptim mjaft të gjerë. Ai është një person me pikëpamje moderne, shumë i lidhur me Islamin dhe në të njëjtën kohë në përpjekje të vazhdueshme për ta lidhur atë me modernizmin.

Bartholemeos I, Patriark i Fanarit Grek



GYLENI është një shembull i harmonisë dhe i tolerancës për të gjithë ne dhe një model i vlerave të larta për të gjithë njerëzimin.

Azam Nizamuddin,

Përfaqësuesi i Komunitetit Mysliman Amerikan



Të gjitha studimet historike kulturore dhe fetare të bëra deri tani, i kanë shpërfillur idetë e Lëvizjes GYLEN. Unë mendoj se kjo ka ndodhur mbi të gjitha, për faktin se Islami, konsiderohet në qarqet shkencore, më tepër si një “ideologji politike” e jo si një besim fetar, apo sistem vlerash shpirtërore. Arsyeja e dytë është fakti se është e vështirë t'i referohesh Lëvizjes së GYLENIT, si një kategori e veçantë njerëzish.

Prof. Dr. Toktamış Ateş

Istanbul Bilgi University



Këto shkolla nuk kanë asnjë qëllim tjetër përveç edukimit; unë nuk do të besoj kurrë se shkollat e hapura si në Federatën Ruse ashtu edhe ato në mbarë botën, kanë ndonjë qëllim tjetër, përveç sigurimit të një edukimi të mirë për studentët. Prapa tyre, nëse i referohemi fjalëve të të nderuarit GYLEN, ju nuk do të jeni në gjendje të shikoni asgjë tjetër përveç koncepteve të “paqes”, “dialogut” dhe “tolerancës.”

Dr. Pim Valkenberg

Radboud University



GYLEN mund të shndërrohet në një nga bashkëbiseduesit më me vlerë për kristianët e angazhuar në themelimin e institucionit të dialogut me Islamin. Metoda e GYLENIT në vendosjen e dialogut mbështetet në “të harruarit e kontradiktave të shkuara dhe fokusimi në gjëra të përbashkëta që kemi brenda feve tona.”



FETHULLAH GYLEN

Ass Prof. Charles Nelson,

The Kean University



Shembulli i moralit të lartë, i propozuar nga F. Gylen dhe parimet e tij, na nxisin drejt të vepruarit, vetësakrificimit, si dhe shërbimit për mirëqenien e mbarë njerëzimit.

Lord Ahmed,

Anëtar i Dhomës së Lordëve



Fethullah Gylen është dijetar mysliman me pikëpamje moderne. Është e pamundur të qëndrosh mënjanë duke parë zhvillimin e Lëvizjes së tij. Kjo lëvizje shërben si një urë mbi humnerë e cila shtrihet ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit.

Prof. Dr. Paul Weller,

Derby University



Gylen kundërshton hapur identifikimin e Islamit me terrorizmin. Ai thotë se i mallkon ata që vrasin njerëz të pafajshëm duke përdorur fenë si mburojë. Ai thekson se mbështetet mbi burimet autentike të Islamit dhe propozon dinamika zhvillimore të cilat bazohen mbi Kuranin dhe Sunetin.

Prof. Dr. Marcia Hermanseen,

Chicago University



Gylen është një mësues dhe udhëheqës shpirtëror. Tre faktorë themelorë qëndrojnë pas suksesit të Lëvizjes Gylen, e cila me kalimin e kohës është shndërruar në një projekt me përmasa globale: Rëndësia e madhe që i kushtohet profesionit të

mësuesit, toleranca e cila e ka origjinën në kulturën turke dhe është përvetësuar dhe trajtësuar në Lëvizjen Gylen, si dhe mungesa e pretendimeve për përfitime materiale në këmbim të shërbimit.

Guus ter Horst,

Ish Ministre e Brendshme dhe e Marrëdhënieve Mbretërore të Hollandës



Ministria e Çështjeve të Integritimit, duke vijuar hetimet e kryera nga qeveria nuk ka dalluar asgjë negative në këtë Lëvizje dhe të dhënat e shërbimeve tona sekrete, janë evidencë e qartë e këtij fakti. Nuk ekziston asgjë në thelb të kësaj lëvizjeje, e cila të lëkundë besimin tek ajo në asnjë rast; ajo nuk ka asgjë të përbashkët me dhunën e terrorin.

Prof. Dr. John Pahl,

Philadelphia University



Mosha mesatare e ushtarëve amerikanë që japin jetën në Irak është 20,5 vjeç dhe mosha mesatare e të rinjve të vetëvrarë në Palestinë është 19,5 vjeç. Të dyja këto grupe njerëzish, vrasin njëri-tjetrin apo vetëvriten, për hir të atdheut të tyre, ndërsa të rinjtë e frymëzuar nga idetë e Gylenit, i përkushtohen shërbimit ndaj njerëzimit dhe vijueshmërisë së jetës.

Prof. Dr. Y. I Efimov,

Shef i Departamentit të Filozofisë, Akademia e Shkencave Ruse




Gylen si një pjesëtar i shquar dhe i qëndrueshëm i dialogut ndërfaqet, i qëndron fort idesë së domosdoshmërisë së bashkekzistencës dhe bashkëpunimit mes myslimanëve, kristianëve



FETHULLAH GYLEN

dhe hebrejve, si përfaqësues të besimeve fetare të afërta dhe të ngjashme me njëra-tjetrën. Ai bën thirrje për përsosjen e edukimit dhe veprimeve praktike, përmes forcimit të marrëdhënieve ndërmjet njerëzve të kulturave dhe besimeve të ndryshme fetare.

Prof. Dr. John Esposito,



George Town University

Është mjaft e rëndësishme që idetë e Gylenit t'i bëhen të njohura njerëzve si në botën islame ashtu edhe në Perëndim.

Prof. Dr. Pierre Montandon,

Anëtar Nderi i Universitetit të Gjenevës



Domethënia e veprimtarive kulturore dhe edukative të këtyre shkollave do të bëhet më e dukshme në të ardhmen. Përpjekjet e mësuesve të cilët kanë hapur këto shkolla duhet domosdoshmërisht të përmenden dhe të vlerësohen. Këtu jepet një edukim i mrekullueshëm dhe bëhet një punë ideale, e paanshme dhe dinamike e një karakteri demokratik. Një profesionalizëm i tillë, e ka burimin nga trashëgimia historike dhe kulturore e Turqisë. Kontributi i këtyre shkollave në sigurinë botërore do të jetë mjaft i madh dhe unë besoj se ai duhet të vlerësohet siç duhet.

Hajdar Alijev,

ish-President i Azerbajxhanit



Edukimi përbën të ardhmen e një kombi. Këto shkolla ndihmojnë në zhvillimin e sistemit arsimor të Azerbajxhanit, ndaj ne i konsiderojmë ato si një shembull dhe unë personalisht jam mjaft i kënaqur me to. Unë e falënderoj të respektuarin Fethullah Gylen, i cili ka frymëzuar zemrat e mësuesve vullnetarë të cilët kanë bërë përpjekje të mëdha në drejtim të vijueshmërisë së këtij objekti, duke e shndërruar potencialin e tyre të paçmueshëm në energji lëvizjeje.

Monsinjon Georges Marovitch,

ish-Përfaqësues i Vatikanit në Stamboll



Tani, siç e dini Gyleni është takuar me Patriarkun Grek. Ky është një gjest mjaft i bukur dhe fisnik. Ai është takuar gjithashtu me Kreun e Rabinëve dhe më pas ka arritur të takohet me Papën. Ai ka dëshiruar gjithmonë t'ia paraqesë mesazhin e tij të mrekullueshëm mbarë botës dhe të tregojë se Islami, është realisht një fe e dashurisë dhe një fe qiellore me origjinë Zotin. Ne të gjithë jemi krijuar nga Zoti. Që të gjithë ne, ecim në të njëjtën rrugë: ne shkojmë direkt tek Zoti. Ndaj, një ditë në Parajsë nuk do të ketë as kisha, as xhami e as sinagoga. Që të gjithë do të jetojmë të rrethuar nga dashuria e pakufishme e Zotit. Kjo do të thotë se nëse dëshirojmë të ecim drejt kësaj rruge së bashku, duhet të nisim ta bëjmë këtë, pikërisht tani.



FETHULLAH GYLEN



FETHULLAH GYLEN NË MEDIA

Burrat si Fethullah GYLEN lindin një herë në shekull dhe janë njerëz të cilët i japin dritë qiriut të shpresës dhe optimizmit, në botën e ashpër dhe të errët të devijimit fetar, zhurmës politike, dizintegritimit shoqëror dhe mungesës së harmonisë kulturore, në mënyrë që ta shpien gjithë njerëzimin në rrugën e duhur, drejt paqes universale.



FETHULLAH GYLEN

Një Ikonë e Paqes Universale

Weekly Cutting Edge, qershor 2008

Burrat si Fethullah Gylen linden një herë në shekull dhe janë njerëz të cilët i japin dritë qiriut të shpresës dhe optimizmit, në botën e ashpër dhe të errët të devijimit fetar, zhurmës politike, dizintegritimit shoqëror dhe mungesës së harmonisë kulturore, në mënyrë që ta shpion gjithë njerëzimin në rrugën e duhur, drejt paqes universale.

Fethullah Gylen, i cili njihet për jetën e tij të devotshme dhe askete, është një dijetar me përmasa të mahnitshme. Ky njeri i të gjitha fushave, u lind në Erzurum të Turqisë Lindore, në vitin 1941. Ai e mori shkollimin islamik nga një shkollë fetare private në Erzurum, ku mori licencën dhe nisi të predikonte tolerancën dhe harmoninë fetare. Përpyekjet e tij për reforma edukative dhe sociale, e kanë bërë atë figurën publike më të shquar dhe më të vlerësuar që nga vitet 60 e këtej.

Gylen është shfaqur si një nga zërat më të fuqishëm dhe ndikues të komunitetit mysliman i cili bën thirrje për dialog, si një hap i madh drejt paqes universale. Predikimet dhe ligjëratat e tij kanë tërhequr së pari mijëra të rinj të Turqisë dhe më pas i kanë shtrirë krahët e tyre në mbarë botën.

Një dimension i rëndësishëm i paqes i cili është i përmasave universale apo globale, përbën një karakteristikë tjetër, që e bën të dallueshëm Gylenin nga dijetarët e tjerë. Ai thekson rëndësinë e domosdoshmërisë së fesë dhe se dialogu ndërkulturor për paqen botërore nëpërmjet përpjekjeve të tij për t'u takuar me udhëheqës fetarë dhe komunitarë brenda vendit të tij të lindjes

por edhe jashtë tij, janë të njohura nga të gjithë. Prapa rregullave që garantojnë paqen dhe sigurinë, qëndrojnë mjaft referenca në Kuran, që kanë të bëjnë me qëndrimet që duhen mbajtur ndaj kriminelëve dhe njerëzve të cilët janë përgjegjës direkt apo indirekt, për krijimin e një atmosfere anarkie apo terrori; për të tillë njerëz ekzistojnë sanksione ligjore, dënime dhe ndëshkime, në bazë të udhëzimeve të Kuranit.

Gylen rithekson shpesh në ligjëratat dhe predikimet e tij se paqja, drejtësia dhe stabiliteti, janë të një rëndësie themelore për Islamin; betejat dhe luftërat janë vetëm

Gylen argumenton fuqishëm se paqja në këtë fshat global qëndron në respektimin e të gjitha diversiteteve, duke i konsideruar këto diversitete si pjesë të natyrës dhe duke iu garantuar njerëzve mikpritje dhe bashkëpunim afatgjatë.

opsione dytësore, të cilat mund të vihen në jetë vetëm nën kondita apo rrethana të veçanta. Ai kundërshton përdorimin e dhunës për të arritur objektiva thjesht politike dhe u mëson pasuesve të tij se është diçka e palejuar dhe mëkat, të përfitosh diçka duke përdorur metoda të pandershme. "Në botën e sotme të ndriçuar, mënyra e vetme për t'i bërë të tjerët të pranojnë idetë dhe pikëpamjet tuaja, është nëpërmjet bashkëbisedimit dhe përdorimit të argumenteve bindës."



FETHULLAH GYLEN

Vetëm nëpërmjet mirëkuptimit reciprok, dialogut ndërfitar dhe ndërkulturor si dhe një procesi të respektit të ndërsjellë, komunitetet e ndryshme mund të bashkëjetojnë në harmoni dhe në mirëkuptim. Rruga e kundërt do të shpinte në një katastrofë fetare, çoroditje politike dhe kakofoni kulturore.

Gylen në veprat e tij, tregon edhe për përfitimet që do të vinin për njerëzimin, në një kohë paqeje dhe prosperiteti. Megjithëse të konsideruarit e botës si një fshat, po shndërrohet çdo ditë e më tepër në një bindje të palëkundur, besimet e ndryshme fetare, racat, traditat dhe zakonet e popujve të ndryshëm, do të vijojnë të bashkëjetojnë në këtë fshat. Gylen argumenton fuqishëm se paqja në këtë fshat global qëndron në respektimin e të gjitha diversiteteve, duke i konsideruar këto diversitete si pjesë të natyrës dhe duke iu garantuar njerëzve

Gylen ishte një nga udhëheqësit e parë myslimanë, i cili brenda 24 orëve dënoi ashpër sulmet e 11 shtatorit përmes një deklarate për shtyp.

mikpritje dhe bashkëpunim afatgjatë.

Një koncept madhor lidhur me mësimet e Gylenit rreth paqes është në këndvështrimin e tij për fjalën "komb." Megjithëse ky koncept ka të bëjë veçanërisht me botën myslimane dhe me popullin turk, në kontekstin e rolit të tyre në ndërtimin e historisë njerëzore, si lojtarët më të rëndësishëm dhe më ndikues për paqen botërore, natyrisht ekziston një domethënie më e gjerë sesa thjesht koncepti

i një kombi të veçantë, sidomos kur ne i shikojmë gjërat me syrin e vizionit të Gylenit dhe idealeve të tij të dialogut dhe paqes universale.

Me të vërtetë, Gylen ishte një nga udhëheqësit e parë myslimanë, i cili brenda 24 orëve dënoi ashpër sulmet e 11 shtatorit përmes një deklarate për shtyp. Ai i konsideroi mizoritë e kryera si një atentat i madh ndaj paqes botërore, atentat i cili padrejtësisht ia njollos imazhin besimtarëve të vërtetë. Ai theksoi: "Terrori nuk mund të përdoret kurrë në emër të Islamit, apo për hir të objektivave që kanë të bëjnë me të. Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman nuk mund të jetë terrorist. Një mysliman, mund të jetë vetëm përfaqësues dhe simbol i paqes, mirëqenies dhe prosperitetit."

Më tutje, ai e përkufizon myslimanin si një person të dashurisë dhe afeksionit, i cili shmang çdo lloj veprimtarie terroriste dhe i cili nuk posedon asnjë lloj ndjenje keqdashjeje apo urrejtjeje për asgjë dhe asnjëri. Sipas tij, myslimanët e vërtetë mund të jenë vetëm përfaqësuesit më të besueshëm dhe më të çmuar të paqes universale. Ai sugjeron se edukimi është mjeti i vetëm për të njohur siç duhet konceptin e paqes dhe progresit global, në kuptimin e tyre të vërtetë të fjalës. Iniciativat edukative të frymëzuara prej tij dhe të mbështetura mbi pikëpamjet e bashkekzistencës paqësore, kanë hapur rrugën për ndërtimin e paqes universale.

Gylen është i bindur se një e ardhme më e mirë dhe më paqësore për njerëzimin mund të vendoset vetëm nëpërmjet edukimit universal dhe ndërkulturor. Një edukim i zemrës dhe i shpirtit, paralelisht me atë të



FETHULLAH GYLEN

mendjes dhe karakterit, synon të rigjallërojë dhe të nxisë gjithë qenien njerëzore të arrijë një nivel të lartë profesional si dhe të sigurojë të mira dhe shërbime të dobishme për të tjerët. Edukimi përbën elementin më të rëndësishëm të Lëvizjes GYLEN dhe është gjithashtu një mjet efektiv për jetëgjatësinë e Lëvizjes. Lëvizja GYLEN, ka hapur qindra shkolla në mbarë botën. Në këto shkolla fëmijët e ardhur nga pozita të ndryshme etnike dhe kulturore, edukohen kryesisht prej mësuesve të shkolluar në Turqi, nëpër universitetet më të njohura të këtij vendi.

GYLEN zotëron bindjen e fuqishme se të shërbyerit ndaj njerëzve është rruga e vërtetë drejt paqes dhe drejtësisë për njerëzimin; ajo varet në parapërgatitjen e një edukimi adekuat, i cili i bën bashkë dijet shkencore me vlerat shpirtërore dhe etike.

Këto shkolla duket sikur e vendosin drejtësinë vetë, nëpërmjet punësimit të një numri të njëjtë mësuesish kristianë dhe myslimanë nga komunitetet lokale, duke shkolluar si fëmijët myslimanë dhe ato kristianë, por edhe duke nxitur bashkëpunimin me institucionet kristiane në atë zonë ku ndodhen. Shumica dërrmuese e njerëzve që kanë të bëjnë me këto shkolla dhe të cilët vijnë nga shtesa të ndryshme të shoqërisë, theksojnë se procesi i edukimit me qëllim vendosjen e paqes botërore, përbën një proces që zgjat gjatë gjithë jetës së njeriut, duke u shtrirë që nga fëmijëria e tij e hershme e deri në moshë të madhe,

përsa i përket mënyrave dhe shkallës së edukimit.

Pikëpamjet e GYLENIT që kanë të bëjnë me fushën e edukimit dhe që nxisin ndërtimin e paqes, inkurajojnë lexuesit të nxjerrin mësim dhe të frymëzohen nga modelet e gjalla të personifikuara në qenie të panumërta njerëzore, të respektuara për praktikimin e vlerave, virtyeteve dhe sjelljeve që kapërcejnë dhe mbizotërojnë mbi ndjenjat e lakmisë, shpirtngushtësisë dhe lakmisë për pushtet.

Prandaj, GYLEN zotëron bindjen e fuqishme se të shërbyerit ndaj njerëzve është rruga e vërtetë drejt paqes dhe drejtësisë për njerëzimin; ajo varet në parapërgatitjen e një edukimi adekuat, i cili i bën bashkë dijet shkencore me vlerat shpirtërore dhe etike. Shumë nga pjesëtarët e grupimit të tij, besojnë se praktikatat edukative, veprimtaritë mediatike dhe projektet e dialogut të frymëzuara nga ai me qëllimin e vetëm, ndërtimin e një kulture paqeje, promovojnë vlera kyçe në traditat e ndryshme fetare dhe shpirtërore. Këto tradita, konsiderohen në gjirin e dialogut ndërfaqetarak dhe ndërkulturore si një trup me vlera të njëjta dhe të përbashkëta, i cili është përgjegjës për rendjen drejt veprimeve paqësore dhe marrëdhënieve të ngrohta ndërmjet njerëzve, bashkësive dhe popujve.

Shkollat e kësaj Lëvizjeje formojnë “Ishuj të Bardhë” mbi tokë, të cilët GYLEN i quan “Ishujt e Paqes.” Shkollat formojnë “Ishuj të Paqes”, ku kulturat dhe qytetërimet takohen me njëri-tjetrin dhe bien në konsensus. Lëvizja e tij vullnetare, përbën një kontur të theksit dhe grumbullimit rreth virtyeteve universale humane, si dhe një themel për respektin për pozitën e atyre të cilët kanë perceptime, besime fetare dhe pikëpamje të ndryshme.



FETHULLAH GYLEN

Paqja e ndërtuar përmes edukimit, përbën një mjet të qëndrueshëm pajtimi për shoqëritë e ndara. Vizioni edukativ i Gylenit nuk përfshin vetëm shkollat por gjithashtu edhe familjet, bashkësitë dhe mediet, si ato vizive ashtu edhe ato të shkruara. Gylen i bën jehonë një edukimi hyjnor, i cili ka nevojë për një rreth të mësuarit që konsiston në familjen, shkollën, shoqërinë, fqinjësinë, besimin fetar, si dhe organizatat kulturore dhe vendin e punës. Kjo u mundëson fëmijëve, duke filluar që nga mosha e tyre e hershme, të mësojnë faktin se ata janë pjesëtarë të komuniteteve (lokale apo globale) që kanë nevojë të jetojnë së bashku në harmoni dhe paqe.

Me konceptet e tolerancës dhe të dialogut, Gylen nënkupton idenë e përqafimit të

Gylen ka përpunuar një qëndrim paqësor ndaj fesë dhe shkencës, si dy aspekte përbërëse të të njëjtit realitet, plotësuese të njëra-tjetrës.

njerëzve pavarësisht ndryshimeve në opinion, botëkuptim, ideologji, etni apo besim fetar. Ekziston një nevojë e ngutshme, për të kuptuar se ndryshimet ekzistojnë dhe se objektivi nuk është eliminimi i tyre, por të dëgjuarit dhe mirëkuptimi i palës tjetër.

Nga pikëpamja praktike, ne mund të themi se një dialogues duhet të krijojë një paradigmë të re lokale apo universale, për të lehtësuar kështu interpretimin paqësor të realiteti aktual. Ne, si pjesëtarë

të ndryshëm të besimeve fetare, ideologjive dhe pikëpamjeve të ndryshme, lypset të flasim me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që, të shërojmë paradigmat, të dalim nga rrethi vicioz i keqinterpretimeve dhe i paragjykimeve. Produkti përfundimtar i shërimit të këtyre paradigmave nuk është vetëm paqja, por edhe ekzistenca. Kjo përbën pikën kryesore të filozofisë së dialogut në fushën e bashkekzistencës paqësore.

Në fshatin e sotëm global, kufijtë e kanë humbur kuptimin e tyre dhe kulturat e ndryshme po hyjnë në kontakt me njëra-tjetrën më shpesh dhe më intensivisht. Klima ndërretnike dhe ajo ndërretare ka pësuar një ndryshim dramatik gjatë viteve të fundit në mbarë botën. Meditimi social dhe bashkekzistenca paqësore brenda kontekstit të ndryshimeve kulturore etnike dhe fetare, hierarkive, rivaliteteve dhe konflikteve që përjetojnë përditë në realitetin e sotëm social ekonomik dhe politik, janë shndërruar në domosdoshmëri në ditët tona, me qëllim ruajtjen e harmonisë sociale dhe paqes universale.

Gylen ka përpunuar një qëndrim paqësor ndaj fesë dhe shkencës, si dy aspekte përbërëse të të njëjtit realitet, plotësuese të njëra-tjetrës. Ai ka frymëzuar Lëvizjen e tij edukativo-qytetare, për të ndërtuar një botë paqësore të bazuar mbi dialogun, tolerancën, respektin dhe mëshirën si dhe për të lartësuar individët, të cilët vënë në përdorim intelektin, zellin, dëshirën për të ecur përpara dhe për t'u modernizuar. Historia ka provuar se lëvizje të tilla, janë logjikshëm të bazuara mbi vlerat morale dhe etike, të cilat nuk shuhen kurrë.



FETHULLAH GYLEN



Fethullah Gylen Ndërthur Tradicionalen me Modernen

New York Times, qershor 2010

Pensilvania verilindore me bukurinë mahnitëse të tokave pjellore të fermave të shtrira rrëzë maleve Pocono, i ka hapur dyert një prej personaliteteve më në zë të Turqisë, i cili vazhdon jetën e tij në heshtje, por në fakt është një ndër më të diskutuarit.

Personat të cilët flasin me një respekt e nder të veçantë për të, e përkufizojnë Fethullah Gylenin, si një mësues, shkrimtar dhe predikues mysliman.

Një nga profesorët e Universitetit Georgetown, i cili në të njëjtën kohë ka studiuar dhe ka bërë kërkime mbi Gylenin,

John L. Esposito, thotë që, i vetmi person i cili mund të krahasohet me Gylenin është Dalai Lama.

Gylen fokusohet mbi rëndësinë e paqes, tolerancës, forcimit të lidhjeve ShBA-Turqi dhe ekonominë e lirë. Fjalët e përsëritura disa herë “Terrori nuk ka vend në Islamit e vërtetë”, kanë ndikuar shumë tek personalitetet perëndimore.

Edhe ish-ministrja e jashtme e ShBA-së, Madeleine K. Albright si dhe një nga paraardhësit e saj, James A. Baker III, kanë folur rreth aktiviteteve të grupeve të lidhura me Gylenin dhe kanë lavdëruar mbrojtjen që i bëhet demokracisë dhe dialogut.

Por kritikuesit dhe paragjykykuesit e shohin atë nga një këndvështrim i errët. Ata



FETHULLAH GYLEN

pohojnë që mbështetësit e Gylenit kanë zënë pozicione të larta në Turqi dhe kanë qëllime të fshehta.

Turqia e cila ka shumë kohë që drejtohet nga një qeveri laike dhe tashmë një qeveri mike e Islamit, duke vendosur veten si një aktor bazë në marrëdhëniet me Izraelin, Iranin dhe Irakun, kthehet në qendër të vëmendjes kur merr përsipër një rol më të madh global në tensionin e ndezur mbi vendin e fesë në jetën publike. Kështu këndvështrimi i Gylenit përpiqet të ekuilibrojë tradicionalen me modernen.

Bashkë me shumë ndjekës të tij, jeton në një zonë me një sipërfaqe prej 10 hektarësh, mbushur me bredha dhe lule fieri, ku ndodhet dhe një miniliqen i mbushur me peshq të larmishëm portokalli, në një shtëpi ku gjendet një sallon pritjeje dhe një vend modern për qëndrimin dhe bujtjen e vizitorëve.

Për shkak të problemeve shëndetësore Gylen largohet rrallë nga vendbanimi i tij.

Në drekën e shtruar me ushqimet tradicionale klasike turke, Gylen, biri i një imami province, u tregua jashtë mase modest dhe nuk të linte përshtypjen e një njeriu mbizotërues.

Gyleni i cili ka mësuar Kuranin që në moshën pesëvjeçare dhe ka predikuar që 14 vjeç, ka arritur të krijojë dalëngadalë një komunitet ndjekësish. Ai krijoi një rrjet ndërkombëtar të përbërë nga shkolla, spitale dhe qendra pune. Në mesin e tyre, zë vend dhe Banka Islame Asia, që mban miliarda të ardhura, përfshirë këtu dhe gazetën më të njohur të Turqisë "Zaman" dhe kanalin televiziv

Ebru-TV në Somerset, New Jersey.

Të gjitha këto janë pjesë e lëvizjes të njohur nga të tjerët si *Lëvizja Gylen*, por në të vërtetë janë pjesë e *Lëvizjes së Vullnetarëve*, lideri i së cilës me modestinë e tij preferon mos ta nxjerrë veten në plan të parë. Gyleni pohon se nuk ka asnjë përfitim personal nga gjithë këto aktivitete dhe se e vetmja gjë që ka, është një jorgan, disa çarçafë dhe disa libra të çmuar për të. Ai thotë se nuk e di në sa vende ka institucione, sa është numri i mësuesve dhe i nxënësve.

"Besoj se është i gabuar emërtimi i lëvizjes si *Lëvizja Fethullah Gylen* dhe duke e quajtur kështu, mendoj se nuk respektohen shumë njerëz të cilët ia kanë kushtuar jetën kësaj lëvizjeje. Roli im në këtë lëvizje është shumë i kufizuar dhe nuk ekziston lidhja me një lider, qendër ose një hierarki", shprehet Gyleni pasi i bëhet një pyetje në lidhje me punën e ndjekësve.

Por të tjerët bëjnë të ditur që ka mbi 1.000 shkolla në 110 shtete të cilat drejtohen ndoshta nga 5 milionë anëtarë. Në Amerikë ka shkolla të ngjashme me to, madje edhe në Burma gjendet një shkollë e tillë. Ato përcjellin vlerat e Islamit por ndryshe nga medresetë, përdorin tekstet zyrtare të vendit, ku ndodhen dhe fokusohen mbi teknologjinë dhe shkencën moderne. Ato vlerësohen si institucione me vlera të larta arsimore dhe edukative, për të cilat ka kërkesa të larta dhe konkurrencë të fortë.

Por në fund të viteve 90' *Lëvizja Gylen* pati fërkime të forta me ish-qeverinë laike. I ardhur në Amerikë për t'u kuruar, Gylen i sëmurë nga zemra dhe diabeti, qëndron në Amerikë pas fajësimit për cenim të laicizmit



FETHULLAH GYLEN

të bërë nga një prokuror turk. Por ai thekson se fjalët janë ndryshuar (me montazh) dhe më në fund të gjitha këto akuza janë hedhur poshtë.

Specialistët pohojnë që disa personalitete të qeverisë aktuale, mike e myslimanëve, janë nga komuniteti i Gylenit. Ndërkohë që Gylen mbron faktin se lëvizja mban të njëjtën distancë me çdo lloj qeverie turke, ashtu edhe si me qeveritë e huaja, ai thekson se nuk kanë dëshirë të zënë poste në zyrat shtetërore.

Sipas disa specialistëve, autoritetet amerikane mbështesin faktin se *Lëvizja Gylen* përbën një ekzistencë pozitive në Azinë e Mesme, sepse pas ndarjes së Republikave Sovjetike, Gylen ka dërguar me qindra vullnetarë atje.

Gylen mbron faktin se lëvizja mban të njëjtën distancë me çdo lloj qeverie turke, ashtu edhe si me qeveritë e huaja, ai thekson se nuk kanë dëshirë të zënë poste në zyrat shtetërore.

“Këto shkolla janë një alternativë e re për të rinjtë. Dhe në këtë mënyrë nuk ndihen të detyruar të marrin pjesë në organizata terroriste, thotë sociologia Helen Rose Ebaugh, nga Universiteti Houston, e cila merret me studimin e lëvizjes. Ebaugh tregoi sesi Gylen ka kundërshtuar në mënyrë të prerë çfarëdolloj ndihme të ofruar nga

Arabia Saudite në shërbim të mbarëvajtjes së Universitetit Fatih në Stamboll, në mënyrë që të mos ndodhin keqkuptime të tilla, duke u thënë se: “Mbështetet nga qeveria saudite”.

Në një periudhë kur qeveria turke kritikon ashpër Izraelin për përplasjen dhe goditjen e anijeve me udhëtarë, të cilat çonin ndihma në Gaza, Gylen fajëson organizatorët, duke thënë se, “në vend të përballjes me autoritetet, duhej që më parë të ishte marrë leje nga autoritetet izraelite”. Gjatë shkëmbimit të e-mailit, Gylen thotë se, “shteti dhe qeveria më e keqe është më e mirë se mosqeverisja apo kaosi”.

Duke thënë se mund të mbështesë disa ‘hapa pozitivë’ të qeverisë turke, Gylen shprehet: “Kjo nuk do të thotë që ne i japim atyre këshilla politike, apo veprojmë nën ndikimin e tyre.”

Atmosfera e nxehtë politike në Turqi dhe kushtet e papërshtatshme shëndetësore, e kanë kyçur Gylenin në shtëpinë e tij në Pensilvani që nga viti 1999. Gyleni kalon jetën e tij në dy-tre dhoma të shtëpisë së gjerë ngjyrë kafe.

Në dhomën e mbushur me vepra të artit turk, Gyleni lexon nën një qarkore të gjerë që nga Shekspiri, deri tek Kanti dhe prej aty tek poezitë mistike. Kur ndihet mirë nga ana shëndetësore, del nga dhoma dhe u përgjigjet pyetjeve të vizitorëve. Edhe gratë, pa u përzier me burrat, e dëgjojnë Gylenin nga një ballkon i brendshëm. “Shpresoja të jetoja në Amerikë pa u bezdisur dhe pa u cenuar nga njerëz me mendime radikale të ardhur nga Turqia, Afganistani, Pakistani, apo vende të tjera të botës. Unë jam mysafir i Amerikës”, u shpreh Gylen.



FETHULLAH GYLEN

Një “Hero Paqësor” dhe “Një Prej Intelektualëve më të Shquar Bashkëkohorë”

Turkish Daily News

“Gylen është një dijetar modernist islam dhe udhëheqës i Lëvizjes të emërtuar sipas emrit të tij; Gylen konsiderohet gjerësisht si një prej mendimtarëve më të rëndësishëm myslimanë të gjallë. Ai mban autorësinë e më tepër se 60 librave.”

Krahas Martin Luther Kingut, Mahatma Gandhit, Nelson Mandelas, Dalai Lamas dhe Dorothy Day, dijetari i mirënjohur turk, mendimtari i moderuar islamik si dhe intelektuali i shquar Fethullah Gylen, ka zënë vendin e tij në listën e “Heronjve të Paqes.”

Lista e “Heronjve të Paqes”, u përgatit pas një simpoziumi të “Heronjve të Paqes” të mbajtur me 11-13 Prill 2003 në Universitetin e Teksasit në Austin. Në deklaratën e lëshuar pas këtij simpoziumi, thuhet që “Ne ndodhemi në një udhëkryq. Bota jonë ka nevojë për një rrugë të ndryshme nga dhuna për t’u ballafaquar me problemet me të cilat përballet shekulli ynë i ri. Një “Simpozium i Heronjve të Paqes”, studioi dhe analizoi alternativat e ndryshme ndaj dhunës, si një mënyrë për zgjidhjen e konflikteve, e cila mund të jetë e zbatueshme në kulturën dhe mënyrat tona të shmangies së konflikteve. Ky eveniment ekzaminoi historitë e grave dhe burrave besimi dhe vepra jo e dhunshme e të cilëve ka ndryshuar rrjedhën e historisë dhe i ka frymëzuar të tjerët të veprojnë kundër dhunës e cila kërcënon bashkësitë tona si dhe mbarë botën në kuptimin më të gjerë të fjalës. Dijetarët dhe mbështetësit më të mëdhenj të pikëpamjeve kundër dhunës, erdhën në Austin për t’u

treguar brezave të rinj se si duhet ta ndërtojnë karakterin e tyre personal dhe se si duhet të modelojnë një botë më pak të dhunshme.”

“Megjithëse i thjeshtë në pamjen e jashtme, ai është i veçantë në mendim dhe veprim. Ai përqafon gjithë njerëzimin dhe është thellësisht i largët dhe i kundërt me mosbesimin, padrejtësinë dhe devijimin nga rruga e drejtë. Besimi dhe ndjenjat e tij janë të thella dhe idetë dhe qëndrimet e tij ndaj probleme të ndryshme janë sa të mençura aq edhe racionale. Një model i gjallë i dashurisë, fisnikërisë dhe ndjenjave të pastra; ai është i ekuilibruar në mendime, vepra dhe në mënyrën e trajtimit të çështjeve” kështu e përshkruan rrjeti i lartpërmendur Gylenin.

Fethullah Gylenit i cili i ka nxitur pasuesit e tij të hapin qindra shkolla dhe universitete në mbarë botën me qëllim dhënien e kontributit

Krahas Martin Luther Kingut, Mahatma Gandhit, Nelson Mandelas, Dalai Lamas dhe Dorothy Day, dijetari i mirënjohur turk, mendimtari i moderuar islamik si dhe intelektuali i shquar Fethullah Gylen, ka zënë vendin e tij në listën e “Heronjve të Paqes.”

në paqen botërore, tolerancën dhe dialogun ndërmjet feve dhe qytetërimeve të ndryshme, iu desh të jetonte pothuajse si azilant në SHBA për shkak të përndjekjes ndaj tij dhe pasuesve të tij të cilat nisën që pas procesit antidemokratik të 28 Shkurtit në Turqi.



FETHULLAH GYLEN

THE WORLD'S TOP 20 PUBLIC INTELLECTUALS

Rankings
are an inherently
dangerous business.
Whether offering a hierarchy of
countries, cities, or colleges, any such list
—at least any such list worth compiling—is likely to
generate a fair amount of debate. In the last issue, when we asked
readers to vote for their picks of the world's top public intellectuals, we
imagined many people would want to make their opinions known.

But no one expected the avalanche of voters who came forward. During nearly four weeks of voting, more than 100,000 people came to ForeignPolicy.com to cast ballots.

Such an outpouring reveals something unique about the power of the men and women we chose to rank. They were included on our final list of 100 in large part because of the influence of their ideas. But part of being a "public intellectual" is also having a talent for communicating with a wide and diverse public. This skill is certainly an asset for some who find themselves in the top ranks. For example, a number of intellectuals—including Aitzaz Ahsan, Noam Chomsky, Michael Ignatieff, and Amr Khaled—received strong drives by promoting the list on their Web sites. Others issued press releases or gave interviews to local newspapers. Press coverage

profiling these intellectuals appeared around the world, with stories running in Canada, India, Indonesia, Qatar, Spain, and elsewhere.

No one spread the word as effectively as the man who tops the list. In early May, the Top 100 list was mentioned on the front page of *Zaman*, a Turkish daily newspaper closely aligned with Islamic scholar Fethullah Gülen. Within hours, votes in his favor began to pour in. His supporters—typically educated, especially middle Muslims—were eager to cast ballots not only for their champion but for other Muslims in the Top 100. Thanks to this groundswell, the top 10 public intellectuals in this year's reader poll are all Muslim. The ideas for which they are known, particularly concerning Islam, differ significantly. It's clear that, in this case, identity politics carried the day.

The Top 20

- #### 1 FETHULLAH GÜLEN

Religious leader • Turkey

An Islamic scholar with a global network of millions of followers, Gülen is both revered and reviled in his native Turkey. To members of the Gülen movement, he is an inspirational leader who encourages a life guided by moderate Islamic principles. To his detractors, he represents a threat to Turkey's secular order. He has led a relatively low profile since retiring in the United States in 1999, having fled Turkey after being accused of undermining secularism.
- #### 2 MUHAMMAD YUNUS

Microfinance, activist • Bangladesh

More than 20 years ago, Yunus loaned several dozen poor entrepreneurs in his native Bangladesh a total of \$27. In his beginning of a lifetime devoted to fighting poverty through microfinance, efforts that earned him a Nobel Peace Prize in 2006. Over the years, his Grameen Bank, now operating in more than 140 countries, has loaned nearly \$7 billion in small sums to more than 7 million borrowers—87 percent of them women. Ninety-eight percent of the loans have been repaid.
- #### 3 YUSUF AL-QARADAWI

cleric • Egypt/Qatar

The head of the popular Shari'a and Life TV program on Al Jazeera, Qaradawi issues weekly fatwas on everything from whether Islam forbids all consumption of alcohol (no) to whether fighting U.S. troops in Iraq is a legitimate form of southern jihad. Condemned by al-Qaida as leader of the Muslim Brotherhood, Qaradawi condemned the September 11 attacks, but his pronouncements since, like his justification of suicide attacks, ensure his diverse reputation.

- #### 4 ORHAN PAMUK

Novelist • Turkey

Part political pundit, part literary celebrity, Pamuk is the foremost chronicler of Turkey's off-and-on relationship between East and West. His skillfully crafted works lay bare his native country's tenuous relationship with religious democracy, and modestly earning him a Nobel Prize in literature in 2006. Three years ago, Pamuk was put on trial for "insulting Atatürk's identity" after mentioning the Armenian genocide and the plight of Turkey's Kurds in an interview. The charges were later dropped.

Today, Pamuk teaches literature at Columbia University.
- #### 5 AITZAZ AHSAN

Lawyer, politician • Pakistan

President of Pakistan's Supreme Court Bar Association, Ahsan has been a vocal opponent of President Pervez Musharraf's rule. When Musharraf dismissed the head of the Supreme Court in March 2007, it was Ahsan who led the legal challenge to reinstate the chief justice and rallied thousands of lawyers who took to the streets in protest. He was arrested several times during the period of emergency rule last year. Today, he is a senior member of the Pakistan Peoples Party, formerly led by Benazir Bhutto, and one of the country's most recognizable politicians.
- #### 6 AMR KHALED

Muslim evangelist • Egypt

A former accountant turned rock-star evangelist, Khaled preaches a folksy interpretation of modern Islam to millions of loyal viewers around the world. With a dramatic oratory and casual style, Khaled blends messages of cultural integration and hard work with lessons on how to live a purpose-driven Islamic life. Although Khaled got his start in Egypt, he recently moved to Britain to counsel young, second-generation European Muslims.
- #### 7 ABDOLKARIM SORUSH

Religious theorist • Iran

Sorush, a former university professor in Tehran and specialist in chemistry, Sufi poetry, and history, is widely considered one of the world's greatest Islamic philosophers. Having fallen afoul of the mullahs thanks to his work with Iran's democratic activists, he has lately been quiet in Europe and the United States, where his views and inclines on religious philosophy and human rights are followed closely by Iran's reform movement.
- #### 8 TARIQ RAMADAN

Philosophical scholar of Islam • Switzerland

One of the most well-known and controversial Muslim scholars today, Ramadan embodies the cultural and religious clash he claims to be trying to bridge. His supporters consider him a passionate advocate for Muslim integration in Europe. His critics accuse him of anti-Semitism and having links to terrorists. In 2004, Ramadan was named a U.S. visa to teach at Duke University, after the State Department accused him of distorting Islamic charities linked to Hamas.

Fethullah Gylen Votohet si Intelektuali Publik më me Ndikim në Botë

Intelektuali turk Fethullah Gylen, një nga dijetarët myslimanë më me ndikim në botë, ka zënë vend në krye të listës së "Njëzet Intelektualëve Publikë më të Mëdhenj të Botës" të publikuara nga revistat "Foreign Policy" dhe "Prospect".

Në numrin e saj të maj/qershorit 2008, revista Foreign Policy me qendër në Washington botoi një listë të "100 Intelektualëve Publikë më të Shquar në botë" dhe u kërkoi lexuesve

të saj të jepnin votën e tyre për njëzet më të shquarit, listë të cilën ajo premtoi ta publikonte në numrin e ardhshëm. Në listën prej 100 intelektualëve më të shquar aktualisht revista kishte përfshirë personalitete të njohura botërore si aktivisti Noam Chomsky, ish-zv. Presidenti Al Gore, mbrojtësi iranian i të Drejtave të Njeriut Shirin Ebadi, nobelisti turk Orhan Pamuk, historiani Bernard Lewis, nobelisti italian Umberto Eco, ekonomistja Amartya Sen, botuesi i Newsweek International Fareed Zakaria, Gary Kasparov, sociologu Slavoj Zizek ekonomisti Muhammed Junus,



FETHULLAH GYLEN

shkrimtari britanik Christopher Hitchens, presidenti i republikës çeke Vaclav Havel, gazetari Thomas Friedman i New York Times, Francis Fukuyuma, etj.

Revista thoshte se nuk priste ndonjë “dyndje votuesish” por më pas u vu re se gjysëm milioni njerëz e vizituan adresën foreignpolicy.com, për të përzgjedhur kandidatin e tyre. “Një dyndje e tillë, tregon për diçka unike në lidhje me burrat apo gratë të cilët ne vendosëm të rendisim në këtë listë. Ato u përfshinë në listën tonë fillestare të 100 personave, në pjesën më të madhe falë ndikimit të ideve të tyre.”

Gylen përbën një histori jetësore, e cila meriton një Çmim Nobel për Paqen, jo thjesht pozicionimin në krye të listës së 100 intelektualëve

“Foreign Policy”, vëren se Gylen ka mbledhur numrin më të madh të votave, pasi gazeta me tirazh mjaft të gjerë turke “Zaman”, e botoi në faqen e saj të parë lajmin për sondazhin tonë. “Foreign Policy” shkruante: “Kusht për të qenë një intelektual publik, është gjithashtu zotërimi i talentit për të komunikuar me një publik të gjerë dhe të shumëllojshëm. Kjo vlerë, sigurisht është një karakteristikë

e disa prej atyre të cilët e shohin veten në krye të kësaj liste.”

“Foreign Policy” ua paraqet Fethullah Gylenin lexuesve të saj, si një dijetar islam me një rrjet global prej miliona pasuesish, i cili është sa i lavdëruar po aq edhe i kritikuar në vendin e tij të lindjes në Turqi. “Për anëtarët e Lëvizjes Gylen, ai është një udhëheqës frymëzues, i cili i bën jehonë një jete të ndërtuar sipas parimeve të Islamit të moderuar. Për kritikuesit e tij ai përbën një kërcënim për rendin laik në Turqi,” thoshte foreignpolicy.com. Një temë e re e cila u shfaq në botimin e të së përditshmes The Guardian, e plotëson këtë prezantim me fjalët: “Ai doli i pastër nga akuzat e përpjekjeve për të përmbysur rendin kushtetues në vitin 2006, pas zbulimit të një montazhi që i ishte bërë fjalëve të tij, në të cilin ngjante sikur ai po nxiste mbështetësit e tij të shërbimit civil, për të pritur momentin e urdhrit për të përmbysur sistemin. Gylen njihet si një person që bën mjaft përpjekje në fushën e themelimit të një rrjeti global shkollash, të cilat e paraqesin Islamit me një frymë tolerance dhe se ai është vlerësuar në Perëndim për nxitjen e dialogut.”

Harun Tokak, Presidenti i Fondacionit të Gazetarëve dhe Shkrimtarëve, fondacion në të cilin Gyleni është president nderi, deklaroi se Gylen përbën një histori jetësore, e cila meriton një Çmim Nobel për Paqen, jo thjesht pozicionimin në krye të listës së 100 intelektualëve.



FETHULLAH GYLEN



GJYKIME DHE AFORIZMA NGA FETHULLAH GYLEN

Dashuria është eliksir. Një njeri që jeton me dashuri, është lumturuar prej dashurisë dhe ka mbuluar të tjerët përreth ose gëzimin e tij me dashuri. Në fjalorin e njerëzimit, dashuria është jetë. Ne e ndjejmë dhe e kuptojmë njëri-tjetrin me dashuri.



FETHULLAH GYLEN

Dashuria

Dashuria është eliksir. Një njeri që jeton me dashuri, është lumturuar prej dashurisë dhe ka mbuluar të tjerët përreth ose gëzimin e tij me dashuri. Në fjalorin e njerëzimit, dashuria është jetë. Ne e ndjejmë dhe e kuptojmë njëri-tjetrin me dashuri. Zoti i Plotfuqishëm nuk ka krijuar një marrëdhënie më të fuqishme se dashuria, këtë zinxhir që lidh njerëzit me njëri-tjetrin. Në fakt, bota nuk është asgjë tjetër veçse një rrënojë pa dashurinë që e mban atë në këmbë, të pastër dhe plot jetë.

Dashuria është elementi më thelbësor për çdo qenie, është ndriçimi më rrezatues dhe forca më e madhe, e aftë të rezistojë dhe të kapërcejë gjithçka tjetër. Dashuria lartëson

Dashuria është trëndafili i besimit tonë, një lule në zemër, e cila kurrë nuk vyshket. Meqë Zoti e ka rrethuar universin me dashuri, muzika më magjike dhe më e mrekullueshme në kraharorin e ekzistencës, mbi gjithçka tjetër qëndron dashuria.

çdo shpirt që e rrëmben atë dhe i përgatit këta shpirtra për udhëtimin në amshim. Shpirtrat që kanë qenë të aftë të kenë lidhje me përjetësinë, vënë në përdorim vetveten për të frymëzuar të gjithë shpirtrat e tjerë me çfarë kanë përfutur ata vetë prej amshimit.

Ata ia kushtojnë jetën e tyre kësaj detyre të shenjtë, një detyrë për hir të së cilës do të durojnë çdo lloj vuajtje deri në fund dhe ashtu siç shqiptojnë “dashuri” me frymën e fundit, gjithashtu do të marrin “dashuri” kur të jenë lartësuar në Ditën e Gjykimit.

Është e pamundur për shpirtrat pa dashuri të ngrihen në horizontin e përsosjes njerëzore. Edhe po të jetojnë për qindra vjet, ata nuk do të mund të përparojnë në rrugën e përsosjes. Ata të cilët janë privuar nga dashuria si dhe janë ngatërruar në rrjetën e egoizmit, janë të paaftë të dashurojnë njeri tjetër veç vetes dhe vdesin pa e ditur që dashuria është ngulitur thellësisht në shumë qenie të ekzistencës.

Dashuria është trëndafili i besimit tonë, një lule në zemër, e cila kurrë nuk vyshket. Meqë Zoti e ka rrethuar universin me dashuri, muzika më magjike dhe më e mrekullueshme në kraharorin e ekzistencës, mbi gjithçka tjetër qëndron dashuria.

Heronjtë e dashurisë

Botët e ndriçuara e të lumtura të së ardhmes do t'i ngrenë vetëm heronjtë e dashurisë me zemrat ngritur peshë me dashuri. Heronjtë e dashurisë me buzë të qeshura nga dashuria, me zemrat të gatuar me dashuri, me vështrimet të mbushura me dashuri për njeriun, heronjtë që marrin mesazhe dashurie nga diejt që lindin e perëndojnë, nga yjet që ndizen e shuhën...



FETHULLAH GYLEN

Edhe zemërimi dhe tërbimi madje i heronjve të dashurisë të cilët e kanë përshtatur veten ndaj mjedisit duke marrë si masë dashurinë, meqë paraqesin seriozitet dhe dashuri sepse kanë veprim rregullues e drejtues, konsiderohen gjithmonë sendërtues e të dobishëm.

Toleranca dhe mirëkuptimi

Hapja çdokujt zemrën sa mund t'ia hapësh, le të të jetë si oqean! Tërhiq me besim dhe për njeriun dashuri ndje, të mos mbetet zemër e dëshpëruar që s'u interesove për të e s'ia zgjate dorën!..

Hapja çdokujt zemrën sa mund t'ia hapësh, le të të jetë si oqean! Tërhiq me besim dhe për njeriun dashuri ndje, të mos mbetet zemër e dëshpëruar që s'u interesove për të e s'ia zgjate dorën!..

Brohoriti të mirët për të mirat dhe ndaj zemrave që kanë besuar, bëhu bujar! Mosbesuesve iu afro aq butë sa neveritë e urrejtjet t'u treten e shkojnë e ti, në frymëmarrjet e tua, gjithmonë një Mesih u bëj!..

Përgjigju të keqes me të mirë, sjelljeve të pahijshme ndaj teje mos ua var! Çdo njeri, me sjelljet e veta, karakterin e vet reflekton. Ti zgjidh rrugën e tolerancës e të mirëkuptimit dhe, përballë atyre që s'dinë se ç'është tradita dhe edukata, tregohu bujar!..

Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim. Kurse urrejtja për çdo njeri është ose lëshim i zemrës djallit, ose një vepër marrëzie. Ti duaje njeriun, mahnitu pas njerëzores!..

Tregohu i vëmendshëm ndaj sjelljeve e veprimeve që të bëjnë t'i duash të tjerët e që i tregojnë ata të dashur para syve të tu! Mos harro se të njëjtat gjëra mund të bëhen pretekst që edhe ti të pëlqehesh e të duhesh nga të tjerët. Sillu gjithmonë si njeri dhe i mëshirshëm ji!..

Shkurt, për ta mbrojtur dashurinë dhe konsideratën tënde mes njerëzve, duaj për hir të të Vërtetit, urre për hir të Tij dhe bëhu një njeri me zemrën të hapur ndaj Tij!..

Liria

Liri do të thotë që shpirti të mos pranojë asnjë kusht tjetër çfarëdo veç ndjenjave të larta dhe mendimeve të larta, do të thotë të mos bëhet rob i asnjë parimi tjetër veç virtytit, vlerës dhe dobisë.



FETHULLAH GYLEN

Ata që e kuptojnë lirinë si mundësi absolute veprimi, janë kah e ngatërrojnë lirinë njerëzore me lirinë shtazore. Diametralisht e kundërt me lirinë ku mbështeten zemrat e pafrë për të realizuar dëshirat e errëta të trupit, të të gjithë natyrës lëndore të njeriut, liri e cila është krejtësisht një simptomë shtazore, liria që, duke hequr pengesat para shpirtit, i hap udhë trokut të tij, është krejtësisht një simptomë njerëzore.

Respekt për mendimin e tjetrit

Kritika e çdo gjëje, kundërshtimi për çdo gjë, s'janë veçse, për çdo herë, një akt shembjeje. Po që se dikujt s'i pëlqen diçka, le të përpiqet ta bëjë më të mirën e saj, sepse pas shembjes s'mbeten tjetër veçse gërmadha, kurse pas bërjes, ngrehina dhe jetë...

Në një kuvend, çdo fjalë ka vlerë. Nuk duhet të kundërshtosh menjëherë as mendimet që nuk përputhen me idenë tënde. Mendo se ato mund të jenë shprehur lidhur me diçka tjetër, duro gjer në fund dhe dëgjo!

Arti

Të gjithë shpirtrat e mbyllur ndaj artit janë si ca turma amorfe me qenien e mosqenien të njëvlershme, të cilat nuk i sjellin ndonjë dobi vetes, familjeve, kombit, madje mund të jenë të dëmshme...


Është arti që e bën hekurin më të çmuar se arin, bakrin se bronzin. Sigurisht, në sajë të artit, mineralet më të pavlefshme shndërrohen në gjëra më të çmuara se ari, argjendi dhe diamanti...

Kultura

Kultura është tërësia e parimeve të lindura nga ndjenja të tilla si gjuha, edukata, zakonet dhe arti të një shoqërie, të shndërruara, më

Kritika e çdo gjëje, kundërshtimi për çdo gjë, s'janë veçse, për çdo herë, një akt shembjeje. Po që se dikujt s'i pëlqen diçka, le të përpiqet ta bëjë më të mirën e saj, sepse pas shembjes s'mbeten tjetër veçse gërmadha, kurse pas bërjes, ngrehina dhe jetë...

pas, duke u përpunuar vazhdimisht, në mënyrën e jetesës të asaj shoqërie, tërësia e parimeve, çdo fragment i të cilave është, pothuaj, shumë i rëndësishëm. Të bësh sikur s'i sheh këto parime, është verbëri, kurse përpjekja për ta larguar shoqërinë prej tyre, do të thotë ta hutosh dhe trulltosësh atë duke e lënë pa rrugë, pa drejtim.



FETHULLAH GYLEN

Shoqëritë që përpiqen për t'i siguruar vazhdimësi ekzistencës dhe përhershmerisë së vet duke u ndërzyer me kulturën dhe qytetërimin e kombeve të tjerë, u ngjajnë pemëve të zbukurimit me fruta artificiale të varura nëpër degë, gjë që është sa qesharake, aq edhe vetëmashtruese!

Kultura zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e çdo kombi. Kultura e lidhur ngushtë dhe e njësuar me të kaluarën e kombit dhe rrënjët e tij shpirtërore, hap dhe i ndriçon rrugët e gjallesës e të lartësimit për atë komb. Në të kundërt, zigzagjet e vazhdueshme me nga një mendësi dhe ide të re për çdo ditë, e shpërbëjnë kombin, e kalbin dhe e shtrijnë përdhe.

Qytetërimi

Qytetërimi s'është pasuri materiale, dukje, shijim i kënaqësive trupore dhe notim i lëndësore mes dëfrimesh. Qytetërimi është pasuri ndjesore, delikatesë shpirtërore, thellësi pikëpamjeje dhe pranim i të tjerëve duke u njohur edhe atyre të drejtën për të ekzistuar.

Qytetërimi që nuk mbështetet në virtyt dhe moral, që nuk ushqehet nga hauzet e arsyes dhe ndërgjegjes, është një festë e përkohshme me flamurka e banderola që nuk i shërben lumturisë së njerëzimit, por vetëm ca të pasurve si dhe dëshirave të ca qejflinjve. Mjerë për ata që gënjehen pas parullave të tij me drita që ndizen e shuhen!

Njerëzorja

Duke e pranuar egon e vet si peshore për të gjitha sjelljet dhe qëndrimet e mira apo të këqija të tij ndaj të tjerëve, njeriu duhet ta peshojë çdo gjë me të: të dojë edhe për të tjerët ato gjëra që do për vete dhe kurrë të mos e nxjerrë nga mendja se sjellja apo veprimi që s'i pëlqen për vete, nuk u pëlqen as të tjerëve. Kështu, ai ka shpëtuar edhe nga sjelljet e këqija, edhe nga të bërit keq të tjerëve!

Qytetërimi s'është pasuri materiale, dukje, shijim i kënaqësive trupore dhe notim i lëndësore mes dëfrimesh. Qytetërimi është pasuri ndjesore, delikatesë shpirtërore, thellësi pikëpamjeje dhe pranim i të tjerëve duke u njohur edhe atyre të drejtën për të ekzistuar.

Në përpjekjet për t'u bërë i dobishëm nuk ka kufi. Njeriu me zell të lartë mund të bëhet altruist gjer aty sa të jetë i gatshëm për ta flijuar edhe jetën për të tjerët. Vetëm se, që kjo lloj burrërie të bëhet për njeriun virtyt, duhet që sinqeriteti, bujaria dhe kthjelltësia e qëllimit të jenë larg fanatizmit racor dhe fisnor të njeriut!



FETHULLAH GYLEN

Ata që i quajnë të parëndësishme edhe të mirat më të mëdha që u bëjnë të tjerëve, ndërkaq që edhe të mirat më të parëndësishme që u bëjnë të tjerët, i vlerësojnë lart, janë njerëz të përsosur që kanë arritur në lartësitë e moralit hyjnor si dhe prehje në ndërgjegje. Njerëz të tillë as mburren me të mirat që kanë bërë, as ankohen për mosinteresimin që u bëhet...

Respekt ndaj njeriut

Kafsha, pasi vdes, harrohet dhe gropa i humbet. Por njeriu s'është kështu... Kombet që nuk i mbrojnë kujtimet dhe varret e tërve, s'e di, a janë të vetëdijshëm se i zbresin ata në nivel të kafshëve? Në të vërtetë, respekti ndaj të vdekurve është një garanci e dhënë të gjallëve për të ardhmen...

Martesa dhe foleja familjare


Martesa nuk është për kënaqësi e dëfrim. Martesa bëhet për të ndërtuar familjen, për të siguruar vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit, për t'i shpëtuar nga hallakatja mendimet dhe ndjenjat e individit, për t'i marrë nën kontroll dëshirat trupore. Ndërkaq, ashtu si edhe në shumë çështje të tjera të krijimit, dëshirat dhe kënaqësitë fizike janë një përparësi dhe element nxitës...

Personat që do të martohen, nuk duhet të vendosin sipas veshjes e mbathjes së njëri-tjetrit, madje as sipas pasurisë dhe bukurisë; në këtë çështje tepër serioze, duhet të vendosin sipas bukurisë shpirtërore, kuptimit të moralit dhe nderit, virtutit dhe lartësisë së karakterit...

Kombi formohet prej elementëve shtëpi. Kështu, po qe se shtëpitë janë mirë, edhe kombi është mirë; po qe se shtëpitë janë keq, edhe kombi është keq! Sikur ata që kërkojnë paqen e kombit, të përpiqeshin së pari për paqen e familjeve!..

Martesa nuk është për kënaqësi e dëfrim. Martesa bëhet për të ndërtuar familjen, për të siguruar vazhdimësinë dhe pavdekësinë e kombit, për t'i shpëtuar nga hallakatja mendimet dhe ndjenjat e individit, për t'i marrë nën kontroll dëshirat trupore.

Familja është një komb i vogël, kurse kombi, një familje e madhe. Një person që ka mundur të arrijë me sukses ta qeverisë një familje të madhe a të vogël si dhe t'i ngrejë pjesëtarët e saj në nivele të larta njerëzore, mund të bëhet i suksesshëm me pak përpjekje edhe në organizime më të mëdha...



FETHULLAH GYLEN

Edukata dhe i Riu

Eduktorët që s'kanë punuar si çirakë pranë një mjeshtri dhe s'kanë marrë edukatë nga një burim i shëndoshë, janë si shërbëtorë që u mbajnë pishën rrugës së të tjerëve. Paturpësia dhe përkëdhelia e dukur në fëmijët është pasojë e turbullisë së burimit ku ai është zhvilluar e zhvillohet. Parregullsia ndjesore, ideore dhe e veprimit në familje reflektohet e përforcuar në shpirtin e fëmijës. Dhe, natyrisht, nga ai në shoqëri...

Në shkolla, të paktën po aq sa në mësimet e tjera, duhet qëndruar mbi edukatën dhe kulturën kombëtare në mënyrë që të përgatiten breza me shpirt e karakter të shëndoshë, të cilët do ta kthejnë vendin në parajsë. Arsimi është tjetër gjë, edukimi, tjetër gjë. Shumica e njerëzve mund të bëhen arsimtarë, por janë të paktë ata që mund të bëhen me plot kuptimin e fjalës edukatorë!

E ardhmja e çdo njeriu është e lidhur tepër ngushtë me ndikimet dhe mbresat e periudhave të fëmijërisë dhe rinisë. Po që se fëmijët dhe të rinjtë rriten në një klimë ku t'u zhvillohen ndjenjat e larta, janë kandidatë për t'u bërë të gjallë në mendje dhe ide, shembull në moral dhe virtyt!

Njeriu është njeri në atë masë që ndjenjat e tij të jenë larg gjërave të ulëta. Edhe sikur njerëzit me zemrën nën presionin e ndjenjave të këqija dhe me shpirtin të kapur në mengenenë e egoizmit, të duken në pamje si njerëz, të lenë për të menduar.

Pothuajse çdo njeri e njuh pjesën e edukatës që ka të bëjë me trupin, por janë shumë të paktë ata që kuptojnë nga edukata mendore e ndjesore që i shërben, në fakt, punës. Me formën e parë të edukatës përgatiten më shumë njerëz të shquar për nga muskujt, kurse me formën e dytë, njerëz të shpirtit dhe mendimit...

Rinia

Çdo komb që u ka dhënë vlerë brezave të rinj, është lartësuar, kurse kombet që i kanë braktisur të rinjtë në rrjedhën e dëshirave rinore, e kanë paguar shumë rëndë pasojën e këtij nënvleftësimi. Nëse mjedisi ynë sot vlon në poshtërsi dhe brezat e rinj tërbohen çdo ditë e më shumë, kjo është krejtësisht rezultat i nënvleftësimit tonë! Sigurisht, ndërsa kryet na shëtiste në qiej, nuk i ndjemë

Njeriu është njeri në atë masë që ndjenjat e tij të jenë larg gjërave të ulëta. Edhe sikur njerëzit me zemrën nën presionin e ndjenjave të këqija dhe me shpirtin të kapur në mengenenë e egoizmit, të duken në pamje si njerëz, të lenë për të menduar.

dot kobrat që po na kalonin nëpër këmbë duke u zgjatur gjer në odat tona të gjumit dhe të sotmen tonë të hidhur me duart tona e përgatitëm...



FETHULLAH GYLEN

Thjeshtësia

Thjeshtësia është tregues i pjekurisë dhe vlerës të individit, kurse mbajtja me të madh, i papjekurisë dhe mangësisë së vlerave të individit. Njerëzit më të formuar janë ata që rrinë më shumë mes njerëzve e bëhen gjithmonë me ta, kurse njerëzit më të mangët në vlera janë ca të pafat me nam të keq të cilët e kanë për turp të rrinë mes njerëzve e t'i ndajnë gëzimet e hidhërimet me ta!

Lartësimi i një njeriu në vlerat njerëzore del në dukje me anë të thjeshtësisë tek ai; edhe thjeshtësia vetë del në dukje kur atë nuk munden ta ndryshojnë gjërat që shoqëria u jep vlerë, si posti, detyra, pasuria dhe dituria. Për atë njeri të i cili njëri prej elementëve të sipërpërmendur arrin të shkaktojë ndryshim në mendime e sjellje, nuk mund të bëhet fjalë as për thjeshtësi, as për lartësim në vlerat njerëzore!

Morali dhe etika

Të jesh i ditur është tjetër, të jesh njeri, tjetër! Duke hyrë me diturinë e vet nën urdhrin e njerëzimit, dijetari shpëton nga hamallëku i kujtesës dhe arrin të bëhet një njeri i lartë në atë masë që, me moralin dhe virtytshmërinë e vet, ta përfaqësojë diturinë e vet. Në të kundërt, s'ka ndonjë ndryshim prej një të mjeri që e ka çuar jetën kot.

Në ditët tona, morali, më në fund, nuk kuptohet, ashtu siç e kuptonin të parët, një tërësi virtytesh. Njeriu i ditëve të sotme kërkon ta kuptojë atë më shumë në formën e etikës dhe edukatës shoqërore. Eh, sikur

ta shihnim moralin të çdo njeri qoftë edhe në këtë formë!..


Morali përmban një sërë parimesh të larta lidhur me sjelljet e njeriut, të cilat, që të gjitha, burojnë prej nivelit të lartë shpirtëror. Duke u mbështetur në këtë mund të themi

Ata që orvaten të reformojnë botën, duhet së pari të reformojnë vetveten. Në përpjekjet për të bindur të tjerët që t'i ndjekin në udhën për një botë më të mirë, ata duhet të largojnë nga bota e tyre e brendshme urrejtjen, smirën, xhelozinë dhe të hijeshojnë botën jashtë tyre me të gjitha virtytet dhe cilësitë.

se personat që nuk kanë siguruar afinitetin e duhur me shpirtin e vet, është mjaft e vështirë t'i përfaqësojnë rregullat morale për një kohë të gjatë...

Integriteti Personal

Ata që orvaten të reformojnë botën, duhet së pari të reformojnë vetveten. Në përpjekjet për të bindur të tjerët që t'i ndjekin në udhën për një botë më të mirë, ata duhet të largojnë nga bota e tyre e brendshme urrejtjen, smirën, xhelozinë dhe të hijeshojnë botën jashtë tyre me të gjitha virtytet dhe cilësitë. Shfaqja e atyre që janë



FETHULLAH GYLEN

larg nga vetëpërmbytja dhe vetëdisiplinimi, që kanë dështuar në pastrimin e ndjenjave të tyre, mund të duket joshëse dhe me një përmbytje të thellë në fillim, por ata nuk do të jenë në gjendje t'i frymëzojnë të tjerët ose, nëse munden në të vërtetë, sentimentet që ata zgjuan, do të shuhen shumë shpejt.

Shpirti ideal

Ata që vrapojnë në rrugën për t'i ndriçuar njerëzit, ata që përpiqen vazhdimisht për lumturinë e njerëzve, ata që u zgjasin dorën

Feja është manual parimesh hyjnore që i çojnë njerëzit, me vullnetin e tyre të lirë, në gjëra të mira e të dobishme. Është gjithmonë e mundur të gjesh mes parimeve të fesë bazat që përgatisin përparimin materialo-shpirtëror të njeriut, për rrjedhojë, lumturinë e tij në këtë e në jetën tjetër!

njerëzve të rënë në greminat e ndryshme të jetës, janë shpirtra të lartë që e kanë njohur veten, të cilët, si engjëj mbrojtës të shoqërisë mes së cilës jetojnë, përfyten me fatkeqësitë që u bien sipër shoqërisë, u vënë gjoksin furtunave, hidhen në flakë dhe rrinë vazhdimisht me gishtin në shënjestër para tronditjeve të mundshme.

Gjëja që do të na kënaqë më shumë, duhet të jenë kritikant e ardhura nga njerëzit që duam dhe për dashurinë e të cilëve jemi të sigurt. Në të kundërt, ashtu siç do të ndodhë që, si pasojë e disa të metave tona, të humbim shumë miq, nuk do të dimë edhe t'i rregullojmë shumë prej të metave e dobësive tona!


Feja

Që nga dita kur është krijuar e gjer më sot, njeriu, vetëm në atmosferën e ngrohtë të fesë e ka gjetur qetësinë e vërtetë dhe ka mundur të bëhet i lumtur vetëm në sajë të fesë. Ashtu siç është e pamundur të bëhet fjalë për moral dhe virtyt të lartë atje ku s'ka fe, është mjaft e vështirë, gjithashtu, të bësh fjalë për lumturi. Sepse burimi i moralit dhe virtytit është ndërgjegjja, kurse i vetmi element që e urdhëron ndërgjegjen, është feja, lidhja me Zotin!..

Feja është manual parimesh hyjnore që i çojnë njerëzit, me vullnetin e tyre të lirë, në gjëra të mira e të dobishme. Është gjithmonë e mundur të gjesh mes parimeve të fesë bazat që përgatisin përparimin materialo-shpirtëror të njeriut, për rrjedhojë, lumturinë e tij në këtë e në jetën tjetër!

Ata që s'e pranojnë fenë, me kohë nisin të sillen pa respekt edhe ndaj koncepteve të larta si nderi, kombi dhe atdheu...

Imoraliteti pothuaj në tërësinë e tij është zift që shpërthen prej burimit të pafesisë; po



FETHULLAH GYLEN

ashtu dhe çdo lloj grindjeje dhe anarkie janë oleandra helmuese të luginave të pafesisë...

Feja dhe shkenca e vërtetë janë si dy fytyrat e një të vërtete të vetme. Feja e shëtit njeriun nëpër rrugë të drejta dhe e çon në përfundime të lumtura. Ndërkaq, shkenca me synim dhe qëllim të përcaktuar qartë, i bën dritë para, si një pishtar, nëpër këto rrugë dhe në fushën e vet.

Feja dhe shkenca e vërtetë janë si dy fytyrat e një të vërtete të vetme. Feja e shëtit njeriun nëpër rrugë të drejta dhe e çon në përfundime të lumtura. Ndërkaq, shkenca me synim dhe qëllim të përcaktuar qartë, i bën dritë para, si një pishtar, nëpër këto rrugë dhe në fushën e vet.

Feja i drejtohet mendimit të shëndoshë, mendjes së kthjelltë dhe shkencës dhe, nga ky këndvështrim, s'ekziston mundësia e kritikës për asnjë çështje të saj. Ata që s'duan ta pranojnë atë, ose e kanë të prishur sistemin e të menduarit, ose të gabuar botëkuptimin shkencor, ose të pamjaftueshëm gjykimin...

Në saje të fesë njeriu rrok kuptimin e njerëzores dhe veçohet prej kafshëve. Në vështrimin e njeriut të pafe, njeriu nuk ka ndryshim prej kafshëve...

Njerëzimi, kohë pas kohe, ka mohuar fenë në emër të shkencës dhe ka mohuar shkencën në emër të fesë, duke nxjerrë në pah dy pamje prezente konfliktuale. Të gjitha dijet i përkasin Zotit dhe feja është prej Zotit. Atëherë si mund të jenë ato në konflikt?

Ç'prietet prej shkencës

Meqë jeta e vërtetë për njeriun mundësohet me shkencë dhe kulturë, ata që e lënë pas dore mësimin, quhen të vdekur edhe po të jenë në jetë, sepse qëllimi më i rëndësishëm i krijimit të njeriut është vëzhgimi dhe mësimi si dhe, pastaj, mësimi të tjerëve i gjërave të mësuara vetë.

Masat dhe vendimet e një individi janë të goditura me aq sa ç'janë në marrëdhënie me mendjen dhe logjikën, kurse këto zhvillohen në përpjesëtim të drejtë me shkencën dhe intuitën. Prandaj ndodh që atje ku nuk ka shkencë dhe intuitë, mendja është e ngathët, logjika, mashtruese, vendimet, të pagoditura!

Vlera njerëzore e një njeriu shquhet dhe del në shesh duke mësuar vetë, duke i mësuar dhe i ndriçuar edhe të tjerët pastaj. Kur atij nuk i shkon mendja të mësojë nëse s'di, ta rinojë veten me gjërat e mësuara e të bëhet shembull për të tjerët, mund të duket, në pamje të jashtme, se është njeri, por të le të mendosh në është me të vërtetë i tillë!..



FETHULLAH GYLEN

Synimi i mësimit është që dija t' i bëhet njeriut prijës dhe udhërrëfyes, që të ndriçohen udhët që shkojnë në përsosjen njerëzore. Për rrjedhojë, dituritë dhe shkencat që ia kanë zënë vendin shpirtit duke e shmangur krejtësisht atë, janë një barrë në shpinë të të zot, kurse intuita që nuk e orienton njeriun kah objektivat e larta, një hamallëk ndjesish dhe mendimi!..

Fuqia dhe vlera e çdo personi është sipas përmbajtjes dhe pasurisë së diturisë që ka marrë: e atij që e përdor diturinë thjesht si një element thashethemesh, po aq; e atij që, duke e përdorur diturinë si një prizëm në njohjen e materies dhe dukurive, arrin gjer në skajet më të errëta të hapësirës e që, duke marrë krahë me kulturën e vet, takohet me të vërtetat përtej natyrës, gjithashtu po aq...

Demokracia

Demokracia ka përparuar së bashku me kohën. Ashtu siç ajo ka përshkuar stadi të ndryshme në të kaluarën, do të vazhdojë të evoluojë dhe përmirësohet në të ardhmen. Gjatë rrugës, ajo do të jetë shndërruar në një sistem më të drejtë dhe human, bazuar në drejtësinë dhe realitetin. Nëse krijesat njerëzore janë konsideruar si një e tërë, pa shpërfillur dimensionin dhe nevojat shpirtërore të ekzistencës së tyre dhe pa harruar që jeta njerëzore nuk është e kufizuar me këtë jetë të vdekshme dhe që të gjithë njerëzit lakmojnë amshimin, demokracia mund të arrijë kulmin e perfeksionit dhe të sjellë edhe më shumë lumturi për njerëzimin. Parimet islame të barazisë, tolerancës dhe të drejtësisë mund ta ndihmojnë atë për ta arritur këtë.

Republika


Republika, e cila mbështetet në botëkuptimin e lirisë dhe drejtësisë së vërtetë, krahas të qenit një formë qeverisjeje e lartë dhe e sigurt, është dhe një sistem jashtëzakonisht delikat. Po qe se nuk i dilet për zot duke u kujdesur veçanërisht për këtë aspekt të saj, mbirja dhe rritja e ateizmit dhe, për pasojë, e anarkisë në gji të saj mund të bëhet e pashmangshme.

Republika e vërtetë është forma qeverisëse e shpirtit të lartësuar dhe më e përshtatshme për njeriun si qenie e nderuar. Kurse për shpirtat vulgarë ende të pamaturuar ose që nuk i kanë dalluar dot ende rrugët e përsosjes njerëzore, është një iluzion në shkretëtirë e si një çardak i varur gati në të rënë ku s' mund të dilet...

Republika ka nevojë për njerëz që ta ndjejnë dhe kuptojnë plotësisht atë. Kuvendi i saj duhet të jetë, ashtu si një kuvend të urtësh, serioz e hijerëndë, kurse veprimtaria, vërtetësi e drejtësidashëse!

Dogma dhe Islami

Nëse dogmatizëm do të thotë të pranosh ose të kopjosh diçka qorrazi pa i lënë hapësirë mendimit të lirë dhe aftësive intelektuale, atëherë në Islam nuk ka dogmatizëm. Veçanërisht në konceptimin për fenë në Perëndim, dijet dhe besimi janë konsideruar gjëra të ndryshme. Kurse në Islam ato plotësojnë njëri-tjetrin. Kurani insiston që gjithsecili duhet të shfrytëzojë aftësitë e tij mendore, mendimin e lirë, arsyetimin, reflektimin, thellimin, kritikimin dhe vlerësimin...



FETHULLAH GYLEN

Islami, Teokracia dhe Tirania

Disa njerëz ashtu siç mund të shfrytëzojnë gjithçka me qëllim të keq, mund ta shfrytëzojnë dhe Islamin dhe ta përdorin fenë për rregulla despotike. Por kjo nuk do të thotë që Islami ka një aspekt despotik. Një pretendim i tillë vjen për shkak të trajtimit të çështjes në mënyrë jokorrekte. Islami nuk ka asgjë të përbashkët me teokracinë që në një kontekst është një sistem qeverisjeje i ushtruar nga interpretimi i etërve të kishës. Në Islam nuk ka hierarki klerikale zyrtare ose një sistem klerikal.

Fundamentalizmi

Fundamentalizëm do të thotë aderim fanatik dhe dogmatik në një besim. Ai nuk ka asgjë të përbashkët me Islamin edhe nëse disa njerëz i njehsojnë lëvizjet iraniane dhe saudite me fundamentalizmin. Por kjo nuk do të thotë që Islami e parasheh fundamentalizmin. Versionet iraniane dhe saudite janë të veçanta në vetvete duke rrjedhur nga sektet pasuar nga secili prej tyre. Shumica e myslimanëve nuk i pranojnë as njërin, as tjetrin. Është gabim që ta konsiderosh Islamin si fundamentalizëm dhe myslimanët si fundamentalistë. Çështja është mbyllur në konfuzionin konceptual dhe së pari duhet të qartësohet kjo.





FETHULLAH GYLEN



KONFERENCA DHE SEMINARE MBI LËVIZJEN GYLEN

“Idetë e Gylenit i kanë kapërcyer kufijtë mes shteteve. Idetë e tij janë të tilla që përfshijnë gjithë njerëzimin dhe kapërcejnë çdo kufi”



FETHULLAH GYLEN

Konferenca mbi Gylenin në Washington

Universiteti Georgetown në Washington D.C, organizoi në nëntor të 2008 konferencën me temë “Islami në Epokën e Ndryshimeve Globale: Këndvështrimet Alternative të Lëvizjes Gylen”. Në fjalën e tij të hapjes, At Thomas Michel, pedagog në Universitetin Georgetown dhe ish- i ngarkuar me punë i Vatikanit në çështjet e dialogut ndërfaqet, tha se Lëvizja Gylen, është e rëndësishme për sa i përket dialogut ndërfaqet, edukimit global dhe reduktimit të varfërisë. Në konferencën që zgjati dy ditë folën 35 profesorë të shkencave të ndryshme duke analizuar në aspekte të shumanshme rëndësishme të Lëvizjes Gylen në kohët tona.

Lëvizja Gylen Vlerësohet me Çmim për Kontributin në Fushën e Paqes

Lëvizja Gylen, e drejtuar nga intelektualit dhe dijetari i mirënjohur dhe i respektuar Fethullah Gylen, la gjurmën e saj në një konferencë të mbajtur në Kajro ku morën pjesë shumë akademikë dhe intelektualë të cilët vlerësuan Lëvizjen për kontributin e saj në paqen botërore.

E organizuar nga përpjekjet e përbashkëta të Akademisë së Shkencave të Rusisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, u mbajt në Moskë Konferenca e titulluar

“Traditat Kulturore të Egjiptit dhe Lindjes; nga Kohët e Lashta deri tek Globalizimi.” Kjo konferencë, u nderua me pjesëmarrjen e shumë akademikëve dhe intelektualëve nga Rusia, Gjermania, Franca, Turqia, Egjipti dhe Austria. Profesor Huda Daweesh nga Zagazig University në Egjipt tha: Çdo gjë që të vjen në mendje në lidhje me këtë Lëvizje është prehëse dhe paqësore.”

Profesor Willy Augustat, president i Shoqatës Ndërkombëtare të Paqes Nëpërmjet Kulturës, e përshkroi Lëvizjen e Gylenit, si një Lëvizje globale që kontribuon në paqen botërore. “Baza e kësaj Lëvizjeje është Islami. Ajo përpiqet ta aftësojë botën islame, për të gjetur identitetin e vet”, tha ai.

Lëvizja Gylen Diskutohet në Universitetin e Potsdamit në Berlin

Kontributi i Fethullah Gylenit në nxitjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe tolerancën ndërmjet kulturave, si dhe Lëvizja e emërtuar sipas tij, u bënë objekt diskutimesh në një konferencë dy ditore, e cila nisi më 26 maj 2009, në Universitetin e Potsdamit në Berlin.

Konferenca e titulluar “Myslimanët Mes Traditës dhe Modernizmit: Lëvizja Gylen si Urë Bashkëpunimi Ndërmjet Kulturave”, pati gjashtë panele diskutimesh, çdonjëri prej të cilëve, filloi me nga katër prezantime nga akademikë të shquar, të cilët vinin nga



FETHULLAH GYLEN

vende të ndryshme si SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Holanda, Suedia, Australia dhe Kazakistani, pa harruar edhe përfaqësuesit e ardhur nga Gjermania dhe Turqia.

Mësimet e Gylenit Analizohen në Basenin e Mendimit Amerikan CSIS

Idetë, botëkuptimi dhe mësimet e Fethullah Gylenit, dijetar islam turk, i njohur për përpjekjet e tij në fushën e tolerancës dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet kulturave, u diskutua në një takim të mbajtur të mërkurën, nga një basen mendimtarësh të shquar amerikanë të Qendrës për Studime Strategjike Ndërkombëtare (CSIS).

Alp Aslandogan, anëtar i bordit të Institutit Gylen në SHBA, e përkufizoi Lëvizjen Gylen si një organizatë e cila mbështet dialogun ndërfaqësor dhe kundërshton dhunën. Ai theksoi gjithashtu se kjo Lëvizje është e hapur ndaj çdo grupimi kulturor, etnik apo fetar.

Mes çështjeve që paraqitën mjaft interes në gjirin e pjesëmarrësve të takimit ishte marrëdhënia midis kësaj Lëvizjeje dhe politikës. “Lëvizja është e pozicionuar në një distancë të barabartë nga të gjitha partitë politike. Preferencat e saj politike nuk bazohen mbi parti, por përkundrazi, mbi vlera dhe pikëpamje. Mes këtyre vlerave janë: ‘lufta kundër korrupsionit’, ‘krijimi i një shoqërie demokratike’, si dhe ‘një qëndrim i palëkundur kundër abuzimit

me pushtetin politik””, theksoi Aslandogan.

Rreth problemit të së ardhmes së Lëvizjes së Gylenit nëse Gylen i cili është frymëzuesi i Lëvizjes vdes, Aslandogan tha: “Kjo nuk është një Lëvizje e bazuar mbi individët. E çfarë ndodhi me lëvizjen e dijetarit sufi të shekullit të XIII Mevlana Xhelaledin Rumi, kur ai vdiq? Mësimet dhe misioni i tij prapë se prapë e arritën qëllimin e tyre.

Roli i Lëvizjes Gylen në Dhomën e Lordëve në Londër

Ndikimi potencial i Lëvizjes Gylen në të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e botës myslimane, u shqyrtua në një Konferencë të titulluar “Bota Myslimane në Tranzicion: Kontributi i Lëvizjes Gylen,” të mbajtur më 25-27 tetor 2007, në Dhomën e Lordëve në Londër.

E organizuar nga Instituti i Lindjes së Mesme dhe Universiteti Metropolitan i Lidsit, konferenca shqyrtoi kontributin teologjik dhe intelektual të Fethullah Gylenit, pozicionin e tij brenda kontekstit të historisë intelektuale të Islamit modern, si dhe mbi interpretimet e tija në lidhje me çështjet që kanë lidhje me besimin. Projektet e Lëvizjes që kanë të bëjnë me marrëdhëniet Lindje-Perëndim, bashkëpunimin ndërmjet qytetërimeve si dhe në fushën e luftës ndaj terrorizmit global, përbënin çështje të një interesi të veçantë, në lidhje me qëllimin e konferencës. Ndryshimet radikale, sociale, ekonomike, politike dhe intelektuale, të



FETHULLAH GYLEN

cilave u është nënshtruar bota myslimane që nga koha e kontaktit të saj me Perëndimin, u diskutuan gjerësisht në këtë konferencë. Qëllimi i saj ishte të ekzaminojë me hollësi natyrën dhe thellësinë e këtij ndryshimi, si dhe impaktin e Lëvizjes Gylen në botën bashkëkohore myslimane në veçanti, dhe në marrëdhëniet ndërmjet Perëndimit dhe Islamit në përgjithësi.

“Kontaktet e Lindjes dhe Perëndimit: Lëvizja Gylen” në Kaliforni, SHBA

Konferenca ndërkombëtare me temë: “Kontaktet e Lindjes dhe Perëndimit: Lëvizja Gylen”, u mbajt më 4-6 dhjetor 2009, në Universitetin e Kalifornisë Jugore në Los Angeles Kaliforni, SHBA. Kjo pasoi konferencën e mëparshme rreth Lëvizjes Gylen, të mbajtur në Universitetin Georgetown (2008), në Shtëpinë e Lordëve dhe në Shkollën Ekonomike të Londrës (2007), në Universitetin e Oklahomas në 2006, si dhe në Rice University (2005).

Ndërkohë që globalizimi ka sjellë tkurrjen e botës dhe në daljen në pah të veçorive të Lindjes dhe Perëndimit, ai ka paraqitur gjithashtu edhe sfida të reja për të gjithë. Lëvizja Vullnetare e frymëzuar nga Gylen, ka organizuar aktivitete që mundësojnë dialogun, me qëllim shmangien e konflikteve fetare; ka themeluar institucione edukative për të luftuar injorancën, si dhe ka themeluar organizata bamirëse dhe shoqata biznesi

për të mposhtur varfërinë. Ajo përbën një mundësi unike, për diskutime konstruktive në lidhje me këto sfida globale dhe gjetjen e zgjidhjeve të tyre. Kjo konferencë, i shqyrtoi këto çështje nga këndvështrimi i Lëvizjes Gylen dhe në veçanti, eksploroji impaktin e një lëvizjeje myslimane në rendin e ri botëror.

“Ne duhet të krenohemi me lëvizjen e pazëvendësueshme Gylen e cila zotëron slogane të cilët përfshijnë edhe bazat e Islamit edhe ato njerëzore”, u shpreh Dr. Reza Aslan nga universiteti i Kalifornisë.

Dr. Jill Carol, nga Universiteti Houston Rice shpjegoi se ana më ndikuese e lëvizjes është ndjenja e përgjegjësisë dhe çdo lëvizje e bukur nuk lidhet me kërkesat individuale, por lidhet me kërkesën dhe nevojën e gjithë shoqërisë.

Konferenca e Melburnit Diskuton mbi Kontributin e Gylenit në Paqen Botërore

Lëvizja sociale e frymëzuar nga Fethullah Gylen, theksi i Lëvizjes në dialog dhe kontributi i saj në paqen dhe edukimin botëror, u diskutua në një konferencë të mbajtur gjatë dy ditëve të fundit në Australi.

Konferenca e mbajtur në Melburn në datat 15 dhe 16 korrik, mblodhi së bashku mbështetës të dialogut ndërfaqet dhe



FETHULLAH GYLEN

multikulturalizmit. Diskutantët e vunë theksin në faktin se përpjekjet e Gylenit për të nxitur dialogun ndër fetar kanë kontribuar në zvogëlimin e tensioneve ndërmjet besimeve të ndryshme fetare. Konferenca e titulluar “Nga Dialogu drejt Bashkëpunimit,” u zhvillua me partneritetin e Katedrës Fethullah GYLEN të Studimeve rreth Islamit dhe Marrëdhënieve Myslimano-Kristiane të Universitetit Katolik Australian si dhe Monash University. Fjala e hapjes së kësaj konference, në të cilën morën pjesë shumë akademikë nga mjaft vende të botës, u mbajt nga Xhejms Gobbo, ish-gubernator i Viktorias dhe kryekëshilltar i Mbretëreshës në çështjet e multikulturalizmit.

Ndër diskutantët morën pjesë Prof. Thomas Michell, Abdullah Ajmaz dhe Prof. Daniel A. Madigan. Në fjalën e tij, Ajmaz tha se Gyleni ka predikuar dashuri, miqësi, vëllazëri dhe respekt për çdo njeri në ligjëratat e tij. Ai gjithmonë e ka parë shkakun e shumicës së problemeve që shqetësojnë sot botën të lidhur me injorancën, varfërinë dhe kontradiktat.”

Ajmaz gjithashtu shpjegoi se si ato qindra shkolla të hapura në mbarë botën nga Lëvizja GYLEN kanë ndihmuar në dhënie dhe kontributit për paqe në mbarë botën, menjëherë pas themelimit të tyre. “Shkollat në Bosnje i bashkuan myslimanët dhe kristianët. Studentët në shkollat e Rusisë janë kryesisht kristianë. Veçanërisht në Filipine, këto shkolla kanë ndihmuar në zvogëlimin e diferencave ndërmjet myslimanëve dhe kristianëve, për arsye se studentë nga të dy këto besime fetare, mësojnë në këto shkolla.”

Në ligjëratën e tij të titulluar “Pyetja pa përgjigje e Nostra Aetata”, Profesor

Madigan i Universitetit Georgetown, theksoi se “Islami dhe Krishterimi, përbëjnë dy shprehje të ndryshme të së njëjtës fe dhe histori. Prandaj ndryshimet e tyre, nuk krijojnë ndonjë pengesë për harmoni në bashkëpunim.”

Mësimet e Gylenit dhe të Gandit Diskutohen në Parlamentin Rus

Mësimet e dijetarit të shquar reformator islam Fethullah GYLEN dhe Udhëheqësit shpirtëror indian Mahatma Gandhi, u diskutuan në një simpozium të mbajtur së bashku nga Instituti i Studimeve Orientale i Akademisë së Shkencave të Rusisë si dhe Partia Liberaldemokrate e Rusisë (LPDR), në dhomën e Dumas (Parlamentit Rus).

Udhëheqësi i LPDR Vladimir Zhirnovski, Presidenti i Institutit të Studimeve Orientale Rostislav Ribakov dhe përfaqësuesi i Platformës së Dialogut Eurasia të Rusisë Ali Sami Jëlldërëm ishin mes pjesëmarrësve. Gjatë mbajtjes së fjalimit të tij në këtë eveniment, Jëlldërëm theksoi se nuk ekziston asnjë hapësirë për radikalizëm, fundamentalizëm apo dhunë në mësimet e Gylenit. “GYLEN që i pari dijetar islam, i cili dënoi sulmet e 11 shtatorit 2001 në SHBA dhe masakrën e Beslanit, në të cilën gjetën vdekjen 334 pengje, kur rebelët çëqenë sulmuan një shkollë në këtë qytet në vitin 2004.”

Prof. Ribakov tha se ekziston një ngjashmëri mes Gylenit dhe Gandit dhe se ky nuk ishte vetëm mendimi i tij, por diçka e pranuar



FETHULLAH GYLEN

nga shumica e akademikëve perëndimorë. “Gylen dëshiron që njerëzimi të arrijë lartësi të reja. Ai dëshiron që kjo të ndodhë nëpërmjet kundërshtimit të dhunës. Ndaj ai bën përpjekjet e tij maksimale për t’u mundësuar njerëzve ta kuptojnë këtë ide intelektuale. Kjo përbën atë që i bashkon Gylenin dhe Gandin. Idetë e Gylenit i kanë kapërcyer kufijtë mes shteteve. Idetë e tij janë të tilla që përfshijnë gjithë njerëzimin dhe kapërcejnë çdo kufi”, tha ai.

Leonid Sukjanin, profesor i studimeve islame i Universitetit Ekonomik Rus, tha se ekziston një ngjashmëri mes Gylenit dhe Gandit në aspektin e kundërshtimit të tyre ndaj përdorimit të dhunës. Megjithatë, shtoi ai, Gyleni nuk është një politikan si Gandi. “Gylen është një intelektual, mendimtar, shkrimtar dhe një udhëheqës komuniteti. Në librat e tij, ai gjithmonë ka theksuar se qëndron jashtë politikës. Është e domosdoshme të shikojmë ngjashmërinë ndërmjet Gylenit e Gandit. Gandi ka prodhuar zgjidhje për problemet e shoqërisë në kohën e tij. Në mësimet dhe librat e Gylenit, ne gjithashtu gjejmë zgjidhje për problemet me të cilat përballet bota e sotme,” shpjegoi ai.

“Të dy këta udhëheqës, prodhuan zgjidhje të problemeve të epokës së tyre, duke u mbështetur fort në traditat kulturore të popujve respektivë. Gandi u mbështet në traditën mijëra vjeçare të Hinduizmit dhe Gylen i trajton problemet e sotme, duke u nisur nga këndvështrimi i themeleve të Islamit. Megjithatë, ai nuk kufizohet vetëm në ndjekjen strikte të parimeve bazë islame, por ai i interpreton ato në përputhje me rrethanat dhe kushtet e sotme, duke i bërë kështu këto parime më të kuptueshme dhe

të pranueshme. Kjo është ajo çfarë i bën këto dy individualitete të shquara, të ngjashëm me njëri-tjetrin,” shtoi Sukjanin.

“Ndikimet e Lëvizjes Gylen në Arritjen e Paqes Botërore” në Universitetin Maryland

Universiteti Maryland në ShBA organizoi konferencën me titull “Ndikimet e lëvizjes Gylen në arritjen e paqes botërore”.

Mes pjesëmarrësve në konferencën e organizuar nga Departamenti i Antropologjisë në Universitetin Maryland dhe forumi “Rumi”, ishin të pranishëm përfaqësues dhe akademikë të njohur, të cilët folën rreth ndikimit të lëvizjes Gylen në arritjen e paqes botërore. Konferenca u hap me fjalën e Profesor Ori Soltes nga Universiteti Georgetown. Pas tij e morën fjalën akademikë nga universitete të ndryshme të vendit, duke shfaqur mendimet e tyre. Prof. Pim Valkenberg, nga Universiteti Temple tha se “Lëvizja Gylen mbështetet në tre fusha veprimi; në arsim, në dialogun mes grupeve të ndryshme sociale dhe në fondacionet që u vijnë në ndihmë personave në nevojë. Sipas Gylenit, feja dhe paqja janë të pandara, pasi qëllimi i një myslimani është arritja e paqes së brendshme dhe të jashtme. Sipas Gylenit, një mysliman nuk mund të mbështetet vetëm në forcat e tij, pasi ka nevojë për



FETHULLAH GYLEN

bashkëpunim me të gjithë njerëzimin”, deklaroi ai.

Duke parë simpatinë e pasqyruar nga aktivitetet e lëvizjes Gylen në Shtetet e Bashkuara, u analizua dhe fakti se kjo lëvizje ka ndikuar në bashkimin e bashkësive të feve të tjera në vend.

Kofi Anan: Institucionet Gylen të rëndësishme

Instituti Gylen në qytetin Houston të Amerikës Qendrore organizoi forumin “Marrëveshja globale” ku u diskutua rreth problemeve që po përjeton bota në shekullin XXI. Në forum ishte i pranishëm edhe ish-sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan.

Duke nënvizuar faktin se duhet të përpiqemi të zgjidhim problemet që kanë lidhje me të drejtat e njeriut, solidarizimin edukativ dhe social, Kofi Anan në fjalën e tij gjithashtu theksoi se këta përpjekje përputhen me përpjekjet paralele të institutit. “Me të vërtetë që është shumë e rëndësishme të kemi institucione si “Instituti Gylen”, i cili mbledh njerëz të mendimeve dhe kulturave të ndryshme, institucione të cilat na kujtojnë edhe një herë të vërtetën që të gjithë ne jemi udhëtarë në anijen e të njëjtës botë”, u shpreh Anan.

Shefi i departamentit të Filozofisë në Universitetin e Teksasit, Prof. Mark Webb tha: “Personalisht nuk jam njohur me z.

Fethullah Gylen. Për të njohur Gylenin pashë frytet e tij. Edhe ju tani në këtë moment, në këtë sallon, mund të shihni frytet e tij”. Webb shprehu kënaqësinë e tij duke thënë se ndihej krenar të jetë pjesë e grupit të Lëvizjes Gylen. Në program morën pjesë edhe personalitete të tjera, si deputeti i Teksasit, Alma Allen; Prof. Lyn Ragsdale; dekan në Universitetin Rice; senatorët Hilmann Frazier dhe Hank Zuber, drejtori i Tv Fox 26, D’Artagnan Bebel, kryekonsulli i Anglisë Paul Lynch, etj.

Në Raportin e Davosit, Tregohet Shembulli Gylen

Institucionet arsimore dhe veprimtaria e dialogut ndërfaqetor e ndërkulturor të frymëzuara nga Fethullah Gylen, do të jetë temë diskutimi në takimin e përvitshëm të Forumit Botëror Ekonomik që do të zhvillohet në Davos të Zvicrës.

Në raportin me emër “Islami dhe Perëndimi: Raporti Vjetor Mbi Gjendjen e Dialogut”, të përgatitur nga Shoqata e Forumit Dialogu Perëndim-Islam, u theksua veprimtaria e dialogut dhe e institucioneve arsimore të udhëhequra nga mendimtari i shquar turk Fethullah Gylen. Në raport theksohet se grupet e diasporës Turke zotërojnë programe të tyre jo vetëm në Turqi, por edhe në vendet e Azisë së Mesme. Më tej, në raport thuhet se “Lëvizja e Fethullah Gylenit, origjina e së cilës është nga Turqia, e ka shtuar në masë të konsiderueshme rrjetin e tyre të institucioneve arsimore dhe



FETHULLAH GYLEN

për momentit veprojnë në afro 100 shtete.”

Në raportin prej 157 faqesh me titull “Arsimi dhe koncepti ndërkulturor”, të përgatitur nga komiteti nën kryesinë e Profesorit Xhon J. DeGioia të Universitetit Xhorxhtaun të Uashingtonit, u tregua si shembull krijimi i Katedrës së Fethullah Gylenit në Universitetin Katolik të Australisë. “Katedra mbështet zgjerimin e dialogut mes myslimanëve dhe katolikëve në Australi dhe në zonën e Lindjes së Largët dhe, krahas bashkëpunimeve të dialogut lokal, universiteti përkrah Qendrën për Dialog të Azisë së Largët.

Fethullah Gylen merr titullin Doktor Nderi nga Universiteti Leeds Metropolitan

Universiteti Leeds Metropolitan, një ndër universitetet më të famshme të Britanisë së Madhe, i ka dhënë Fethullah Gylenit titullin Doktor Nderi, për kontributin e tij në paqen dhe dialogun ndërkulturor. Titulli është dorëzuar nga rektori i Universitetit Prof. Susan Price, çmim i cili në emër të Gylenit është marrë në dorëzim nga drejtori i Fondacionit për Dialog në Angli, z. Ozcan Keles, i cili ndër të tjera tha: “Fethullah Gylen e konsideron këtë çmim si njohje e punës dhe përpjekjeve të asaj që është e njohur ndër qarqet akademike, si Lëvizja Gylen, por që vetë ai preferon ta thërrasë një lëvizje e vullnetarëve.”

Ai ka deklaruar gjithashtu se nderimi ndaj Fethullah Gylenit nderon të gjithë ata që janë frymëzuar nga mësimet dhe shembulli i tij. “Qëllimi i punës së Fethullah Gylenit përgjatë gjithë jetës së tij dhe i lëvizjes që ai frymëzon është që të kontribuojë drejt zhvillimit të një shoqërie më humane, e cila të jetë e angazhuar për mirëqenien e të tjerëve”, shtoi ai.

Prof. Elspeth Jones, mbajti gjithashtu një fjalim mbi kontributin e Fethullah Gylenit në fushat e dialogut dhe arsimit, e cila ndër të tjera tha: “Lëvizja qytetare Gylen, ka si qëllim të saj primar, të kontribuojë drejt zhvillimit të një shoqërie plotësisht humane, paqe të qëndrueshme dhe mirëkuptimi më të madh. Fethullah Gylen pohon se ne fillimisht jemi njerëz, e më pas myslimanë apo të ndonjë feje ose kulture tjetër. Ai thekson rëndësinë në shërbim të komunitetit në të cilën jetojmë, dhe personalisht është kundër çdo forme të aktivitetit terrorist apo dhune”.

Prof. Helen Rose Ebaugh: Fethullah Gylen, Zëri më i Bukur i Islamit

Prof. Helen Rose Ebaugh, pedagoge e degës së sociologjisë në Universitetin Houston dhe një ndër nismëtares e para në hapjen e degës së sociologjisë fetare në shoqërinë amerikane, prezantoi librin e saj “Lëvizja Gylen: Analiza sociologjike e një lëvizjeje sociale me origjinë islame” gjatë një konference në Belgjikë rreth Lëvizjes Gylen.



FETHULLAH GYLEN

Ebaugh pohon se dëshira për të shkruar një libër rreth lëvizjes GYLEN i ka ardhur pas sulmeve të 11 shtatorit. “Pas sulmit të kullave binjake kam vënë re fillimin e një fushate negative kundër Islamit. Myslimanët shiheshin si terroristë dhe asnjë lider mysliman nuk bënte ndonjë sqarim rreth kësaj teme. Ndërkohë, sytë më kapën një artikull në gazetën Washington Post. Në atë artikull dikush thoshte se myslimani nuk mund të jetë terrorist dhe në të njëjtën kohë terroristi nuk mund të jetë mysliman. Në çastin kur unë po kërkoja zërin e Islamit, këto fjalë më mbetën në mendje sepse Fethullah GYLEN ishte lideri i parë i cili reagoi ndaj sulmeve të 11 shtatorit. Shfaqja e Fethullah GYLENIT me deklaratat të cilat dënonin dhe mallkonin terrorin, nxori në pah një fytyrë krejt ndryshe të Islamit. Pas kësaj ngjarjeje, në një konferencë dëgjova përsëri të flitej për të njëjtin emër. Për të flitej me shumë respekt e dashuri. Më vonë vendosa të analizoj këtë emër dhe nisa të shkruaj librin.”

Duke nënvizuar se lëvizja GYLEN është një lëvizje e përhapur në të gjithë botën dhe shkollat e hapura janë zemra e kësaj lëvizjeje, Ebaugh thekson se kjo lëvizje ka arritur suksese të paarritshme dhe se thirrja për dialog dhe paqe e bërë nga vetë ajo nuk do të mbetet pa përgjigje. Ebaugh deklaroi se shërbimi i dhënë nga kjo lëvizje që ka arsimuar dhe edukuar specialistë të fushave të ndryshme nuk do të nënvlerësohet. Ajo pohon se modelet e edukimit dhe të arsimit të lëvizjes duhen marrë si shembull dhe se edhe presidenti i SHBA Barak Obama ndjen simpati për këtë lëvizje.

Prof. Ebaugh pohon gjithashtu se pasi ka nisur të studiojë rreth Fethullah GYLENIT dhe Lëvizjes GYLEN, ka marrë letra të ndryshme

të cilat e kritikojnë ashpër GYLENIN dhe Lëvizjen. “Në momentin kur kërkon të të sjellin një dokument apo provë ku të argumentojnë kritikën e tyre, ata heshtin. Sepse nuk kanë”, shton ajo.

Dirk Ficca: Çdo Feje i Duhet një Fethullah GYLEN

Drejtuesi i Parlamentit Botëror të Feve, Dirk Ficca, vlerëson përpjekjet e mendimtarit të njohur Fethullah GYLEN lidhur me dialogun ndërfaqësor, duke e konsideruar atë si një model të lakmuar për çdo fe.

“Kam shumë respekt për të nderuarin Fethullah GYLEN. Kam lexuar disa nga punimet e tij, pashë dhe lëvizjen e frymëzuar nga vetë ai. Ky njeri me gjuhën më të ëmbël është bërë burim frymëzimi për myslimanët me anë të një eksperience të hapur dhe sakrifikuese përse i përket trajtimit të vlerave më të larta të Islamit në rang botëror. Mendoj se çdo feje i duhet një Fethullah GYLEN. Dhe pika që preferoj më shumë tek ai është mosklasifikimi i tij dhe thirrjeve drejtuar myslimanëve në asnjë nga kategoritë e iluminizmit global perëndimor. Duke përdorur aspektin racional të Islamit, ai bëri thirrje për një dialog ndërfaqësor. Ai u tha myslimanëve të sillen me të tjerët si të ishin vëllezërit e tyre myslimanë. Dhe unë mendoj se çdo fe duhet të bëjë diçka të tillë. Të vlerësojë vlerat racionale. Prandaj ai për mua nuk është vetëm një hero i cili ka bërë shumë gjëra për shoqërinë myslimane, por një model i lakmuar edhe për fetë tjera”.



FETHULLAH GYLEN

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR GYLENIN

Vitet e fundit janë mbajtur mjaft konferenca për të studiuar kontributin teologjik dhe intelektual të Fethullah Gylenit. Ato e vendosin atë në kontekstin e historisë moderne intelektuale të Islamit dhe diskutojnë në lidhje me interpretimet e tij. Çështjet e tjera me rëndësi të cilat janë diskutuar dhe ekzaminuar nga ana e akademikëve, janë edukimi universal dhe axhenda ndërfaqetare e Lëvizjes Gylen. Lëvizja synon të nxisë marrëdhëniet pozitive dhe kreative, ndërmjet Perëndimit dhe Botës myslimane, si dhe të shprehë pozicionin e saj konstruktiv në fusha të tilla si demokracia, multikulturalizmi, globalizmi dhe dialogu ndërfaqetar në kontekstin e modernizmit laik.

Rileximi dhe rishqyrtimi i teksteve fetare nga ana e Gylenit në kontekstin e një Islami të rinovuar dhe të riinterpretuar, mund të përbëjë një pjesë të rëndësishme në ndërtimin e një shoqërie më të mirë njerëzore në botën e sotme. Si një intelektual fetar dhe aktivist i paqes me origjinë nga Turqia, Gylen ka ushtruar ndikimin e tij mbi shumë myslimanë në mbarë botën duke i frymëzuar ata të luajnë një rol të rëndësishëm në projekte dhe fondacione bamirëse dhe edukative. Qëllimi i tij ka qenë gjithmonë promovimi i misionit universal të Islamit, që është të shërbyerit ndaj njerëzve pavarësisht fesë, ngjyrës apo vendit të origjinës. Sfidat me të cilat përballen myslimanët në Perëndim dhe në vendet e tjera jomyslimane, janë të shumta. Këto konferenca kanë shqyrtuar gjithashtu impaktin e Lëvizjes Gylen në Botën myslimane të ditëve tona, botë e cila ndodhet në tranzicion dhe në udhëkryq si dhe marrëdhëniet ndërmjet Perëndimit dhe Islamit në përgjithësi.

Disa nga konferencat ndërkombëtare rreth Fethullah Gylenit dhe Lëvizjes së tij:

Islami në Botën e Sotme: Lëvizja e Fethullah Gylenit në Ide dhe Praktikë

Rice University, 12-13 nëntor 2005, Hjuston, Teksas, SHBA

Islami në Botën e Sotme: Lëvizja e Fethullah Gylenit në Ide dhe Praktikë

Universiteti Metodist i Jugut, 4-5 mars 2006, Dallas, Teksas SHBA

Islami në Botën e Sotme: Lëvizja e Fethullah Gylenit në Ide dhe Praktikë

Universiteti i Oklahomas, 4-5 nëntor 2006, Norman, Oklahoma, SHBA

Islami në Botën e Sotme: Lëvizja e Fethullah Gylenit në Ide dhe Praktikë

LSE, SOAS, Dhoma e Lordëve, 25-27 tetor 2007, Londër, Britani e Madhe

Islami në Botën e Sotme: Lëvizja e Fethullah Gylenit në Ide dhe Praktikë

Universiteti i Teksasit në San Antonio, 3 nëntor 2007, San Antonio, Teksas, SHBA

Iniciativat e Fethullah Gylenit për Paqe në Botën e Sotme

Woudestein Erasmus University, November 22-23 nëntor 2007, Rotterdam, Hollandë

Pikëpamjet Alternative të Lëvizjes Gylen

Universiteti Xhorxhtaun, 14-15 nëntor 2008, Washington, SHBA

Myslimanët mes Traditës dhe Modernizmit: Lëvizja Gylen si Një Urë Ndërmjet Kulturave

Universitetat Potsdam, 26-27 maj 2009, Berlin, Gjermani

Myslimanët mes Traditës dhe Modernizmit: Lëvizja Gylen si Një Urë Ndërmjet Kulturave

Universiteti Shtetëror i Luizianës, 6-7 mars 2009, Baton Rouge, Louisiana, SHBA

Lëvizja Gylen dhe Kontributi i Kësaj Lëvizjeje në Edukim dhe në Dialogun Ndërfetar e Ndërkulturor


Universiteti i Karolinës së Jugut, Universiteti i Loyola Marymount dhe Instituti Pacifica, 4-6 dhjetor 2009, Los Angeles, SHBA.

E Ardhmja e Reformave në Botën Myslimane: Krahasimi i Përvojave me Lëvizjen Gylen në Turqi

Universiteti i Kajros dhe Revista Hira, 19-21 tetor 2009, Kajro, Egjipt.



FETHULLAH GYLEN



INSTITUTET GYLEN

Qëllimi kryesor i këtij instituti, është të nxisë kërkimet akademike dhe gjithashtu të hedhë themelet e veprimtarive që kanë të bëjnë me orientimin e njerëzve drejt ndryshimeve pozitive sociale, domethënë në vendosjen e një paqeje të qëndrueshme, të drejtësisë shoqërore si dhe të harmonisë sociale, nëpërmjet fokusimit në temat e edukimit, vullnetarizmit dhe iniciativave civile.



FETHULLAH GYLEN

Instituti Gylen i Universitetit të Houstonit

Instituti Gylen u themelua në tetor 2007 si një organizatë jofitimprurëse dhe si një iniciativë e përbashkët e Universitetit të Houstonit, Fakultetit të Shkencave Sociale në këtë Fakultet, si dhe Institutit të Dialogut Ndërfetar.

Qëllimi kryesor i këtij instituti, është të nxisë kërkimet akademike dhe gjithashtu të hedhë themelet e veprimtarive që kanë të bëjnë me orientimin e njerëzve drejt ndryshimeve pozitive sociale, domethënë në vendosjen e një paqeje të qëndrueshme, të drejtësisë shoqërore si dhe të harmonisë sociale, nëpërmjet fokusimit në temat e edukimit, vullnetarizmit dhe iniciativave civile. Ndërkohë që ne e njohim dhe e pranojmë rolin vërtet të rëndësishëm të ligjeve dhe themeleve të qeverisjes, ne besojmë se çdo zgjidhje afatgjate ndaj çdo problemi themelor të njerëzimit, duhet të angazhojë iniciativat civile dhe duhet të përmbajë komponentin e edukimit. Ne besojmë gjithashtu se bashkimi i njerëzve nga prejardhje të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore rreth vlerave të përbashkëta, shpresave dhe shqetësimeve për njerëzimin, përbën një burim të rëndësishëm në këtë objektiv. Ne po projektojmë një bashkësi mbarëbotërore, në të cilën arritjet e qytetërimeve humane në fushën e marrëdhënieve njerëzore, të barazojnë apo

tejkalojnë arritjet në shkencë apo teknologji. Pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme në mbarë botën e gjejnë veten përditë e më tepër të ndërlidhur në pjesën tjetër të shoqërisë. Në këtë botë të ndërlidhur, ashtu sikurse informacioni dhe zgjidhjet përhapen me shpejtësi, e njëjta gjë ndodh edhe me keqinformimin dhe konfliktin. Vizioni ynë është të vendosë mjetet e përparuara të komunikimit, medias dhe transportit, në shërbim të harmonisë sociale. Ne synojmë të thellojmë mirëkuptimin e ndërsjellë, respektin dhe bashkëpunimin ndërmjet njerëzve nga fusha të ndryshme, duke i shërbyer kështu të gjithë njerëzve, pa asnjë lloj diskriminimi. Për përmbushjen e këtyre objektivave, instituti organizon evenimente publike si simpoziume, konferenca, seminare, dreka zyrtare, publikime veprash popullore dhe shkencore, siguron bursa për studentët, lehtëson kërkimet shkencore, mbështet vizita programesh shkollore si dhe ekskursionet me qëllime kulturore. Ndërmjet vlerave që ne mbështesim dhe nxisim janë simpatia, shpresa, dashuria për njerëzimin, dhembshuria, altruizmi, ndershmëria, dinjiteti, besnikëria, integriteti personal, bashkekzistenca paqësore, drejtësia dhe harmonia shoqërore, shmangia e konflikteve të dhunshme dhe vuajtjeve të njerëzve, parandalimi i abuzimit me substancat e ndaluara, shpëtimi i rinisë nga vetëshkatërrimi, si dhe mbrojtja e burimeve dhe rezervave të tokës.

Pikëpamjet e institutit, janë të frymëzuara nga jeta dhe veprat e dijetarit të shquar bashkëkohor dhe udhëheqësit qytetar Fethullah Gylen.



FETHULLAH GYLEN

Hapet Katedra Gylen në Universitetin Katolik Leuven

Në Universitetin Katolik më prestigjioz të Belgjikës, Leuven, është hapur “Katedra për studimet ndërkulturore Fethullah Gylen”. Katedra e formuar me iniciativën e Platformës për Dialog Ndërkulturor të Gylenit është komentuar si “një eveniment mbresëlënës”.

Me hapjen e katedrës në Universitetin Katolik Leuven, për herë të parë në Belgjikë do të zhvillohen studime akademike të iniciuara nga myslimanët. Në etapën e parë nën kornizën e një marrëveshjeje pesëvjeçare planifikohen shumë punime doktorature dhe organizime konferencash. Profesori i antropologjisë sociale dhe kulturore prof. Johan Leman i cili është ngarkuar me detyrën e drejtuesit të Katedrës Gylen bashkë me rektorin e KUL, Mark Waer, deklaruan se ndihen shumë të lumtur për hapjen e katedrës në universitetin e tyre.

Në deklaratën zyrtare, Leman nënvizoi faktin se mendimtari Fethullah Gylen nxit marrjen e iniciativave në emër të vendosjes së një ure mes Islamit dhe Perëndimit, tradicionales dhe modernes, shkencës dhe shpirtërores, logjikës dhe besimit dhe këtë e bën duke njohur demokracinë si të vetmin sistem politik frytdhënës. Duke na kujtuar dhe një herë thirrjen e Gylenit për paqe, Drejtuesi i Katedrës pohoi se shpreson në kontributin e studimeve të bëra mbi

marrëdhëniet mes popullsisë myslimane dhe pjesës tjetër, mes popullsisë myslimane që jeton në Belgjikë me atë që jeton në Europë dhe mbi konceptin ndërkulturor në procesin e krijimit të kësaj ure.

Ndërsa drejtuesi i IDP Sherafettin Pektash deklaroi se hapja e katedrës është një vazhdim i punës dhe aktiviteteve dhjetë vjeçare. “Nëse ne dëshirojmë vërtetë paqe, nëse kërkojmë një botë, rregull të pranuar nga të gjithë, atëherë duhet të marrim përgjegjësitë tona. Të mbash përgjegjësi do të thotë të marrësh iniciativë dhe ne si IDP jemi përpjekur vazhdimisht për marrjen e nismave të reja. Kemi kaluar shumë pengesa por ne nuk ndalemi para tyre duke pyetur veten pse ndodhi kështu, apo të ofendojmë. Ne jemi përfaqësuesit e këndvështrimit i cili kërkon zgjidhje për problemin”, u shpreh Pektash. Leman dhe Waer pohuan se pas marrëveshjes pesëvjeçare ekziston një mundësi e madhe të shtyhet edhe për pesë vite tjera.

Universiteti Australian Promovon Katedrën Fethullah Gylen

Promovimi zyrtar i Katedrës Fethullah Gylen në Fushën e Studimit të Islamit dhe Marrëdhënieve Myslimano-Katolike, u bë në Universitetin Katolik Australian në



FETHULLAH GYLEN

Melburn Viktoria. Presidenti i Viktorias Xhon Brambi, falenderoi Shoqërinë Australiane për kontributin në fushën e paqes në këtë vend. Guvernatori i Viktorias, profesor David de Kretser dhe presidenti i nderit i Shoqërisë Ndërkulturore Australiane Mehmet Ali Shengul, drejtuan sëbashku ceremoninë e hapjes zyrtare të kësaj katedre.

Prof. Dr. David De Kretser tha: “Për vite me radhë, ka pasur konflikte me karakter fetar ndërmjet protestantëve dhe katolikëve në Irlandë, shiitëve dhe sunivenë Irak. Kërkimet dhe studimet në fushën e marrëdhënieve shoqërore janë mjaft të rëndësishme nga pikëpamja e parandalimit të konflikteve të tilla. Siç thotë Fethullah GYLEN: “Për një botë paqësore, dialogu përbën detyrimin kryesor të njerëzve.” Presidenti i Viktorias Xhon Brambi në mesazhin e tij që i drejtoi pjesëmarrësve të kësaj ceremonie, tha: “Kjo katedër përbën një kontribut të rëndësishëm për strukturimin multikulturor. Unë do të dëshiroja të falënderoja anëtarët e Shoqërisë Ndërkulturore Australiane për kontributin e tyre në këtë drejtim.”

Prof. Greg Barton i Universitetit Monash të Melburnit gjatë fjalës së tij rikujtoi faktin se në ditët që pasuan ngjarjet e 11 shtatorit, myslimanët përjetuan vështirësi të mëdha, duke u bërë subjekt paragjykimesh dhe shtoi se veprimtaritë në fushën e dialogut, do të çojnë në fundin e këtyre përplasjeve ndërmjet besimeve të ndryshme fetare. Barton gjithashtu ceku edhe studimet në fushën e dialogut mbarëbotëror të kryera nga GYLEN. “Është për t’u theksuar ndjeshmëria e tij në fushën e edukimit; të gjitha këto studime të kryera prej tij në

këtë fushë, na detyruan ta emërtojmë këtë Katedër me emrin e z. GYLEN.”

Hapet Katedra Fethullah GYLEN në Universitetin më të njohur të Indonezisë

Katedra Fethullah GYLEN u themelua në një nga Universitetet më të mirënjohur të Indonezisë. Presidenti i Universitetit Islam, Siarif Hidajetullah, tha se ishte mjaft krenar për hapjen e kësaj katedre akademike. “Mesazhet e Fethullah GYLENIT për dialog dhe tolerancë po dëgjohen çdo ditë në mbarë botën”, tha ai.

“Ndihem shumë i ekzaltuar dhe i lumtur. Ne jemi krenarë për Katedrën GYLEN në universitetin tonë, për arsye se z. GYLEN është zgjedhur si intelektual më i shquar falë Lëvizjes së tij të themeluar mbi baza vullnetare.”

Profesor Komaroddin Hidajet gjatë ceremonisë së përirimit ndër të tjera shtoi: “Jemi dëshmitarë të performancës së suksesshme të shkollave turke në Indonezi si dhe të ideve të Fethullah GYLENIT përsa i përket parashtrimin të rrugëve të zgjidhjeve për problemet e njerëzve në epokën tonë. Ndaj unë shpresoj që kjo Katedër do të përbëjë një mundësi të mirë për afrimin e mëtejshëm të dy vendeve tona.”



FETHULLAH GYLEN



Fethullah Gylen Në Prizmin e Intelektualëve Shqiptarë

Mendojmë se është e domosdoshme që edhe në hapësirën shqiptare, krijimtaria e shumanshme, polivalente e Fethullah Gylenit të trajtohet teorikisht e politikisht, jo vetëm nëpërmjet iniciativave individuale, por edhe me mënyrë të institucionalizuar e sistematike.



FETHULLAH GYLEN

Përse e Studiojmë dhe e Besojmë Fethullah Gylenin

Prof. Dr. Adriatik Kallulli

Librat e Gylenit dhe për Gylenin, që Shtëpia Botuese “Prizmi” ka përkthyer dhe botuar këto vitet e fundit, janë ngjarje në jetën tonë kulturore, intelektuale dhe shpirtërore, ndihmesë dhe pasurim i asaj biblioteke shumë të munguar, për gati gjysmë shekulli, ku përveç disa broshurave dhe librave që anatemonin fetë, besimet dhe personalitetet me përmasa universale, nuk kishte asgjë tjetër, edhe pse në botë ekzistojnë mijëra dhe mijëra botime prestigjioze, të ribotuara dhe të përkthyer në dhjetëra gjuhë të botës.

Librat e Gylenit janë plotësime të domosdoshme të një biblioteke të munguar. Natyrisht që zgjedhja dhe prurja e një mendimtari s’duhet të përbëjë rastësi. Dhe rasti i Gylenit nuk është aspak i tillë. Pasi ka fituar reputacionin më të lartë gjithëkombëtar, të një populli njëqind milionë banorësh, me tradita të moçme dhe shumë të pasura, pasi e ktheu veprimtarinë dhe doktrinën e tij në një dritë-ndriçuese për çdo bashkëkombas, mbasi arriti ta hedhë atë edhe në praktikë, duke përfutur lëvizjen e madhe Gylen, si fare pak të gjallë, u vendos në piedestalin e nderit, duke gëzuar ditaditës një mbështetje përherë e më të gjerë, duke lindur solidaritet, kredibilitet dhe veprime që sjellin humanizëm.

Si fillimisht, një njeri i vetëm arriti të futet në zemrat e shumë njerëzve, të shtresave më

të ndryshme, të bëhet shumë i afërt dhe i besueshëm për ta, t’u përçojë idetë, vizionet dhe synimet e veta, t’i solidarizojë me njëri-tjetrin, t’i vërë në një lëvizje të paparë humaniste dhe progresiste, t’i kthejë në një forcë aktive rindërtuese dhe ripërtëritëse? Me ç’mjete e kreu gjithë këtë mision të rrallë në tërë historinë e brezave të fundit?

Vetëm me mendimin e tij thellësisht human, thellësisht koherent dhe konsekuent, të qartë, të kthjellët, komunikues dhe atraktiv. Që nga fjalimet dhe ligjërimet më të para,

Që nga fjalimet dhe ligjërimet më të para, deri te librat e panumërt, të një rëndësie problemore gjithnjë në rritje, Gyleni në gjysmë shekulli krijimtari dhe veprimtari shfaqet para gjithë audiencës së tij shumë të madhe me të njëjtat rrënjë doktrine dhe mendimi, me të njëjtin besim të konsoliduar dhe përherë të ripërtërirë.

deri te librat e panumërt, të një rëndësie problemore gjithnjë në rritje, Gyleni në gjysmë shekulli krijimtari dhe veprimtari shfaqet para gjithë audiencës së tij shumë të madhe me të njëjtat rrënjë doktrine dhe mendimi, me të njëjtin besim të konsoliduar dhe përherë të ripërtërirë, me të njëjtat afirmime të mëdha, me po ato kritika me të cilat e nisi rrugën.



FETHULLAH GYLEN

Kjo koherencë dhe konsekuencë gjysmëshekullore ku shkëlqen e rrëzëllen besimi dhe vlerësimi islam, ku ndriçon erudicioni, njohja e filozofisë, kontradiktave, përvojave, veprave të personaliteteve, e bën atë, në çdo vepër të tij, me dimensione dhe thellësi enciklopedike. Këto janë disa nga arsyet që e kthyen personalitetin e tij në një humanist të dimensioneve planetare. Duke studiuar me laps në dorë çdo vepër të përkthyer, ne shohim se në hapësirat e fletëve të tij lulëzon dhe valëvitet i njëjti grurë farëmirë, i njëjti polen që fekondon bimët, e njëjta erë e ngrohtë përtëritëse pranverore: Gjersa ekziston njeriu, feja është vetvetiu shpirtërore. Ripërtëritja shpirtërore është akt i përhershëm i secilit njeri. Kryhet përmes vetes dhe të tjerëve, përherë përmes zanafillës dhe besimit. Kujdes rrënjët e hershme dhe të moçme. Ruajini fort ato sepse në to është identiteti dhe përhershmëria e përtëritjes. Në to është kodi i përhershëm i katharsit të çdo individi dhe bashkësie. Alternativat nuk sajohen, por gjenden dhe nxiten nga prirjet historike të zhvillimit njerëzor. Konfliktualitetet janë të zgjidhshme nëse ekziston logjika, dashuria, toleranca dhe mirëkuptimi. Jo te disa, por me prirje për t'u shtrirë e përhapur te të gjithë. Të përjashtuarit përfshihen mandej në turmën amorfe, në kontingjentë dhune, terrorizmi dhe prapakthimi.

Ripërtëritja për Gylenin është njëherazi mendim, ndjenjë dhe veprim. Është afirmim rrënjësh dhe vazhdim i tyre. Kjo sjell rilindjen e përhershme, të pandërprerë dhe gjithëpërfshirëse. Përmes këtij procesi që zgjatet dhe bartet në breza, riparohet "logjika e lëkundur". "Trashëgimtarët e

tokës" nuk janë specie e re, por specie në vazhdim. Trungje që zgjerohen me rathë të tjerë. Kombi u rikthehet rrënjëve, s'ka kurrfarë nevojë të mëkohet nga rrënjë të tjerë. Ndërtimi dhe zëvendësimi i tyre është me pasoja shumë të rënda. "Kombi që mbart përbrenda zjarrin e thellësisë" nuk ngrin kurrë. Brenda kombit gjendet "zjarri i thellësisë së rilindjes". Edhe orientimet themelore janë primordiale dhe s'është nevojë të ndërrohen. Parimet e moçme s'janë relike muzeale.

Natyrisht që në procesin e gjatë të progresit dhe të përsosjes kemi shumë nevojë "për mendje të plota gjithëpërfshirëse", "për doktorët e shpirtave", për "plejadën e njerëzve të kualifikuar, për heronj që dinë të shuajnë "mosbesimin errësues", për ata që dinë ta kthejnë besimin në dashuri, për ata që arrijnë ta zotërojnë "të menduarit matematik", por jo pa zemër për "heronjtë e mendimit dhe të veprimit", sepse një kohë pa prometej është e vdekur. Vetëm të tillët mund të jenë "arkitektët e shpirtave tanë, "skulptorët që mund të gdhendin statujën sublime të shpirtave tanë. Kjo statujë mund të ngrihet, mund të lartësohet, mund të qëndrojë e palëkundur në sheshet e të sotmes dhe të ardhmërisë. Qëndron e palëkundur sepse krejt ndryshe nga statujat e mermerta, të bronzta, ajo është në radhë të parë shpirtërore. Si e tillë ajo jeton përherë dhe ripërtërihet përherë. Janë vetëm disa pak mendime këto nga burimi i dliirë dhe i pashtershëm që përmban dijetari Gylen.

Kumtesë e mbajtur në "Promovimin e Ideve të Gylenit", Tiranë, Mars 2010 (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN

Fethullah Gylen dhe Modeli Shqiptar

Dr. Ferdinand Xhaferi

Fethullah Gylen përfaqëson një figurë poliedrike ku bëhet bashkë shkrimtari dhe poeti, aktivisti i paqes dhe reformatori shoqëror, studiuesi islam dhe predikuesi karizmatik i tij. Pra një figurë ku shkrihet në një të vetme përfaqësuesi masivist i popullit, me përfaqësuesin e komunitetit akademik. Gyleni ka qëndruar jashtë angazhimit në politikën zyrtare dhe është bërë popullor për myslimanët dhe jomyslimanët edhe jashtë kufijve të Turqisë si pasojë e mospërqafimit të një platforme politike, por duke lançuar platformën e dashurisë dhe të tolerancës.

Modeli i Gylenit, sikurse duket edhe në librin “Dashuri dhe Tolerancë”, është në esencë një integrim i kulturës turke me Islamin në funksion të promovimit të tolerancës dhe dialogut. Ky model që paraqet produkte të tij tolerancën dhe dialogun, natyrshëm është tërësisht i integrueshëm edhe me kërkesat bazë të mirëfunksionimit të një demokracie liberale. Myslimanët shqiptarë lehtësisht konstatohet se ndjekin mendimin e Gylenit të bashkekzistencës së traditës me Islamin në funksion të dialogut dhe tolerancës. Kjo ka sjellë që Shqipëria, një vend me shumicë myslimane, nuk ka

pasur asnjëherë konflikte të armatosura për çështje fetare.

E shkuara dhe e tashmja e myslimanëve shqiptarë shikohet se shkon sipas modelit të Gylenit. Kështu, ndjenjat e tolerancës dhe të respektit reciprok janë shfaqur që në vitet e para të konvertimit të shqiptarëve në myslimanë. Gjithashtu është pranuar nga studiues të ndryshëm se ndjenja e kombësisë tek myslimanët shqiptarë nuk është ngatërruar me çështjet fetare. Kështu Lordi Bajron ka shkruar “I dua shqiptarët, nuk janë të gjithë myslimanë; disa nga fiset e tyre janë të krishtera. Feja nuk i bën te ndryshojnë zakonet e tyre. Ndërsa kleriku Anglez, Hygens, bashkëkohës i Bajronit, ka shkruar: “Muhamedani shqiptar nuk është i ngrirë. Ai shpeshherë merr për grua një të krishterë, merr me vete në xhami djemtë, kurse vajzat i lë të shkojnë me t’ëmën në kishë dhe ai vetë shkon me radhë në të dy qendrat e kultit”.

Janë edhe shumë aspekte nderimi dhe bashkëpunimi të myslimanëve shqiptarë për besimtarë të feve të tjera që formësojnë një konkretizim në praktikë të ideve të Gylenit për Islamin e vërtetë që bazohet në paqe, tolerancë dhe bashkekzistencë paqësore me fetë e tjera.

Hafiz Ali Kraja (Tari) në varrimin e At Gjergj Fishtës do thoshte: “vepra jote o poet ka për



FETHULLAH GYLEN

të krijue një faqe të lavdishme në historinë e kombit..”

Po kështu bashkëpunimi njih formë të organizimit të konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta siç ishte “Konferenca e përbashkët e fetare për mbrojtjen e paqes”. Po kështu është krijuar tradita e shkëmbimit të konsideratave reciproke në ditët e festave fetare.

Shumë interesant është fakti se Gylen integrohet me realitetin shqiptar dhe është shprehës i këtij realiteti edhe për njollën e errët që mbart historia e Shqipërisë me

Pra, Gylen arrin të argumentojë me një logjikë të pakundërshtueshme se rendi shoqëror i mijëvjeçarit të ri mund të administrohet me sukses vetëm me alternativën e dialogut dhe të tolerancës.

diktaturën 50 vjeçare ku Islami dhe të gjitha fetë për afro katër dekada jo vetëm u ndaluan, por predikuesit u përdoqën dhe u keqtrajtuat.

Së fundmi, unë do të kisha dëshirë të evidentoja një fakt tjetër lidhur me teknikën që përdor Gyleni në shpjegimin e vlerave të dialogut dhe të tolerancës fetare. Më konkretisht në ligjëratën e tij “Islami një

fe për tolerancën” por edhe në të gjitha ligjëratat që formësohen duke pasur si bazë harmoninë fetare, tolerancën dhe dialogun ndërfetar, z. Gylen nuk analizon apo kritikon të tjerët, pavarësisht propagandës që qarkullon kundër Islamit. Me shumë finesë, z. Gylen mbetet i vendosur në principet e tij për të thënë se si janë të rrënjësura në Islam toleranca, harmonia, dashuria dhe dialogu. Pra, nuk shfaqet në të gjitha ligjëratat e tij asnjë luhajtje për t’u shmangur nga misioni bazë për t’i sqaruar jomyslimanët lidhur mbi të vërtetat e Islamit, por edhe për të orientuar dhe qartësuar myslihanët se suksesi në sfidat që po ndeshin është i garantuar vetëm duke qenë shprehës të nevojës për dialog dhe promovues të tolerancës nëpërmjet edukimit dhe vetëpërmirësimit. Pra, Gylen arrin të argumentojë me një logjikë të pakundërshtueshme se rendi shoqëror i mijëvjeçarit të ri mund të administrohet me sukses vetëm me alternativën e dialogut dhe të tolerancës. Jemi me fat që edhe myslihanët shqiptarë orientohen në veprimtarinë e tyre të përditshme sipas modelit që ka kultivuar dhe kultivon Fethullah Gylen.

Referat i mbajtur në promovimin e librit “Drejt një Qytetërimi Botëror me Dashuri dhe Tolerancë, Tiranë, Qershor 2006. (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN

Gyleni, Një Thirrje Për Dialog Kulturor

Prof. Dr. Zyhdi Dervishi

Në opusin e krijimtarisë teorike e shkencore, filozofike e teologjike, eseistike e politike të Fethullah Gylenit artikullohet dendur fjala oqean. Mendoj se e gjithë krijimtaria e tij shpirtërore që komunikon harmonishëm me të kaluarën, të tanishmen dhe të ardhmen e të gjitha kulturave, shkencave, arteve, dhe feve është jo një oqean, por një megaoqean eterik dijesh dhe mirësie, kuptimesh shkencore përgjithësuese dhe botëbesimesh

Mendojmë se është e domosdoshme që edhe në hapësirën shqiptare, krijimtaria e shumanshme, polivalente e Fethullah Gylenit të trajtohet teorikisht e politikisht, jo vetëm nëpërmjet iniciativave individuale, por edhe me mënyrë të institucionalizuar e sistematike.

polivalente, që reflektojnë në një version sintetik origjinal bashkëkohës gjithë oqeanet e trashëgimisë shpirtërore të njerëzimit.

Veçanërisht gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, ndër gazetarët, veprimtarë shoqërorë,

madje edhe ndër studiuesit profesionistë të çështjeve sociale janë shtuar zërat që përpiqen të arsyetojnë tezën se aktualisht, dhe sidomos në të ardhmen, konfliktet ndërmjet kulturave, ndërmjet qytetërimeve do të përcaktojnë disa profile kryesore përcaktuese të zhvillimit të njerëzimit. Një nga artikulluesit dhe zhvilluesit kryesorë të një teze të tillë, sociologu amerikan bashkëkohës Samuel Huntington, ndër të tjera, ka shkruar: "...disa marrëdhënie ndërqytetërore janë më të pritura për konflikte sesa disa të tjera... Në makronivel ndarja mbisunduese është ndërmjet 'Perëndimit dhe të tjerëve', ndërsa konfliktet më të forta ndodhin ndërmjet shoqërive myslimane e aziatike, nga njëra anë, dhe Perëndimit, nga ana tjetër. Përplasjet e rrezikshme në të ardhmen ka gjasa që të shkaktohen nga ndërveprimi i arrogancës Perëndimore, intolerancës islamike dhe vetësigurisë aziatike". Kësisoj Huntington, e sheh të sotmen dhe e parasheh të ardhmen me lentet e turbulluara nga tymi i barutit ose i rrezeve radioaktive të luftërave ndërkulturore dhe ndërqytetërore. Ndryshe nga ky teoricien që i keqtrajton qytetërimet e popujt si reparte luftarake përballë njëri-tjetrit, Fethullah Gylen e sheh njerëzimin si një tërësi organike, që në kodin e vet gjenetik nuk ka të programuar luftën vetëshkatërrimtare, por mbijetesën harmonike. Faktorët që provokojnë përplasjet rrënimtare të njerëzimit Gylen i konsideron të përkohshme dhe jashtë natyrës humaniste të kulturave dhe popujve. Nga përplasia ndërmjet tyre, aq sa shkatërrohen popujt e qytetërimet, rrënohet njëherazi gjithë njerëzimi. Duke i



FETHULLAH GYLEN

karakterizuar raporte të tilla në mënyrë të figurshme dhe i frymëzuar nga një konstante altruiste në gjykimet e veta, Fethullah Gylen, shkruan: “Njerëzimi është një pemë dhe popujt janë degët e tij... Ngjarjet, si erëra të forta, i përplasnin ato me njëra-tjetrën. Dhe, natyrisht, dëmin e pëson pema.” Dhe kësajsoj dëmtohet pema e njerëzimit, që është krijimi më i mrekullueshëm në planetin tonë.

Me të gjithë energjitë shpirtërore dhe krijimtarinë e tij të shumanshme, Fethullah Gylen ka qenë dhe mbetet i angazhuar në betejat pa shumë zhurmë, por më të vështira të paqes, për paqëtimin e marrëdhënieve ndërmjet qytetërimeve, ndërmjet popujve, ndërmjet individëve. Në panteonin e heronjve të paqes të historisë pesë mijëvjeçare të njerëzimit, Fethullah Gylenin e vendosin krahas Budës e Gandit, krahas Martin Luterit dhe Nënë Terezës. Si arkitekt dhe strategvizionar i betejave paqësore për paqëtimin e marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, pavarësisht nga përkatësia qytetërimore e kulturore, nacionale e fetare, gjinore e profesionale, Fethullah Gylen vazhdimisht ka bërë apel për të tejkaluar frymën e kriterizimit të sëmurë, frymën e polemikave të pafrytshme për ngjarjet e të kaluarës, frymën e urrejtjes rrënimtare, pikësynimin e përhershëm për t’i hapur rrugë dialogjeve në shumë rrafshe, veçanërisht dialogut ndërfetar. “Kritika e çdo gjëje, kundërshtimi për çdo gjë, s’janë veçse, për çdo herë një akt shembjeje.”. Fethullah Gylen i kundërvihet çdo procesi e dukurie sociale që krijon gërmadha, sidomos në vlerat shpirtërore të njerëzve.

Ai është zëdhënësi më i kualifikuar i idesë së dialogut, që synon të mbajë gjithnjë hapur dhe me kapacitet të plotë komunikimet e shumanshme ndërmjet qytetërimeve, popujve dhe besimeve. “Dialogu ndërfetar është sot një domosdoshmëri dhe hapi i parë për vendosjen e tij është harrimi i të kaluarës, shmangia e argumenteve polemizuese, dhe dhënia përparësi pikave të përbashkëta, të cilat janë më të shumta se polemikat.”

Krijimtaria mendore e shpirtërore e Fethullah Gylenit është e përmasave të tilla që i ka kapërcyer me kohë kufijtë e çdo nderimi. Përkundrazi, janë të nderuar me merita humanizmi e altruizmi të gjithë ata që, jo vetëm e studiojnë me vëmendje, por edhe udhëhiqen praktikisht prej saj për zgjidhjen sa më racionale të të gjithë problemeve të mëdha sociale e kulturore, religjioze e morale që përjeton çdo popull në ditët tona. Nga studimi i vëmendshëm i veprës së Fethullah Gylenit edhe ne shqiptarët gjejmë çelësa për zgjidhjen imediate dhe perspektive të mjaft problemeve të natyrave të ndryshme që traumatizojnë shoqërinë shqiptare të ditëve tona. Mendojmë se është e domosdoshme që edhe në hapësirën shqiptare, krijimtaria e shumanshme, polivalente e Fethullah Gylenit të trajtohet teorikisht e politikisht, jo vetëm nëpërmjet iniciativave individuale, por edhe me mënyrë të institucionalizuar e sistematike.

Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin “Dialogu Ndërfetar e Ndërkulturor Si Vlera Integruese”, Tiranë, 2008. (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN

Kontributi i Fethullah Gylenit për Dialogun Ndërfetar dhe Ndërkulturor

Prof. Dr. Muhamet Pirraku

Shkallët e ngritjes intelektuale të Gylenit tregojnë për një personalitet të rrallë në histori, me njohuri enciklopedike në shërbim të njeriut dhe të njerëzimit. Gylen, që në moshën 19-vjeçare shtroi kërkesa për reformimin e sistemit shkollor dhe universitar në Turqi, të cilat do të siguronin ngritjen shpirtërore të rinisë dhe zhvillimin modern të ekonomisë së vendit e të botës në përgjithësi, mbi bazë të arritjeve shkencore perëndimore, sikundër edhe demokratizimin e shoqërisë turke dhe të vendeve myslimane, si vlerë e pandashme e rendit të ri demokratik botëror. Projektin e tij, të cilin do ta emërtojë thjesht “Shërbim” në Emër të Zotit për mirëqenien e njeriut dhe të njerëzimit, do ta mbështeste në vlerat e mendimit filozofik islam, në harmoni me udhëzimet kuranore dhe në mësimet e të Zgjedhurit të Zotit për profet të njerëzimit dhe thirrës për dialogun ndërfetar e ndërkulturor, vlera këto në themele të lëvizjes së sotme për globalizimin e shoqërisë njerëzore.

Sipas dijeplotit Fethullah Gylen, përparimi i shkencave teknike, i tregut të përbashkët dhe i telekomunikacionit ndërplanetar, ka bërë të mundur që bota e sotme të përjetohej si një fshat i madh global, kurse shekullin XXI me vlerat bazë: modernizimin, pluralizimin,

individualizmin dhe fenë, e pandeh si shekull të pritur të mbretërisë së tolerancës dhe të dialogut ndërfetar, ndërkulturor, ndëretnik dhe ndërshtetëror, që do të shpjerë në ngjizjen e njësisë së civilizimit botëror unik dhe në globalizimin e shoqërisë njerëzore mbi parimet e përbashkëta të feve hyjnore. Dijetari, kështu, atakoi fuqimisht tezën e Hungtingtonit për “përplasjen e civilizimeve” në shekullin XXI, së këndejmi edhe tezën tjetër të tij, se “Evropa merr fund atje ku fillojnë ortodoksia dhe islami”, për faktin se “asnjë fe hyjnore nuk është bazuar kurrë në konfliktin, nëse ajo fe është përfaqësuar nga Moisiu, Jezusi ose Muhamedi”. Porosia e Gylenit për akëcilin, është: “Kurrë mos harro se ke shumë vëllezër që s’janë ulur në prehrin e nënës tënde!” dhe saktëson: “Toleranca dhe dialogu janë “dy trëndafila për majat e smeraldit”.

Çdo shkrim i tij në fushë të mendimit edukativ, fetar, arsimor, pedagogjik, filozofik, historiografik, sociologjik, politik, kritik etj., është me plot sentenca të frymëzuara, margaritarë në rrafshin e dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor, të mbështetura fuqimisht në burimet hyjnore të feve të shpallura. Vërtet, esetë dhe traktatet e tij edukative, arsimore dhe politike, si dhe bisedat me përfaqësuesit e komuniteteve fetare, janë margaritarë në themele të mendimit për unifikimin e civilizimit botëror.

Për t’i hapur hulli këtij projekti, Mësuesi i Ndritshëm, vuri kontakte dialoguese me Patrikun e Fanarit, me Kryerabinin e Jerusalemit, si dhe një rëndësie të veçantë për kthesë historike, ishte takimi i Gylenit me



FETHULLAH GYLEN

Papa Gjon Pali II, në 1998, në Vatikan. Gylen e ftonte Papën në një vizitë të përbashkët në Jerusalem, “si një hap domethënës në përpjekjet për ta shpallur qytetin e shenjtë një zonë ndërkombëtare, një vend ku njëlloj si të krishterët, hebrenjtë dhe myslimanët, të jenë të lirë për të shkuar në pelegrinazh pa kufizim, madje pa pasur nevojë për vizë”.

Kështu, dijetari islam, Fethullah Gylen, mund të quhet Kryeekumenist dhe Apostull

Ftoj komunitetin universitar dhe akademik botëror, të shqyrtojë mundësinë për aplikimin urgjentisht të Mendimit filozofik të Gylenit për lëndë mësimore në gjimnaze dhe universitete, e cila ka për ta luajtur rolin e një barriere edukative të papushtueshme ngritur mbi themele të dashurisë e të mirëkuptimit të njerëzishëm, - “kundër atyre që duan ta shohin të ashtuquajturën përplasje të civilizimeve të bëhet realitet”.

i Paqes i pashoq në brezin e tij. Në studimin: “Domosdoshmëria e dialogut ndërfetar”, të mbajtur në Parlamentin e Fëve Botërore, në Kejp Taun, në dhjetor 1999, me një guxim që i ka hije vetëm njeriut të urtë, të panjolla në jetë dhe në vepër paqësore, u bë zëdhënës i së

ardhmes të dëshiruar të njerëzimit.

“Qëllimi i dialogut midis feve nuk është thjesht për të shkatërruar materializmin shkencor dhe botëkuptimin rrënues materialist, por sepse natyra e vërtetë e fesë e kërkon këtë dialog. Hebraizmi, Krishterimi, Islami, madje edhe Hinduizmi dhe fetë e tjera botërore pranojnë të njëjtin burim për vete dhe duke përfshirë dhe budizmin, kanë të njëjtin qëllim. Si një mysliman, unë i pranoj të gjithë profetët dhe librat e sjellë përgjatë historisë për popujt të ndryshëm dhe e vlerësoj besimin në to si një parim esencial të të qenit mysliman”.

Në fund të kësaj kumtese, e për fillimin e mbarë të jetësimit të kërkesave jetësore të edukatorit Njerimadh-Fethullah Gylen, dishepull i thirrjes për domosdoshmërinë e dialogut ndërfetar e ndërkulturor për paqen botërore, me lejen Tuaj edhe në emrin Tuaj, mbështetur në njohurinë e mirë që kam për veprën e gjithëmbarshme të Gylenit, e ftoj komunitetin universitar dhe akademik botëror, të shqyrtojë mundësinë për aplikimin urgjentisht të Mendimit filozofik të Gylenit për lëndë mësimore në gjimnaze dhe universitete, e cila ka për ta luajtur rolin e një barriere edukative të papushtueshme ngritur mbi themele të dashurisë e të mirëkuptimit të njerëzishëm, - “kundër atyre që duan ta shohin të ashtuquajturën përplasje të civilizimeve të bëhet realitet”.

Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin “Dialogu Ndërfetar e Ndërkulturor Si Vlera Integruese”, Tiranë, 2008. (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN

Filozofia e Gylenit dhe Njeriu

Prof. As. Dr. Gjergji Sinani

Në çdo kohë njeriu ka shtruar pyetjen; si të jetoj në mënyrë dinjitoze? Nga çasti që shtrohet kjo pyetje, njerëzit janë përpjekur që të ndërtojnë një shoqëri që të krijojë kushtet e domosdoshme që njerëzit të zhvillojnë lirshëm aftësitë dhe talentet e tyre, të ndërtojnë një shoqëri në përputhje me idealin e tyre si njerëz. Në këtë kuptim, të gjithë mendimtarët janë ndalur në çështjet që ekzistenca e njeriut të jetë sa më në përputhje me idealin e tyre si njerëz, prandaj dhe njerëzit duhet t'u jenë mirënjohës, sepse kanë qenë dhe janë heronjtë e mendimit që i kanë mësuar njerëzit të kërkojnë dhe të luftojnë për lirinë dhe dinjitetin e tyre. Të gjithë mendimtarët humanistë, si kur janë nisur nga premisa e Zotit, apo premisa natyrore, në qendër të tyre kanë patur njeriun. E thënë në një mënyrë filozofike, sipas Niçes, si të ngrihet njeriu nga nënjeri në mbinjeri.

Gyleni, ashtu siç na e paraqet Carrol në librin e saj "Dialogu i qytetërimeve", synon njeriun ashtu si dikur Konfuci për virtytin e qeveritarit dhe të qeverisurit, Sokrati që e ktheu filozofinë nga kozmosi drejt njeriut, Platoni me utopinë e vet, Kanti me imperativin e vet moral që të mos trajtohet njeriu si mjet, por vetëm si qëllim e deri te Sartri me humanizmin e vet ateist dhe

etikën e përgjegjësive.

Sigurisht, Gyleni, duke e bërë njeriun si mishërues të vlerave hyjnore, synon që të kritikojë xhihadin, dhunën, terrorin dhe të flasë për jetën njerëzore në përgjithësi dhe jo vetëm të myslimanëve. Është ky humanizëm që i jep kuptim dialogut me filozofët e mëdhenj, pavarësisht pozicioneve ontologjike.

Gyleni, duke u dhënë vlerave origjinë hyjnore, ato mund të zhvillohen përmes aftësive të tyre të të dëshmuarit dhe të interpretuarit të universit. Ai thekson se njerëzit zotërojnë vlera edhe më të larta se engjëjt dhe se vetëm përmes ideve dhe veprave të tyre ata i japin kuptim jetës. "Qeniet njerëzore, shkruan ai, përbëjnë thelbin dhe elementin kryesor të ekzistencës, përmbajtjen dhe elementin bazë të universit... Me qeniet njerëzore, krijimi ka gjetur interpretuesin e vet dhe lënda është konceptuar nëpërmjet mendjes së njerëzve duke gjetur kështu kuptimin e vet shpirtëror". Gyleni, ashtu si Kanti e të tjerë mendimtarë, i merr vlerat dhe dinjitetin njerëzor si bazë për të përkufizuar sjelljet e ligjshme dhe të paligjshme të njerëzve në shoqëri të ndryshme, pavarësisht se ai i mbështet thëniet e tij te Kurani dhe jo te arsyeja siç bënte, për shembull, Kanti. Po ç'rëndësi ka bazamenti ontologjik. Rëndësi kanë njeriu dhe veprat e tij dhe që feja të mos nxisë urrejtjen për tjetrin, por dashurinë ndërmjet njerëzve. Në këtë perspektivë ai e dënon vrasjen dhe madje thekson se "Islami



FETHULLAH GYLEN

e konsideron vrasjen e një njeriu si vrasjen e gjithë njerëzimit, sepse për vrasësin e një njeriu është e pranueshme ideja se çdo person tjetër mund të vritet”.

Prandaj, edhe del imperativi i dashurisë. “Në fakt, dashuria është trëndafil i besimit tonë, një lule në zemër, e cila kurrë nuk vyshket. Meqë Zoti e ka rrethuar universin me dashuri, muzika më magjike dhe më e mrekullueshme në kraharorin e ekzistencës, mbi gjithçka tjetër qëndron dashuria”.

Sigurisht, dashuria përkthehet në humanizëm. Ai do të tregojë se dashuria përbën zemrën e Islamit dhe injorimi ose keqpërdorimi i fesë ka pasoja mjaft të rrezikshme si për njeriun, por edhe për paqen sociale. Për rëndësinë aktuale të problemit le ta sjellim të plotë idenë e tij. “Humanizmi përbën një doktrinë të dashurisë që në ditët tona, po interpretohet shtrembër duke qenë potencialisht dhe lehtësisht e manipulueshme nëpërmjet interpretimeve të ndryshme... Duhet të jetë e vështirë për të bërë të përputhshme me humanizmin sjelljen e çuditshme të atyre që reklamojnë dhembshurinë dhe mëshirën dhe që më pas përfshihen në akte anarkie dhe terrori, me qëllim shkatërrimin e unitetit të një vendi. Si edhe për ata të cilët kanë vrarë pa iu dridhur dora, njerëz të pafajshëm, si një pjesë e një veprimtarie shekullore, të bazuar në shkatërrimin e mirëqenies së një vendi dhe gjithashtu, edhe për ata të cilët i kryejnë këto akte në emër të vlerave fetare dhe në mënyrë të tmerrshme

akuzojnë padrejtësisht Islamin si një fe që lejon sulmet terroriste”.

Te liria e mendimit ai shikon edhe një rilindje të myslimanëve dhe që të ndodhë kjo, vëren ai, “Ne duhet të bëhemi të lirë, për të menduar dhe vepruar. Ne kemi nevojë për ato zemra të gjera, të cilat mund të përqafojnë lirinë e plotë të mendimit, të cilat janë të hapura ndaj dijes, shkencave dhe kërkimit shkencor...”. Ai qëndron

Gyleni, duke e bërë njeriun si mishërues të vlerave hyjnore, synon që të kritikojë xhihadin, dhunën, terrorin dhe të flasë për jetën njerëzore në përgjithësi dhe jo vetëm të myslimanëve. Është ky humanizëm që i jep kuptim dialogut me filozofët e mëdhenj, pavarësisht pozicioneve ontologjike.

në të njëjtën linjë paralele me Millin se e shikon lirinë në aspektin e dinjitetit dhe aftësive njerëzore. “Liria e vërtetë, liria e përgjegjshmërisë morale, e bën një individ qenie njerëzore, sepse ajo e motivon dhe e gjallëron ndërgjegjen dhe i heq pengesat shpirtit”.

Kumtesë e mbajtur në “Promovimin e Ideve të Gylenit”, Tiranë, Mars 2010 (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN

Ideja e Mëshirës Universale në Etikën dhe Filozofinë e Fethullah Gylenit

Dr. Agron Tufa

Civilizimi modern perëndimor e thelloi përgjatë shekullit XX edhe më shumë idenë e tjetërsisë së civilizimeve, të cilat u theksuan edhe më fort nën trysinë e faktorëve ideologjikë, socialë, historikë e sidomos religjiozë. Tjetërsia Perëndimore nga traditat Lindore ka patur vazhdimisht partizanët e flaktë për një sekularizëm fanatik të qytetërimeve, që nga Osvald Shpengleri deri te Samuel Hantingtoni.

Mitet e mëdha të shkencës, ateizmi dhe mbingopja, e nxorën njeriun bashkëkohor - një krijesë të gjymtuar shpirtërisht e moralisht, tepër larg nga destinacioni i tij. Kjo ftohje dhe tëhuajësim nga destini i tij, krijon edhe atmosferën e rëndë të padurimit dhe fobisë për Tjetrin, të ndryshmin, të pangjashmit, çka jo shpesh ka krijuar një premisë të pashpresë të izolimit të qytetërimeve deri në "përplasjen" e tyre, sipas Hantingtonit.

Ideja rilindëse e poetit dhe mendimtarit turk Fethullah Gylen është se njeriu duhet ribërë, ashtu siç ka dalë ai i shkatërruar nga trysnitë dhe mite moderne. Pathosi humanist i tij na bën thirrje të kthehemi edhe një herë në origjinën e çiltër të gjërave,

në zanafillën e kulluar të vendosjes së marrëdhënieve të harmonishme midis njeriut dhe Zotit. Njerëzimi i sotëm, ashtu siç endet duke u përplasur nga kontradikta në kontradiktë, duhet në radhë të parë të pastrohet nëpërmjet mësimëve të Kuranit famëlartë dhe mësimëve të tjera të shenjta si kusht i domosdoshëm i harmonisë së shpërfillur. Njeriu i sotëm, sipas Gylenit është larguar nga natyra, nga Zoti dhe nga virtytet e çiltra. Ai duhet të kërkojë shpëtimin e tij duke menduar për mëshirën, duke folur për mëshirën dhe duke e shfaqur vetveten vetëm nëpërmjet mëshirës.

Koncepti i Gylenit është kategorial, është një nocion filozofik, i shfaqur nën një pasuri sinonimike me përcaktorët "tolerancë", "dashuri", "përvujtni", "falje". Duket se Gyleni kërkon që njeriu bashkëkohor duhet të hapë zemrën ndaj çudive dhe mrekullive të Zotit, të fitojë aftësinë e humbur, të mahnitet dhe të dashurohet me të bukurën, me fuqinë e dashurisë prekëse për krijesat e Zotit dhe veprave të tij në Natyrën e Madhe. Mëshira në pikëpamjen e Gylenit është një kategori gjithëpërfshirëse, që nënkupton një sistem estetik, dhe së këndejmi, një etikë morale. Mëshira është parë në veprën e mendimtarit si një atribut, kryesëpari, hyjnor, princip universal i botëve, diç që tejkalon nocionet e kohës dhe pafundësisë, si një akt dashurie në Krijimin e Madh të Allahut: "T'i duash krijesat për hir të Krijuesit", citon ai poetin turk Junus Emre. Sipas këtij modeli dhe duke e ndjekur atë, arrihet përsosja e njeriut. Përndryshe, Gyleni



FETHULLAH GYLEN

na paralajmëron se "...në një vend ku nuk ka tolerancë, është e pamundur të flasësh për zhvillimin e mjeteve të komunikimit masiv, për mendimin e përparuar ose, për më tepër, për aktivitete kulturore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të". Duket se Fethullah Gyleni me këtë libër i drejtohet direkt shoqërisë shqiptare, e cila përjeton një krizë vlerash dhe një sekularizim të

Roli i Gylenit me lëvizjen e tij, është e vetmja kundërpërgjigje për vështrimin pesimist futuristik të historisë së njerëzimit bashkëkohor, i cili mund të zhvillojë me mendjen dhe zemrën e tij një mbretëri të harmonisë hyjnore në tokë, larg "përplasjeve" dhe konflikteve.

skajshëm të saj, kryesisht, në mospërputhjen e shpirtërores me fiziken, të mospërputhjes së kohërave, historisë, traditave, brezave dhe ndjenjës religjioze.

Kjo ide e mëshirës universale në konceptimin e Fethullah Gylenit, ka një trajektore shpirtërore që nis nga Mëshira e Zotit për krijesat e Tij, dhe zbrit në tokë, në përditshmërinë tonë, duke synuar të largojmë të keqen nga zemrat e secili.

Por ky është edhe kushti themelor për marrëveshjen, për fillimin e dialogut. Njerëzit pa zemra të pastra, në vend të dialogut linden Murin ndarës.

Ideja e tolerancës dhe e Mëshirës është hapja e njerëzimit drejt rrahjes së çështjeve themelore, njohja e Tjetrit dhe respektimi i lirisë së botëkuptimit. Roli i Gylenit me lëvizjen e tij, është e vetmja kundërpërgjigje për vështrimin pesimist futuristik të historisë së njerëzimit bashkëkohor, i cili mund të zhvillojë me mendjen dhe zemrën e tij një mbretëri të harmonisë hyjnore në tokë, larg "përplasjeve" dhe konflikteve. Mungesa e dialogut me Tjetrin ka prodhuar dhe ka përcaktuar fatalisht një ide krejt tjetër nga e vërteta e vlerave të qytetërimit islam. Paragjykimet dhe fobitë janë ndërtoar edhe në mungesë të subversivitetit të qytetërimit islam, në mungesë të reprezentimit me të gjitha dimensionet e mahnitshme të tij në rrafshet shpirtërore, morale, kulturore etj.

Këtë pathos, mendimtari i shquar Fethullah Gylen, na e ofron në mënyrë delikate, prekëse e tepër të argumentuar, nëpërmjet një vepre kaq optimiste. Gyleni sikur na bën thirrje të gjithëve: Duajini krijesat e Krijuesit dhe bashkë me ta, do të shihni se të gjitha shanset e harmonisë dhe përnaltësimin, presin përpara.

Referat i mbajtur në promovimin e librit "Drejt një Qytetërimi Botëror me Dashuri dhe Tolerancë, Tiranë, Qershor 2006. (me shkurtime)



FETHULLAH GYLEN



Në Prag të Mijëvjeçarit të ri Fethullah GYLEN

Ashtu siç çdo njeri, ndryshe nga kafshët, simbolizon të gjithë njerëzimin, të drejtat e individit nuk mund të jenë sakrifikuar për shoqërinë, dhe të drejtat shoqërore duhet të jenë të kushtëzuara nga të drejtat e individit. Kjo është arsyeja pse të drejtat dhe liritë themelore njerëzore që gjenden në fetë e reveluara ishin marrë në bordin e një Perëndimi të sflitur nga lufta.



FETHULLAH GYLEN

Pikërisht si çdo agim dhe çdo pranverë që vjen simbolizon një fillim dhe shpresë të re, edhe një shekull dhe mijëvjeçar i ri shprehin të njëjtën gjë. Në këtë kontekst, brenda ingranazheve të kohës, mbi të cilat ne nuk kemi kontroll, njerëzimi ka kërkuar gjithmonë një shkëndijë të re të jetës, një erë të freskët si flladi i agimit, dhe ka shpresuar dhe dëshiruar të hedhë një hap në dritë duke lënë pas errësirën, sikur të ishte duke kapërcyer një prag.

Të gjitha ndjenjat negative mund të jenë transformuar në burime të së mirës përmes përpjekjeve dhe edukimit. Në këtë mënyrë, njeriu arrin nivelin e “më të lartit ndër krijesat” duke udhëtuar në rrugën e transformimit nga një krijesë njerëzore potenciale në një krijesë njerëzore të vërtetë dhe të përsosur, në simbolin, modelin dhe përfaqësuesin personal më të mirë të krijimit dhe ekzistencës.

Ne gjithmonë vjelim frytet e veprave tona. Në periudhën e parë të historisë së tij, njerëzimi jetoi në lumturi si një shoqëri e bashkuar, anëtarët e së cilës ndanin gëzimet dhe hidhërimet e tyre. Por pastaj ata lidhën grykët dhe këmbët e tyre me një zinxhir të ndryshkur të formuar me vargonjtë e shtypjes. Ky ishte rezultat i xhelozisë, makutërisë dhe lakmisë për të drejtat dhe pasurinë e të tjerëve. Pasoja ishte vrasja e Abelit nga Kaini. Si rrjedhim, njerëzimi hyri shkallë-shkallë në udhën e përçarjes. Pavarësisht se mijëvjeçarët rrjedhin njëri pas tjetrit, ashtu si ditët, stinët, dhe vitet, ky “cikël” vazhdon akoma.

Mijëvjeçari i dytë

Mijëvjeçari i dytë filloi me kryqëzatat dhe pastaj me invazionin mongol në botën islame, që në atë kohë ishte zemra e botës dhe historisë. Pavarësisht nga luftërat dhe shkatërrimet, pavarësisht nga krimet e kryera, nganjëherë në emër të fesë dhe nganjëherë në emër të epërsisë ekonomike, politike dhe ushtarake, ky mijëvjeçar shihet si kulmi i qytetërimit oriental, një qytetërim i bazuar në vlerat shpirtërore, metafizike, universale dhe të përjetshme, ndërsa qytetërimi perëndimor bazohet në shkencat fizike. Shumë zbulime gjeografike dhe shkencore ndodhën gjatë këtij mijëvjeçari.

Megjithatë, qytetërimi oriental dhe perëndimor ekzistonin të ndarë nga njëri-tjetri. Kjo ndarje, që nuk duhej të kishte ndodhur, ishte bazuar në faktin që i pari distancohej nga përpjekjet e inteligjencës dhe shkencës, ndërsa i dyti distancohej nga besimi, metafizika dhe vlerat e përjetshme dhe të pandryshueshme. Si rrjedhim, shekujt e fundit të mijëvjeçarit të dytë dëshmuar katastrofa që për ne janë të vështira për t'u kuptuar. Për shkak të rritjes së arrogancës dhe egoizmit njerëzor, të nxitur nga aftësitë e tij, popujt do të përjetonin kolonializmin, masakrat e egra, revolucionet që flijuan miliona jetë njerëzore, gjakderdhjet e paimagjinueshme dhe luftërat shkatërrimtare, diskriminimin racial, padrejtësitë e pafundme shoqërore dhe ekonomike dhe perdet e hekurta



FETHULLAH GYLEN

ndërtuar nga regjimet që me ideologjinë dhe filozofinë e tyre kërkonin të mohonin esencën, lirinë, vlerën dhe nderin e natyrës njerëzore. Gjithçka përmendëm më sipër dhe po ashtu disa shenja nga Bibla janë arsytet e frikës që ka pushtuar Perëndimin që bota përsëri do të përmbytet nga lumenjtë e gjakut dhe shkatërrimet. Ata janë plotësisht pesimistë dhe të shqetësuar për faktin se si do të rrjedhë ky mijëvjeçar i ri.

Shpresat tona

Mjetet moderne të komunikimit dhe të transportit e kanë transformuar botën në një fshat të madh global. Kështu, ata që besojnë dhe qëndrojnë të kufizuar në pikëpamjen që çdo ndryshim radikal në një vend përcaktohet për shkak të situatave të brendshme dhe jo nga influencat jashtë tij, janë jashtë realitetit të sotëm. Kjo është koha e marrëdhënieve interaktive. Kombet dhe popujt janë më shumë në nevojë dhe kushtëzohen nga njëri-tjetri, një situatë që shkakton afërsi në marrëdhëniet e ndërsjella.

Ky rrjet i marrëdhënieve që ka lënë pas periudhën e shëmtuar të kolonializmit dhe ekziston në bazë të interesit të ndërsjellë, siguron përfitime edhe për pjesën e prapambetur. Përveç kësaj, në sajë të përparimit të teknologjisë, veçanërisht asaj elektronike dixhitale, grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit gradualisht po vjen duke u rritur. Si rezultat, individët dalin në ballë duke e bërë të pashmangshëm zëvendësimin e regjimeve shtypëse me

qeveritë demokratike që respektojnë të drejtat e njeriut.

Ashtu siç çdo njeri, ndryshe nga kafshët, simbolizon të gjithë njerëzimin, të drejtat e individit nuk mund të jenë sakrifikuar për shoqërinë, dhe të drejtat shoqërore duhet të jenë të kushtëzuara nga të drejtat

Unë shpresoj dhe besoj që bota e mijëvjeçarit të ri do të jetë lumturisjellëse, do të jetë më e drejtë dhe më e mëshirshme, në kundërshtim me frikën e disa popujve. Islami, Krishterimi dhe Hebraizmi, rrjedhin të gjithë nga njëjtë rrënjë, të gjitha kanë në mënyrë thelbësore të njëjtën bazë besimi dhe janë ushqyer nga i njëjti burim.

e individit. Kjo është arsyeja pse të drejtat dhe liritë themelore njerëzore që gjenden në fetë e reveluara ishin marrë në bordin e një Perëndimi të sfilatur nga lufta. Këtyre të drejtave u është dhënë përparësi në të gjitha marrëdhëniet. E drejta e parë është ajo për jetën, e cila është dhënë nga Zoti dhe mund të merret vetëm prej Tij. Për të nxjerrë në pah rëndësinë e kësaj të drejte në Islam, ka një parim themelor në Kuran: “... *kush vret një njeri pa të drejtë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte vrarë të gjithë njerëzit. E kush e shpëton një njeri, është si të kishte shpëtuar të gjithë njerëzit...* (Maide, 32)



FETHULLAH GYLEN

Të drejta të tjera janë liria e fesë dhe e besimit, liria e mendimit dhe e shprehjes, e drejta e pasurisë dhe shenjtëria e familjes, e drejta për t'u martuar dhe për të pasur fëmijë, për të komunikuar dhe udhëtuar, dhe e drejta e arsimimit të lirë. Parimet e jurisprudencës islame janë bazuar në këto dhe në të drejta të tjera, të cilat tani, të gjitha, janë pranuar nga sistemet e ligjshme moderne, të tilla si mbrojtja e jetës, fesë, pasurisë, riprodhimit, intelektit si edhe kuptimi thelbësor i barazisë së popujve, që është bazuar në faktin që të gjithë popujt janë krijesa njerëzore dhe prandaj nuk pranohet diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës dhe gjuhës. Të gjitha këto do të jenë - dhe duhet të jenë - bazat e domosdoshme të mijëvjeçarit të ri.

Unë shpresoj dhe besoj që bota e mijëvjeçarit të ri do të jetë lumturisjellëse, do të jetë më e drejtë dhe më e mëshirshme, në kundërshtim me frikën e disa popujve. Islami, Krishterimi dhe Hebraizmi, rrjedhin të gjitha nga e njëjta rrënjë, të gjitha kanë në mënyrë thelbësore të njëjtën bazë besimi dhe janë ushqyer nga i njëjti burim. Megjithëse ata kanë jetuar si fe rivale për shekuj me radhë, pikat e përbashkëta dhe ndarja e përgjegjësive për të ndërtuar një botë të lumtur për të gjithë krijesat e Zotit e bën të nevojshëm dialogun ndërfaqetarak mes tyre. Ky dialog tani është shpalosur për të përfshirë dhe fetë aziatike dhe të zonave të tjera. Rezultatet janë pozitive.

Siç u theksua më sipër, ky dialog do të zhvillohet si një proces i nevojshëm dhe ndjekësit e të gjitha feve do të gjejnë rrugët

për t'u bërë të afërt dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Gjeneratat e shkuara dëshmojnë një përlëshje të ashpër që kurrë nuk duhet të zërë vend: shkenca kundër fesë. Ky konflikt që i jep krah ateizmit dhe materializmit, ka ndikuar më shumë se në çdo fe tjetër te Krishterimi. Shkenca nuk mund të

Megjithëse ata kanë jetuar si fe rivale për shekuj me radhë, pikat e përbashkëta dhe ndarja e përgjegjësive për të ndërtuar një botë të lumtur për të gjithë krijesat e Zotit e bën të nevojshëm dialogun ndërfaqetarak mes tyre.

kundërshtojë fenë, qëllimi i saj është të kuptojë natyrën dhe njerëzimin, që janë secili një kompozim i manifestimeve të Atributeve të Zotit të vullnetit dhe fuqisë. Feja e ka burimin e saj në Atributin Hyjnor të shprehjes, të manifestuar në rrjedhën e historisë njerëzore në shkrimet e shenjta, siç janë Kurani, ungjijtë, Dhiata e Vjetër dhe e Re, dhe të tjera që kanë qenë zbuluar nga profetët e vërtetë duke filluar nga Ademi. Në sajë të përpjekjeve të studiuesve dhe teologëve të krishterë dhe myslimanë, duket që konflikti midis fesë dhe shkencës që ka vazhduar për pak shekuj, do të vijë në



FETHULLAH GYLEN

një fund, ose më e pakta absurditeti i tij do të jetë më në fund i pranuar.

Fundi i këtij konflikti dhe një formë e re e edukimit që i bashkëngjit njohuritë fetare dhe shkencore me moralitetin dhe spiritualitetin, do të krijojë njerëz vërtet pa paragjykime me zemrat e ndriçuar nga shkencat fetare dhe spiritualiteti, me mendjet e ndriçuar nga shkencat pozitiviste, të karakterizuar nga të gjitha llojet e meritave njerëzore dhe vlerat morale,

Fundi i këtij konflikti dhe një formë e re e edukimit që i bashkëngjit njohuritë fetare dhe shkencore me moralitetin dhe spiritualitetin, do të krijojë njerëz vërtet pa paragjykime me zemrat e ndriçuar nga shkencat fetare dhe spiritualiteti, me mendjet e ndriçuar nga shkencat pozitiviste, të karakterizuar nga të gjitha llojet e meritave njerëzore dhe vlerat morale, kompetentë për kushtet social-ekonomike dhe politike të kohës së tyre.

kompetentë për kushtet social-ekonomike dhe politike të kohës së tyre. Bota jonë e vjetër do të përjetojë një “pranverë” të çuditshme përpara vdekjes së saj. Kjo pranverë do të shohë hendekun e ngushtuar


midis të pasurve dhe të varfërve, pasuritë e botës do të shpërndahen më me drejtësi, në përputhje me punën, kapitalin dhe nevojat, nuk do të ketë diskriminim të bazuar në racën, ngjyrën, gjuhën dhe botëkuptimin, liritë dhe të drejtat themelore njerëzore do të jenë të mbrojtura. Individët do të dalin në krye dhe duke mësuar se si të shfrytëzojnë mundësitë e tyre, do të fluturojnë në udhën për t’u bërë “krijesa njerëzore më e lartësuar” me krahët e dashurisë, dijeve dhe besimit.

Në këtë pranverë të re, kur progresi shkencor dhe teknologjik është marrë në konsideratë, njerëzit do të kuptojnë që nivelet e sotme të shkencës dhe të teknologjisë i ngjasojnë stadi të jetës së një foshnjeje që është mësuar të ecë këmbadoras. Njerëzit do të organizojnë udhëtime në hapësirë thjesht sikur të ishin duke shkuar në një vend tjetër. Udhëtarët në rrugën e Zotit, të devotshmit e dashurisë që nuk kanë kohë për armiqësi, do të mbajnë brenda shpirtit të tyre frymëzimin për botët e tjera.

Po, kjo pranverë do të lulëzojë në themelet e dashurisë, dhembshurisë, mëshirës, dialogut, pranimit të të tjerëve, respektit të ndërsjellët, drejtësisë dhe të drejtave. Ajo do të jetë koha kur njerëzimi do të zbulojë esencën e tij të vërtetë. Mirësia dhe mirësjellja, drejtësia dhe virtyti do të formojnë bazën esenciale të botës. Nuk ka rëndësi se çfarë ndodh, bota do të vijë herët ose vonë në këtë udhë dhe asnjë nuk mund ta ndalojë këtë.

Ne lutemi që Mëshira e Pafundme nuk do t’i lërë shpresat dhe pritjet tona pa përgjigje!


Drejt një Qytetërimi Botëror me Dashuri dhe Tolerancë



Ky libër ka një qëllim të dyfishtë: nga njëra anë, është thirrje për myslimanët që të jenë më të vetëdijshëm se Islami mëson nevojën për dialog dhe se ata janë ftuar për të qenë ndërmjetës dhe dëshmitarë të mëshirës universale të Zotit; nga ana tjetër, është një ftesë për jomyslimanët që të lënë pas paragjykimet, dyshimet dhe të vërtetat e cinguara në mënyrë që të arrijnë ta kuptojnë të vërtetën e Islamit.

Kriteret ose Dritat e Rrugës

Ky libër është një përmbledhje e disa nga aforizmave dhe gjykimeve të Fethullah Gylenit, secila prej të cilave është një kriter ose margaritar i mençurisë me të cilën çdokush mund të kërkojë dhe të gjejë rrugën e tij në botën e sotme, apo një dritë ndriçuese në rrugën tonë, për të jetuar si një qenie njerëzore e përgjegjshme. Një libër që përmban rregullat e arta të jetës.




Statuja e Shpirtrave Tanë


Në këtë libër Fethullah Gylen ka bërë një paraqitje sistematike dhe të hollësishme të ideve që ai sugjeron për rigjallërimin dhe përpjekjet që duhen bërë në rimëkëmbjen e mendimit dhe të veprimit islam.

Dialogu i Qytetërimeve

Një vepër e thellë dhe sugjestionuese e cila përpiqet të bëjë analizën e ideve kyçe themelore përgjatë shekujve në mbarë botën. Autorja paraqet idetë e Fethullah Gylenit në një dialog tekstual me pesë filozofë, ndër më të shquarit dhe influencuesit e epokave dhe qytetërimeve të ndryshme. Në këtë studim unik do të vëreni dialogun dhe këndvështrimet e përbashkëta të Gylenit me Platonin, Konfucin, Millin, Sartrin dhe Kantin.




Dëshmia e Traditës në Epokën Moderne



Një ndër analizat më të hollësishme dhe më objektive mbi Lëvizjen Gylen. Ky studim përbën një përpjekje për të kuptuar përse Lëvizja Gylen ka një fushë të tillë ndikimi që ka marrë përmasa globale. Aktive në më shumë se 160 vende nëpërmjet shkollave dhe qendrave ndërkulturore, Lëvizja Gylen konsiderohet si një nga lëvizjet më domethënëse shoqërore që ka lindur ndonjëherë në botën myslimane.

Skica e një Portreti

Skica e një portreti është një analizë shumëdimensionale e Fethullah Gylenit dhe Lëvizjes që ai ka frymëzuar. Autori rreket të japë një skicë të mendimtarit të shquar nëpërmjet veprës së shkruar dhe aktiviteteve të Gylenit, si dhe përmes artikujve dhe komenteve që janë shkruar rreth tij.





FETHULLAH GYLEN

Fethullah GYLEN në Internet

faqet e internetit për Fethullah GYLENIN në gjuhë të ndryshme

në gjuhën shqipe
www.al.fgulen.com

në gjuhën angleze
www.en.fgulen.com

në gjuhën arabe
www.ar.fgulen.com

në gjuhën bullgare
www.bg.fgulen.com

në gjuhën daneze
www.dk.fgulen.com

në gjuhën franceze
www.fr.fgulen.com

në gjuhën gjeorgjiane
www.ge.fgulen.com

në gjuhën gjermane
www.de.fgulen.com

në gjuhën japoneze
www.jp.fgulen.com

në gjuhën kineze
www.ch.fgulen.com

në gjuhën polake
www.pl.fgulen.com

në gjuhën ruse
www.ru.fgulen.com

në gjuhën spanjolle
www.es.fgulen.com

në gjuhën turke
www.tr.fgulen.com